



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS

Profili i zgjeruar i migrimit

2013 – 2017

AUTORITETI QEVERITAR PËR MIGRIM

Prishtinë,
Dhjetor 2018

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara dhe i takojnë Autoritetit Qeveritar për Migrim - Qeveria e Republikës së Kosovës. Riprodhimi nuk është i lejuar pa autorizim. Në rast të përdorimit të të dhënave nga ky dokument duhet cituar burimin.

MOHIM

Hartimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë, përmes projektit të zbatuar nga Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit (ICMPD) në bashkëpunim me Universitetin e Maastricht-it dhe financuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Migrim.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e Autoritetit Qeveritar për Migrim dhe nuk paraqet këndvështrimet e ICMPD-së, Universitetit të Maastricht ose Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë.

Kontakti:

Autoriteti Qeveritar për Migrim
Qeveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Punëve të Brendshme
Tel: + 381 (0) 38 200 19 545
www.mpb.rks-gov.net
Adresa: Rruga Luan Haradinaj 13
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

PARATHËNIE

Hartimi i profileve të migrimit nga ana e autoriteteve qeveritare që nga viti 2012 është rezultat i kërkesave të dalura nga procesi i liberalizimit të vizave dhe atyre për integrim Evropian. Për adresimin e këëtyre kërkesave, mekanizmi ndër-institucional është formalizuar me vendim të Qeverisë si Autoritet Qeveritar për Migrim (AQM) në vitin 2013 ka hartuar 3 profile të zgjeruara të migrimit dhe 3 profile të lehta të migrimit. Profili i Zgjeruar i Migrimit 2013-2017 është i katërti i hartuar deri tani dhe i cili do tëë azhurnohet çdo 5 vite.

Hartimi i profileve të migrimit është pjesë integrale e punës së AQM-së. Përgjatë viteve, hartimi i këtyre dokumenteve ka luajtur një rol të madh në punën e AQM-së dhe është fuqizuar me kalimin e kohës, ngjajshëm me punën e Autoritetit në mbledhjen e tëë dhënave në fushën e migrimit. Kjo gjithashtu i përgjigjet nevojave për përcjelljen së lëvizjeve migratore të vendit.

Ky dokument është përgatitur nga AQM-ja dhe hartimi i tij është koordinuar nga Koordinatori Nacional për Migrim. Institucionet anëtare të AQM-së dhe institucionet tjera që kanë marr pjesë në hartimin e këtij dokument janë si më poshtë:

- Ministria e Punëve të Brendshme
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike
- Ministria e Punëve të Jashtme
- Ministria e Integrit Evropian
- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Ministria e Financave
- Ministri e Shëndetësisë
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
- Ministria për Komunitete dhe Kthim
- Zyra për Planifikim Strategjik/Zyra e Kryeministrit
- Agjencia e Statistikave të Kosovës Banka Qendrore e Kosovës
- Policia e Kosovës

Organizatat ndërkombëtare të cilat kanë përkrahur procesin e hartimit të këtij dokument janë si në vijim:

- IOM - Organizata Ndërkombëtare për Migrim
- UNHCR - Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
- ICMPD - Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit
- EULEX - Misioni i BE-së në Kosovë

ABSTRAKT

Profili i Zgjeruar i Migrimit 2013-2017 është hartuar nga Autoriteti Qeveritar për Migrim (AQM) si mekanizëm ndër-institucional, i themeluar me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ky është Profili i katërt i kësaj natyre me elemente analitike dhe me qasje gjithëpërfshirëse. Struktura dhe metodologjia e hartimit të këtij dokumenti është në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare për hartimin e profileve të zgjeruara të migrimit.

Qëllimi i këtij dokumenti është të paraqes analizën e trendve të migrimit, si dhe ndikimin e migrimit në sektorët e ndryshëm dhe në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Dokumenti si i tillë është një burim i rëndësishëm për politikëbërësit dhe vendimmarrësit në hartimin e politikave e strategjive koherente në fushën e migrimit. Profilet e formatit të tillë hartohen në periudha 5-vjecare dhe do përmbajnë të dhëna dhe statistika nga institucionet vendore dhe ato të BE-së. Të dhënat ndërkombëtare (kryesisht që ndërlidhen me emigrimin) që përdoren në hartimin e këtij Profili janë pothuajse të gjitha të gjeneruara nga mekanizmat e BE-së.

Të dhënat e paraqitura në këtë dokument janë të dhëna administrative dhe statistikore vjetore nga institucionet zyrtare të cilat janë të ndërlidhura direkt apo indirekt me çështje migratore në vend.

Profili i Zgjeruar i Migrimit 2013-2017 është i ndarë në pesë kapituj dhe është ilustruar përmes tabelave dhe figurave. Për qëllim të krahasueshmërisë, do të jetë i strukturuar në formatin e përafërt me ato të viteve paraprake por me disa ndryshime të vogla.

Ky dokument do të publikohet në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht) ku përveç kopjes fizike do të jetë i disponueshem edhe në formën elektronike në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

| | |
|-----------------|--|
| AFQ | Anketa e Fuqisë Punëtore |
| APRK | Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës |
| ARC | Agjencia e Regjistrimit Civil |
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| BAKD | Bruto të Ardhurat Kombëtare të Disponueshme |
| BE | Bashkimi Evropian |
| DIMAK | Qendrën Informuese Gjermane për Migrim, Aftësim Profesional dhe Karrierë |
| DMH | Drejtoria për Migrim dhe të Huaj |
| DRC | Këshilli Danez për Refugjatë |
| DRPR | Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar |
| DSHAM | Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion |
| ECTS | Sistemi Evropian për Transferin dhe Akumulimin e Kredive |
| EFTA | Zona Evropiane e Tregtisë së Lirë |
| EULEX | Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë |
| EUROSTAT | Agjencia Evropiane për Statistika |
| ICMPD | Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit |
| IHD | Investimet e Huaja Direkte |
| IOM | Organizata Ndërkombëtare e Migrimit |
| ISCED | Standardi Ndërkombëtar për Klasifikimin e Edukimit |
| KASH | Korniza Afatmesme e Shpenzimeve |
| KES | Këshilli Ekonomik Social |
| MAPL | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| MARRI | Nisma Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë |
| MASHT | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë |
| MeD | Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike |
| MF | Ministria e Financave |
| MIK | Menaxhimi i Integruar i Kufirit |
| MKK | Ministria për Komunitete dhe Kthim |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| MPBZHR | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| MPJ | Ministria e Punëve të Jashtme |
| MPMS | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale |
| MSH | Ministria e Shëndetësisë |
| MTI | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë |
| MZHE | Ministria e Zhvillimit Ekonomik |
| PBV | Prodhimi i Brendshëm i Vendit |
| PK | Policia Kufitare |
| PKK | Pikat e Kalimit Kufitar |
| PRE | Programi për Reforma Ekonomike |
| PZHBV | Person i Zhvendosur Brenda Vendit |
| PZHR | Personat e Zhvendosur në Rajon |
| QAP | Qendrat e Aftësimit Profesional |
| SBR | Shkalla Bruto e Regjistrimit |
| SIVK | Sistemi Informativ i Vizave në Kosovë |
| SMIA | Sistemi i Menaxhimit Informativ të Arsimit |
| SMR | Sistemi i Menaxhimit të Rasteve |
| SHBA | Shtetet e Bashkuara të Amerikës |

| | |
|--------------|--|
| UNDP | Agjencia për Zhvillim e Kombeve të Bashkuara |
| UNHCR | Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë |

PËRMBAJTJA

Lista e Tabelave

Lista e Figurave

| | |
|--|----|
| Informatat e përgjithshme për Republikën e Kosovës | 1 |
| PJESA A: HYRJE | 2 |
| A 1. Vështrim i Përgjithshëm | 2 |
| A 2. Historiku i migrimit në Kosovë | 3 |
| PJESA B: KONTEKSTI SOCIO-EKONOMIK I MIGRIMIT | 5 |
| B 1. Popullsia e Kosovës | 5 |
| B 1.1. Treguesit bazik demografik..... | 5 |
| B 1.2. Rrjedhat dhe stoqet e migrimit | 6 |
| B 1.2.1. Rrjedhat e migrimit | 6 |
| B 1.2.2. Stoqet e migrimit | 8 |
| B 2. Zhvillimet e fundit makroekonomike | 10 |
| B 2.1. Sektori financiar..... | 12 |
| B 2.2. Ekonomia jo-formale..... | 18 |
| B 2.3. Investimet e huaja direkte..... | 20 |
| B 2.4. Tregtia | 21 |
| B 2.5. Dërgesat e emigrantëve (remitancat) | 24 |
| B 3. Analiza e tregut të punës | 29 |
| B 3.1. Treguesit kryesorë të tregut të punës..... | 29 |
| B 3.2. Vlerësimi i nevojave për punësim dhe aftësim profesional..... | 35 |
| B 3.3. Nevoja të shumëfishta për mbrojtje sociale | 35 |
| B 4. Kapitali njerëzor | 37 |
| B 4.1. Shkalla /niveli i arsimimit..... | 37 |
| B 4.2. Mundësia për të hyrë në sistemin arsimor | 37 |
| B 4.3. Qasja në arsimin e lartë..... | 39 |
| PJESA C: ANALIZA E GJENDJES SË MIGRIMIT NË SHTET | 41 |

| | |
|--|----|
| C 1. Imigrimi | 41 |
| C 1.1 Regjimi i vizave..... | 41 |
| C 1.2 Të huajt që qëndrojnë në Kosovë dhe lloji i imigrantëve | 43 |
| C 1.3 Të huajt që kanë fituar dhe iu është refuzuar shtetësia e Republikës së Kosovës | 48 |
| C 1.4 Imigrimi i parregullt..... | 50 |
| C 1.5 Azili dhe përcaktimi i statusit të mbrojtjes ndërkombëtare..... | 60 |
| C 2. Emigrimi | 62 |
| C 2.1 Kërkesat për viza | 62 |
| C 2.2 Shtetasit e Republikës së Kosovës me leje qëndrimi të vlefshme në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen..... | 64 |
| C 2.3 Lirimi nga shtetësia..... | 66 |
| C 2.4 Emigrantët e parregullt | 67 |
| C 2.5 AzilLerkuesit Kosovare ne shtetet e BE-se dhe Zones Schengen..... | 73 |
| C 3. Diaspora dhe mërgata | 76 |
| C 4. Ripranimi dhe riintegrimi i shtetasve të Kosovës të kthyer nga vendet e huaja | 78 |
| C 4.1.Ripranimi vullnetar dhe me forcë..... | 78 |
| C 4.2 Riintegrimi i personave të riatdhesuar | 81 |
| C 5. Personat e zhvendosur brenda vendit dhe jashtë vendit | 84 |
| PJESA D: POLITIKAT DHE PROGRAMET E MIGRIMIT DHE EFEKTIVITETI I TYRE NË MENAXHIMIN E MIGRIMIT DHE SFIDAVE TË ZHVILLIMIT | 87 |
| D 1. Korniza e politikave dhe ligjeve në fushën e migrimit në Kosovë | 87 |
| D 1.1. Korniza e politikave..... | 87 |
| D 1.2. Korniza ligjore në fushën e migrimit..... | 89 |
| D 1.3. Korniza ligjore ndërkombëtare në fushën e migrimit | 92 |
| D 2. Pasqyrë e kornizës institucionale kombëtare dhe partnerëve në fushën e migrimit | 92 |
| D 2.1. Institucionet vendore në fushën e migrimit..... | 92 |
| D 2.2. Organizatat dhe akterët e shoqërisë civile në fushën e migrimit | 94 |
| D 3. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e migracionit | 94 |
| D 3.1. Bashkëpunimi me organizatat dhe iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe akterët e tjerë ndërkombëtarë në fushën e migrimit | 95 |

| | |
|--|------------|
| D 3.2. Bashkëpunimi bilateral në fushën e migrimit..... | 95 |
| PJESA E: VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË MIGRIMIT DHE POLITIKAT E MIGRIMIT PËR ZHVILLIMIN SOCIO-EKONOMIK..... | 97 |
| E 1. Ndikimet e migrimit në zhvillimin socio-ekonomik të vendit..... | 97 |
| E 2. Roli i migrimit në formësimin e demografisë..... | 97 |
| E 3. Efektet e remitencave në mirëqenien dhe pabarazinë e ekonomive familjare | 98 |
| E 4. Ndikimet e migrimit në tregun e punës | 99 |
| E 5. Roli i migrimit në stimulimin e zhvillimit të tregtisë dhe sektorit privat | 100 |
| E 6. Ndikimi i migrimit në sferën politike në vend..... | 100 |
| PJESA F: PËRFUNDIMET | 101 |
| F 1. Rezultatet (gjetjet) kryesore të migrimit përsa i përket prirjeve të ardhshme të mundshme të migrimit | 101 |
| F 2. Përmirësimi i të dhënave të migrimit..... | 105 |
| F 3. Rekomandimet në lidhje me menaxhimin e migrimit | 107 |
| REKOMANDIMET STRATEGJIKE PËR PËRMIRËSIMIN E MENAXHIMIT TË MIGRIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS..... | 110 |
| SHTOJCAT | 112 |
| I. Burimet dhe Variablat (Ndryshoret) e përdorura për mbledhjen e të dhënave..... | 112 |
| II. Aneks Tabelat..... | 113 |
| III. Referencat..... | 131 |

LISTA E TABELAVE

| | |
|---|-----------|
| <i>Tabela 1: Indikatorët demografik për periudhën 2013-2017.....</i> | <i>5</i> |
| <i>Tabela 2: Stoqet e imigrimit dhe rrjedhja e imigrimit ne numra absolut dhe relative, 2013-2017.....</i> | <i>9</i> |
| <i>Tabela 3: Stoqet e emigrimit dhe rrjedhja e emigrimit ne numra absolut dhe relative, 2013-2017.....</i> | <i>9</i> |
| <i>Tabela 4: Stoqet e emigrimit dhe rrjedhja e migrimit në numra absolut dhe relativ, 2013-2017.....</i> | <i>10</i> |
| <i>Tabela 5: Bilanci tregtar 2013-2017 (në .000 eur)</i> | <i>21</i> |
| <i>Tabela 6: Eksporti i Shërbimeve: top sektorët 2013-2018.....</i> | <i>22</i> |
| <i>Tabela 7: Renditja e kosovës për të bërit biznes gjatë viteve.....</i> | <i>23</i> |
| <i>Tabela 8: Numri i përgjithshëm i bizneseve të regjistruara</i> | <i>23</i> |
| <i>Tabela 9: Numri i bizneseve te regjistruara me pronarë të huaj.....</i> | <i>24</i> |
| <i>Tabela 10: Lejqëndrimet e përkohshme, sipas kategorive, 2013-2017.....</i> | <i>44</i> |
| <i>Tabela 11: Të huajt që hyrë në Kosovë në mënyrë të parregullt sipas përkatësisë gjinore në përqindje, 2013-2017.....</i> | <i>52</i> |
| <i>Tabela 12: Shtetasit e huaj të larguar me urdhër largimi me forcë sipas shtetësisë, 2013-2017</i> | <i>56</i> |
| <i>Tabela 13: Shtetësia e personave të dyshuar për kontrabandë me migrantë, 2013-2017</i> | <i>57</i> |
| <i>Tabela 14: Viktimat e trafikimit të identifikuar sipas vendit të origjinës/shtetësisë 2013-2017.....</i> | <i>58</i> |
| <i>Tabela 15: Të kthyerit vullnetar të raportuar nga UNHCR, 2013-2017.....</i> | <i>84</i> |
| <i>Tabela 16: Shtëpitë e ndertuara nga MKK-ja dhe akterët e jashtëm, 2013-2017</i> | <i>86</i> |

LISTA E FIGURAVE

| | |
|--|----|
| Figura 1: Trendi i imigrimit në Kosovë për vitet 2013-2017..... | 6 |
| Figura 2: Emigrimi kosovarë i vlerësuar nga ASK, 2013-2017..... | 8 |
| Figura 3: Rritja reale e BPV, parashikimi dhe pjesëmarrja sipas komponentëve 2012-2018 | 11 |
| Figura 4: Treguesi i klimës së biznesit (TKB), vlerësimi i gjendjes aktuale: Balanca | 12 |
| Figura 5: Struktura e kredive dhe norma vjetore e rritjes, 2013-2017..... | 13 |
| Figura 6: Kontributi në rritjen reale të BPV-së..... | 15 |
| Figura 7: Investimet e huaja direkte në Kosovë në miliona euro dhe si përqindje e PBB-së, 2013-2017..... | 20 |
| Figura 8: Investimet e huaja direkte sipas sektorëve kryesor ekonomik, në përqindje, 2013-2017..... | 21 |
| Figura 9: Trendi i hyrjeve të remitancave, 2013-2017 | 25 |
| Figura 10: Dërgesat e migrantëve - sipas kanaleve, në përqindje, 2013-2017..... | 26 |
| Figura 11: Trendi i daljeve të remitancave, 2013-2017..... | 27 |
| Figura 12: Shërbimet e udhëtimit në miliona euro, 2013-2017 | 27 |
| Figura 13: Të hyrat nga Diaspora si përqindje e produktit të brendshëm bruto, 2013-2017..... | 28 |
| Figura 14: Kompenzimi i punëtorëve sipas viteve, 2013-2017..... | 29 |
| Figura 15: Shkalla e Papunësisë sipas viteve, 2013-2017..... | 31 |
| Figura 16: Shkalla e papunësisë dhe punësimit, 2013-2017 | 32 |
| Figura 17: Shkalla e papunësisë sipas viteve për të rinj, 2013-2017..... | 32 |
| Figura 18: Vendet e lira dhe ndërmjetësimet në punësim sipas viteve, 2013-2017 | 34 |
| Figura 19: Trendi i nxënësve të larguar jashtë vendit sipas nivelit dhe vitit shkollor, 2013/14-2016/17..... | 38 |
| Figura 20: Trendi i nxënësve të ardhur nga jashtë vendit sipas nivelit dhe vitit shkollor, 2013/14-2016/17 | 38 |
| Figura 21: Numri i studentëve në institucione publike dhe private të arsimit të lartë, 2010/11-2016/17..... | 40 |
| Figura 22: Kërkesat, aprovimet dhe refuzimet e vizave hyrëse sipas misionëve diplomatike/konsullore për pesë vendet e para, 2013-2017..... | 43 |
| Figura 23: Trendi i leje-qëndrimeve të përkohshme, krahasim i kategorive ‘Bashkimi Familjar’/‘Punësim’ (2013-2017)..... | 45 |
| Figura 24: Leje qëndrimet e përkohshme, sipas afatit kohor, 2013-2017 | 46 |
| Figura 25: Lejeqëndrimet e përhershme të lëshuara në periudhën 2013-2017 | 46 |
| Figura 26: Prodhimi i leje qëndrimeve të përkohshme dhe të përhershme në vitet, 2013-2017... .. | 48 |
| Figura 27: Numri i personave që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës, 2013-2017..... | 49 |
| Figura 28: Refuzim i hyrjeve të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, 2013-2017..... | 50 |

| | |
|--|----|
| Figura 29: Refuzim i hyrjeve të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës sipas kontinenteve, 2013-2017..... | 51 |
| Figura 30: Numri i imigrantëve që kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar, 2013-2017..... | 52 |
| Figura 31: Të huajt me qëndrim të pa rregullt sipas shtetësisë, 2013-2017..... | 54 |
| Figura 32: Të huajt të urdhëruar të largohen nga territori i Republikës së Kosovës, 2014-2017.. | 55 |
| Figura 33: Rastet e iniciuara për kontrabandë me migrantë, 2013-2017 | 57 |
| Figura 34: Azil-kërkuesit në Republikën e Kosovës sipas grup-moshës, 2013-2017..... | 61 |
| Figura 35: Numri i kërkesave, viza të lëshuara dhe të refuzuara sipas shteteve, 2013-2017..... | 62 |
| Figura 36: Numri i kërkesave, viza të lëshuara dhe të refuzuara sipas viteve, 2013-2017 | 64 |
| Figura 37: Leje qëndrimet e vlefshme të kosovarëve në shtetet e BE-së, 2013-2107..... | 65 |
| Figura 38: Shtetasit Kosovarë me leje qëndrimi të vlefshme në shtetet anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen sipas arsyes së qëndrimit, 2013-2017 | 65 |
| Figura 39: Numri i përgjithshëm i personave që janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës sipas gjinisë 2013-2017 | 67 |
| Figura 40: Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose të zënë në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, sipas shteteve, 2013-2017 | 68 |
| Figura 41: Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi sipas arsyes së refuzimit, 2013-2017..... | 69 |
| Figura 42: Shtetasit Kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, sipas pesë shteteve kryesore, 2008-17 | 70 |
| Figura 43: Shtetasit Kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, 2013-2017..... | 71 |
| Figura 44: Shtetasit Kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen në bazë të urdhrit për largim sipas shteteve dhe viteve, 2013-2017 | 72 |
| Figura 45: Trendi i kërkesave për azil dhe i kërkesave për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë të shtetasve Kosovarë drejt BE-së dhe Zonës Schengen, 2013-2017..... | 74 |
| Figura 46: Trendi i vendimeve përfundimtarë pozitive për shtetasit Kosovarë, 2013- 2017..... | 75 |
| Figura 47: Ripranimi vullnetarë dhe me forcë sipas viteve, 2013-2017 | 79 |
| Figura 48: Ripranimi me force sipas komunave, 2013-2017 | 80 |
| Figura 49: Ndhurma menjëherë pas arritjes dhe ndihmat emergjente brenda 12 muajve pas riatdhesimit, 2013-2017 | 82 |
| Figura 50: Ndhurma për ri-integrim të qëndrueshëm, 2013-2017..... | 83 |

INFORMATAT E PËRGJITHSHME PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS

Republika e Kosovës është shteti më i ri në Gadishullin Ballkanik me një pozicion gjeografik qendror e rrethuar me Republikën e Shqipërisë, Republikën e Maqedonisë, Republikën e Malit të Zi dhe Republikën e Serbisë.



Rajoni: Europa Juglindore

Gjerësia e territorit të Republikës së Kosovës: 41° 51' 21 dhe 43° 16'

Gjatësia e territorit të Republikës së Kosovës: 19° 59' dhe 21° 47'

Emri zyrtar: Republika e Kosovës

Kryeqyteti: Prishtina

Gjatësia e kufijve: Me Republikën e Shqipërisë në jugperëndim 113.551 km, me Republikën e Maqedonisë në jug 170.772 km, me Republikën e Malit të Zi në veriperëndim 79.165 km, me Republikën e Serbisë në verilindje 380.068 km. Kufiri i Republikës së Kosovës me vendet fqinje kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror, kurse gjatësia e përgjithshme e kufirit është 743.556 km¹.

Sipërfaqja: 10,908 km²

Vendet fqinje: Republika e Shqipërisë, Republika e Maqedonisë, Mali i Zi, Republika e Serbisë

Popullsia: 1,798,506 (e vlerësuar më 2017)

Dendësia e popullsisë: 164 banorë për 1km²

Grupet etnike: Shqiptarë 91.1%; të tjerë 8.9% (e vlerësuar më 2017)

Forma e qeverisjes: Republikë Parlamentare

Valuta: Euro (EUR)

Dita e pavarësisë: 17 shkurt 2008

Presidenti: z. Hashim Thaçi

¹ Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/ALB_Strategjia_Kombetare_MIK_2013-2018_12.07.2013.pdf

² Po aty

PJESA A: HYRJE

A 1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Në vitin 2005, Komisioni Evropian në Komunikatën mbi Migrimin dhe Zhvillimin kishte propozuar që Profili i Migrimit duhet të ketë për qëllim mbledhjen e të dhënave me çështje që kanë të bëjnë me situatën e tregut të punës, shkallën e papunësisë, kërkesën dhe ofertën e tregut të punës dhe mangësitë e tashme dhe ato potenciale të aftësive sipas sektorëve dhe profesioneve, nevojat profesionale në vend, lëvizjet migruese, lëvizjet hyrëse dhe dalëse financiare të ndërlidhura me migrimin, përfshirë remitancat, si dhe aspektet relevante gjinore dhe ato të ndërlidhura me të mitur³.

Qeveria e Republikës së Kosovës në përputhje me kërkesat që kanë dal nga procesi i liberalizimit të vizave me Bashkimin Evropian si dhe në përputhje me procesin e integritimit Evropian ka filluar me hartimin e profileve të migrimit në baza vjetore që nga viti 2012 në kuadër të mekanizmit koordinues ndër-institucional i formalizuar me Vendim të Qeverisë për themelimin e Autoritetit Qeveritar për Migrim (AQM).

Profili i Zgjeruar për Migrim 2013-2017 është dokument gjithëpërfshirës dhe analitik që përban analizë të të dhënave dhe trendeve në fushën e migrimit (emigrimit dhe imigrimit). Qëllimi i këtij dokumenti është që të shfrytëzohet si analizë e gjendjes aktuale për qëllim të hartimit të Strategjisë Shtetërore për Migrimit 2019-2023 dhe dokumentet e tjera të politikave.

³ Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Regjioneve: Migrimi dhe Zhvillimi: Disa orientime konkrete COM (2005), faqe 37, shtojca 8

A 2. HISTORIKU I MIGRIMIT NË KOSOVË

Përkundër kufizimeve për lëvizje të lirë në zonë Schengen, (mos liberalizim të vizave) popullsia e Kosovës vazhdon të emigrojë, por me një rënie të shprehur në vitin 2017 krahasuar me vitet paraprake.

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës është vlerësuar se numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2017, është vlerësuar të jetë gjithsej 11,263 banorë përfshirë emigrantët e rregullt dhe të parregullt.

Pjesa më e madhe e emigrantëve për vitin 2017, ishin emigrantët të rregullt. Arsyet e emigrimit të rregullt ishin: bashkimi familjar, martesat, punësimi, shpërngulje të përhershme (kryesisht në shtete fqinje), studimi, etj. Po ashtu, gjatë periudhës 2013-2017 një numër i konsiderueshëm emigruan duke kërkuar azil (*aplikantë për herë të parë*) në vendet e BE-së përfshirë vendet e Asociacionit të Tregtisë së Lirë të Evropës (EFTA-së). Përveç vendeve të BE-së dhe EFTA-së një numër i Kosovarëve kishte emigruar edhe në vende të tjera kryesisht në SHBA, Kanada dhe vende tjera⁴.

Numri i popullsisë Kosovare të emigruar dhe asaj me prejardhje Kosovare (1969-2011) është vlerësuar të jetë 703,978 banorë, derisa në vitin 2017 vlerësohet të jetë 833,739 banorë.

Pas vitit 2011 kryesisht emigruan të rinjtë e grup-moshave 25-44 vjeç të cilët përbënin 43.92% të popullsisë emigruese (*mosha kryesore riprodhuese në aspektin e fertilitetit dhe asaj të fuqisë punëtore*) derisa, dominonte grup-mosha 21-27 vjeç me 27.53%. Është interesant fakti se gjatë këtyre viteve (2011-2017) personat pas moshës së punës (*mbi 65 vite*) përbënin një numër të konsiderueshëm të emigrimit me 3.60% derisa në periudhën 1969-2011 kjo grup-moshe përbënte vetëm 1.3% të emigrimit Kosovarë. Bazuar në të dhënat e disponueshme emigrantët Kosovarë (2011-2017) kanë emigruar kryesisht në Gjermani dhe kohëve të fundit edhe në Francë, Itali dhe vendet Skandinave.

Përkundër emigrimit të madh, në Kosovë janë kthyer një numër i vogël i personave që kishin emigruar për vite të tëra nga Kosova.

⁴ PZM 2013-2017 nuk posedon me të dhëna zyrtare të publikuara për SHBA dhe Kanada.

Në vitin 2017 bazuar në të dhënat e vlerësuara nga Agjencia e Statistikës së Kosovës kanë emigruar 5,832 persona.

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë të vitit 2011 për periudhën 1969-2011 si dhe vlerësimeve të popullsisë (2011-2017) janë gjithsej 180,242 imigrantë (të kthyer) apo rreth 10% e popullsisë rezidente të Kosovës. Rreth 98% e të kthyerve kishin shtetësi Kosovare prandaj, shumica dërmuese e imigrantëve në fakt ishin të kthyer në vendin e tyre.

PJESA B: KONTEKSTI SOCIO-EKONOMIK I MIGRIMIT

B 1. POPULLSIA E KOSOVËS

Popullsia e përgjithshme rezidente⁵ e Kosovës për vitin 2017 është vlerësuar të jetë 1,798,506⁶ banorë. Krahasuar me vitin 2016, ajo është shtuar për 0.83% banorë. Në këtë rritje ka ndikuar shtimi natyral dhe shkalla e ulët e migrimit neto ndërkombëtarë.

B 1.1. TREGUESIT BAZIK DEMOGRAFIK

Që nga fillimi i vitit 2013 deri në fund të vitit 2017, popullsia e Republikës së Kosovës kishte një shtim natyror prej 108,833 banorë, ndërsa trendi i emigrimit në Republikën e Kosovës ka pasur një rritje të vazhdueshme deri në vitin 2016, përderisa pas vitit 2016 ka rënie të konsiderueshme të emigrimit.

Tabela 1: Indikatorët demografik për periudhën 2013-2017

| Indikatorët demografik | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
|--------------------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Popullsia | 1,820,631 | 1,804,944 | 1,771,604 | 1,783,531 | 1,798,506 |
| Nataliteti | 29,723 | 32,087 | 31,116 | 30,069 | 30,025 |
| Mortaliteti | 8,317 | 8,165 | 8,884 | 9,202 | 9,619 |
| Shtimi natyror | 21,406 | 23,922 | 22,232 | 20,867 | 20,406 |
| Shkalla e natalitetit (promil) | 16.3 | 17.8 | 17.6 | 16.9 | 16.7 |
| Shkalla e mortalitetit | 4.6 | 4.5 | 5.0 | 5.2 | 5.3 |
| Imigrimi | 3,864 | 5,724 | 18,862 | 13,072 | 5,832 |
| Emigrimi | 20,246 | 45,333 | 74,434 | 22,012 | 11,263 |
| Net migrimi | -16,382 | -39,609 | -55,572 | -8,940 | -5,431 |
| Rritja absolute | 5,024 | -15,687 | -33,340.0 | 11,927 | 14,975 |
| Rritja ne % | 0.3 | -0.9 | -1.9 | 0.7 | 0.8 |
| Urbane | 38.9 | 39.0 | 38.9 | 38.8 | 38.3 |
| Rurale | 61.1 | 61.1 | 61.1 | 61.2 | 61.7 |
| Mosha mesatare | 30.6 | 30.8 | 30.2 | 30.4 | 30.2 |
| Jetëgjatësia | 76.8 | 76.8 | 76.7 | 76.7 | 76.7 |

Burimi: ASK

⁵ 'Popullsi rezidente' - llogaritet popullsia e cila ka jetuar për një periudhë kohore të vazhdueshme në vendbanimin e tyre të zakonshëm me shume se 12 muaj ose ka arritur në atë vendbanim gjatë 12 muajve me qëllim që të qëndroj aty me gjatë se një vit; burimi: **MIGRIMI KOSOVAR**, Prishtinë, Prill, 2014, faqe 14: <http://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>

⁶ Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2017, faqe 9 tabela 2: Prishtinë, Qershor 2018: <http://ask.rks-gov.net/media/3385/vleresimi-i-popullsise-se-kosoves-2017.pdf>

Gjatë viteve 2014 dhe 2015 kishte një trend shqetësues të emigrimit, me një numër prej më shumë se 119,000 emigrantë⁷. Emigrimi për periudhën pesë vjeçare 2013-2017 ishte 173,288 banorë, imigrimi 47,354 dhe net migrimi me 125,934 banorë.

Emigrimi i lartë në vitet e lartcekura do të ndikoj edhe në strukturën e popullsisë, në vitalitetin i cili do të jetë evident në vitet vijuese pasi që vlerësohet se pjesa dërmuese e emigrimit kishte përfshirë grup moshat e reja kryesisht 25-44 vite (mosha fertile), të cilat përbënin 47.2% të popullsisë emigruese⁸ e cila ndikoi në rënien e fertilitetit siç ishte në vitin 2003: 3 fëmijë për një grua, ndërsa sipas anketës së MICS-it (Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishtë 2013-2014) ka rënë në 2.3 fëmijë një grua.

Shteti Kosovës karakterizohet me strukturën shumë të re të popullsisë, mosha mesatare është 30.2 vjet ndërsa jetëgjatësia mesatare në Kosovë për vitin 2011 është vlerësuar të ishte 76.7 vite.

Përqindja e popullsisë që jetonte në zonat rurale në vitin 2011 ishte 61.7%, ndërsa ajo në zonat urbane 38.3%.

B 1.2. RRJEDHAT DHE STOQET E MIGRIMIT


B 1.2.1. RRJEDHAT E MIGRIMIT

Imigrimi

Për periudhën 2013-2017, të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i personave që kanë imigruar gjatë këtyre viteve janë kryesisht Kosovar me një mesatare vjetore prej 9,471 persona apo 0.52% e popullsisë brenda një viti.

Figura 1: Trendi i imigrimit në Kosovë për vitet 2013-2017

⁸ MIGRIMI KOSOVAR, Prishtinë, Prill, 2014, faqe 23: <http://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>



Burimi: ASK

Numri i përgjithshëm i imigrantëve⁹ gjatë vitit 2017, i vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ishte gjithsej 5,832 persona¹⁰ apo 0.32% e gjithë popullsisë rezidente. Në këtë numër janë përfshirë të gjithë imigrantët (kosovarë dhe jo-kosovarë) pa marrë parasysh arsyen e imigrimit në Kosovë. Pjesa më e madhe e këtij numri janë shtetas Kosovarë të kthyer.

Emigrimi


Numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2017 i vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ishte gjithsej 11,263 persona¹¹ apo 0.62% e popullsisë rezidente. Në këtë numër janë përfshirë të gjithë emigrantet nga shtetet e BE-së, shtetet EFTA si dhe një numër i kosovarëve që kanë emigruar në SHBA, Kanada dhe vende tjera.

⁹ Në këtë numër janë përfshirë të kthyerit vullnetar/ të ripranuarit, të riatdhesuarit, numri i azilkërkuesve të Kosovës që kanë fituar lejeqëndrimin për më shumë se një vit në Kosovë

¹⁰ Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2017, faqe 9 tabela 2: Prishtinë, Qershor 2018: <http://ask.rks-gov.net/media/3385/vleresimi-i-popullise-se-kosoves-2017.pdf>

¹¹ Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2017, faqe 9 tabela 2: Prishtinë, Qershor 2018: <http://ask.rks-gov.net/media/3385/vleresimi-i-popullise-se-kosoves-2017.pdf>

Figura 2: Emigrimi kosovarë i vlerësuar nga ASK, 2013-2017



Burimi: ASK

Të dhënat për periudhën 2013-2017, tregojnë se Kosova vazhdon të ketë shkallë të lartë të emigrimit me një mesatare vjetore prej 34,658 apo 1.92% të popullatës Kosovare.

B 1.2.2. STOQET E MIGRIMIT

Si pikë bazë (Stock) për rrjedhjen e migrimit, janë marrë të dhënat zyrtare të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Sipas publikimit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës të vitit 2014, i titulluar 'MIGRIMI KOSOVAR'¹², bazuar në të dhënat e vitit 2011 (01 Prill), vlerësohet se janë me shumë se 550,000 banorë kosovar që kishin emigruar nga Kosova prej vitit 1969 derisa, popullsia e vlerësuar me prejardhje kosovare që përfshirë personat e lindur jashtë Kosovës është vlerësuar të jetë 703,978 banorë deri me 01 prill 2011.

Stoqet e Imigrimit

Llogaritet se mbi 7.5% e popullsisë apo mbi 128,000 banorë të Kosovës, së paku një herë a më shumë kanë qëndruar jashtë vendit për një periudhë të caktuar kohore (zakonisht me shumë se një vit) gjatë periudhës prej vitit 1969 e deri me 01 Prill 2011. Pjesa më e madhe e imigrimit ka ndodhur në vitin 1999-2000 kur një numër i madh i kosovarëve janë kthyer në mënyrë vullnetare për të jetuar në Kosovë si rezultat i çlirimit të vendit. Po ashtu, edhe vitet 2015 e

¹² **MIGRIMI KOSOVAR**, Prishtinë, Prill, 2014, faqe 76: <http://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>

2016 karakterizohen me më së shumti imigrantë Kosovarë, si pasojë e emigrimit të madh që kishte ndodhur në vitin 2014 dhe 2015.

Tabela 2: Stoqet e imigrimit dhe rrjedhja e imigrimit ne numra absolut dhe relative, 2013-2017

| Viti | Gjithsej popullsia | Stoku i imigrimit (numra absolutë) | Stoku (përqindje) |
|------|--------------------|------------------------------------|-------------------|
| 2013 | 1,820,631 | 10,410 | 0.57 |
| 2014 | 1,804,944 | 16,134 | 0.89 |
| 2015 | 1,771,604 | 34,996 | 1.98 |
| 2016 | 1,783,531 | 48,068 | 2.70 |
| 2017 | 1,798,506 | 53,900 | 3.0 |

Burimi: ASK

Stoqet e Emigrimit

Në periudhën 5 vjeçare, 2013-2017 llogaritet se emigruan mbi 173 mijë apo mbi 9% e popullsisë së Republikës së Kosovës.

Tabela 3: Stoqet e emigrimit dhe rrjedhja e emigrimit ne numra absolut dhe relative, 2013-2017

| Viti | Gjithsej popullsia | Stoku i imigrimit (numra absolutë) | Stoku (përqindje) |
|------|--------------------|------------------------------------|-------------------|
| 2013 | 1,820,631 | 28,946 | 1.59 |
| 2014 | 1,804,944 | 74,279 | 4.12 |
| 2015 | 1,771,604 | 148,713 | 8.39 |
| 2016 | 1,783,531 | 170,725 | 9.57 |
| 2017 | 1,798,506 | 181,988 | 10.1 |

Burimi: ASK

Stoku i imigrimit neto

Gjatë periudhës 2013-2017 në Kosovë imigruan (zakonisht Kosovarë të kthyer) mbi 47,000 banorë, ndërsa emigruan mbi 173,000 banorë dhe popullësia e Kosovës gjatë kësaj periudhe është zvogëluar për më shumë se 126,000 banorë.

Tabela 4: Stoqet e emigrimit dhe rrjedhja e migrimit në numra absolut dhe relativ, 2013-2017

| Viti | Gjithsej popullsia | Rrjedhat e imig. (Numra absolut) | Rrjedhat e emig. (Numra absolut) | Net rrjedhat emig. sipas viteve | Net stoku i migrimit (Numra absolut) | Net Stoku (ne raport me shpërndarjen e popullsisë) |
|------|--------------------|----------------------------------|----------------------------------|---------------------------------|--------------------------------------|--|
| 2013 | 1,820,631 | 3,864 | 20,246 | -16,382 | 724,187 | 39.78% |
| 2014 | 1,804,944 | 5,724 | 45,333 | -39,609 | 763,796 | 42.32% |
| 2015 | 1,771,604 | 18,862 | 74,434 | -55,572 | 819,368 | 46.25% |
| 2016 | 1,783,531 | 13,072 | 22,012 | -8,940 | 828,308 | 46.44% |
| 2017 | 1,798,506 | 5,832 | 11,263 | -5,431 | 833,739 | 46.36% |

Burim: ASK

Popullata më origjinë nga Kosova që jeton jashtë vendit (Diaspora) në 2017 është llogaritur të jetë 833,739 që do të është ekuivalente me 46.36 % të popullatës që jeton në Kosovë.

Vlen të theksohet shqetësimi i viteve të fundit me dukurinë që po ballafaqohet Kosova rreth emigrimit të banorëve të të gjitha grupeve të popullsisë në veçanti ayre të nivelit me edukim të lartë. Emigrimi po ndodhë për shkak të mundësive më të mira për të bërë karrierë dhe kushteve socio-ekonomike në vendet e destinacionit, siç është evidente mjekët po emigrojnë në Gjermani. Bazuar në këtë Kosova gradualisht po ballafaqohet me fenomenin e 'Ikjes së trurit (Brain drain)' ose me humbjen e kuadrove.


B 2. ZHVILLIMET E FUNDIT MAKROEKONOMIKE

Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar në ruajtjen e një mjedisi të qëndrueshëm makroekonomik, përmirësimit të rritjes ekonomike dhe perspektivës më të mirë të punësimit. Korniza e përgjithshme e politikave të Programit për Reforma Ekonomike (PRE) është një kombinim i: (1) politikave fiskale të bazuara në rregulla të orientuara drejt stabilitetit të financave publike brenda hapësirës së disponueshme fiskale, në mbështetje të rritjes ekonomike përmes investimeve kapitale, rritjes së financimit për fushat prioritare, dhe lehtësirave tatimore për prodhuesit vendor; dhe (2) reformave prioritare, strukturore që adresojnë pengesat kryesore për rritje ekonomike, në mbështetje të zhvillimit të sektorëve

ekonomik konkurrues dhe që sigurojnë se rritja ekonomike është gjithëpërfshirëse dhe synon përmirësimin e mirëqenies¹³.

Rritja ekonomike në vazhdimësi ka shënuar rritje gjatë tërë periudhës raportuese, nga viti 2013 kur ishte 3.4% gjerë në vitin 2017 kur arriti në 4.5% të Bruto Produktit Vendor (BVP). Gjatë vitit 2014 kontribut-dhënësi më i madh në rritjen ekonomike ishte konsumi. Për dallim rritja reale e BPV në vitin 2017 ka ardhur si rezultat i rritjes së eksporteve si dhe investimeve, ku eksporti i shërbimeve ka luajtur rrolin kryesor. Vlerat nominale, në miliona euro të BPV-së për vitin 2016 respektivisht 2017 kanë qenë 6.070 respektivisht 6.345. (shih Tabelën nr. 1 në Aneks).

Figura 3: Rritja reale e BPV, parashikimi dhe pjesëmarrja sipas komponentëve 2012-2018



Burimi: ASK dhe kalkulimet e njësisë së Makroekonomisë, MF


Mund të themi se rritja e konsumit së bashku me rritjen e eksportit të shërbimeve dhe investimeve kanë qenë kontribut-dhënësit më të mëdhenj në rritjen e BPV-së kosovare, duke u mbështetur edhe nga remitencat.

Për sa i përket klimës së biznesit, Oda Ekonomike e Kosovës sipas studimit të bërë me biznese nga pesë sektorë të ekonomisë, ka bërë vlerësimin e situatës aktuale ekonomike të bizneseve, si dhe pritjet e tyre për të ardhmen e afërt. Gjetjet kryesore të nxjerra nga ky studim janë se, siç janë të kualifikuara nga kompanitë sipas pjesëmarrjes në mbulimin e sektorëve, gjendja e

¹³ Programi i Reformave Ekonomike - PRE 2018 Shqip, linku: <https://mf.rks.gov.net/desk/inc/media/3A3F7868-9B7F-4-5C6-9826-189C0629CEDD.pdf>

përgjithshme e të bërit biznes konsiderohet të jetë e favorshme për bizneset kosovare. Vlerësohet se partneriteti i shtuar mes komunitetit të biznesit dhe qeverisë, respektivisht mes Odës Ekonomike të Kosovës dhe Ministrisë së Financave dhe orientimi i kësaj të fundit në favor të bizneseve ka krijuar një ambient më të mirë dhe më të favorshëm të të bërit biznes në vend.

Figura 4: Treguesi i klimës së biznesit (TKB), vlerësimi i gjendjes aktuale: Balanca



Burimi: Oda Ekonomike e Kosovës¹⁴


B 2.1. SEKTORI FINANCIAR

Sektori financiar i Kosovës ka vazhduar të rritet edhe gjatë vitit 2017. Totali i aseteve në sektorin financiar ka shënuar rritje vjetore prej 10.5%, ku deri në shtator të vitit 2017 arriti në 5.77 miliardë euro (rreth 90% të BPV-së). Bankat përfaqësojnë 66.1% të totalit të aseteve të sektorit financiar, pasuar nga fondet e pensioneve me 27.5%, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo-bankare me 3.2% dhe kompanitë e sigurimeve me 3%.

Asetet e sektorit bankar vazhdojnë të dominojnë asetet e bankave të huaja, të cilat përbëjnë 88.3% të totalit të aseteve të sektorit bankar.

¹⁴ Klima e biznesit në Kosovë të gjeturat nga tremujori i katërt i vitit 2017, OEK shkurt 2018, linku http://www.oek-kcc.org/uploads/files/2018/May/24/Klima_e_Biznesit_n_Kosov1527168678.pdf

Figura 5: Struktura e kredive dhe norma vjetore e rritjes, 2013-2017



Burimi: BQK

Korniza fiskale - Strategjia e politikave dhe objektivat afatmesme

Qeveria e Kosovës vazhdon të ndjekë strategji konservative në politikën makroekonomike, duke synuar nivele të ulëta të deficitit buxhetor që sigurojnë rezerva të mjaftueshme buxhetore dhe shmangin akumulimin e tepruar të borxhit publik. Qëllimi i kësaj strategjie është që të ruaj një mjedis të qëndrueshëm makro-fiskal që favorizon rritjen ekonomike të nxitur nga sektori privat.

Parimi udhëheqës operativ i kësaj strategjie është ruajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i kornizës fiskale të bazuar në rregulla fiskale, duke përfshirë rregulla që kërkojnë: rishikimet buxhetore me ndikim neutral në deficit, kufizim të deficitit buxhetor në 2% të BPV-së, raport të rezervave buxhetore prej 4.5% të BPV, kurse pagat publike të jenë konstante në raport me BPV-në nominale dhe kufizim të borxhit prej 40% të BPV-së. Këto rregulla sigurojnë ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal në procesin e zhvillimit dhe ekzekutimit të buxhetit. Përveç rregullave që kufizojnë shpenzimet dhe rritjen e borxhit në përputhje me dinamikën kryesore ekonomike të vendit, Qeveria do të ruajë fleksibilitetin e politikave për të trajtuar mangësitë kyçe të infrastrukturës publike. Përjashtimi nga kufizimi i deficitit për projektet kapitale të

financuara nëpërmjet huadhënies afatgjate dhe koncesionare të donatorëve, ose atyre të financuara nga likuidimi i asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore, ofron hapësirë të mjaftueshme për të trajtuar këto mangësi brenda një kornize të kujdesshme dhe të mirëfillët fiskale.

Në këtë kontekst strategjik, objektivat fiskale afatmesme të Qeverisë janë si më poshtë:

- Të mbajë lartë nivelin e investimeve kapitale si pjesë të shpenzimeve të përgjithshme për të adresuar pengesat strukturore dhe për të rritur konkurrencën përmes përmirësimit të infrastrukturës publike;
- Racionalizimi i shpenzimeve operative dhe krijimi i hapësirës për rritjen e financimit dhe efektivitetit të institucioneve gjyqësore, shëndetësore dhe arsimore;
- Përcaktimi i financimit koncesional të borxhit të jashtëm për projektet strategjike të investimeve kapitale;
- Përmirësimi i efektivitetit të shpenzimeve sociale dhe subvencioneve bujqësore përmes targetimit më të mirë dhe testimit të mundësive brenda kornizës së shpenzimeve rrjedhëse;
- Mobilizimi i të hyrave duke zgjeruar bazën tatimore në vend të rritjes së normave tatimore statutores;
- Nxitja e eksporteve dhe zëvendësimi i importeve përmes lirimeve të tatimeve indirekte për prodhuesit vendor;
- Thjeshtëzimi i tarifave administrative dhe zvogëlimi i barrës rregullative.


Skenari makroekonomik afat-mesëm

Skenari afat-mesëm makro-ekonomik për 2018-2020 paraqet një parashikim kryesisht në vijë me rishikimin e pritshmërisë së rritjes për rajonin, BE-në dhe ekonominë botërore në përgjithësi. Rritja reale në 2018 pritet të jetë 4.6%. Kjo bazohet në pikëpamje pozitive për rritjen e eksporteve dhe investimeve, ndërkohë që rritja e konsumit parashihet të ofrojë kontributin kryesor të rritjes.

Përderisa konsumi, i udhëhequr kryesisht nga rritja e të hyrave primare dhe sekondare, pritet të jetë shtytësi kryesor i rritjes në periudhën afatmesme, roli i investimeve si një përshpejtues i rritjes pritet të rritet deri në 2020. Për 2018-2020, rritja mesatare reale projektohet të jetë 4.9%, ku rritja pritet të tejkalojë 5% më 2020.

Rishikimi më lartë i projeksioneve afat-mesme është i motivuar nga tre zhvillime kyçe: a) vrullin e lartë të rritjes në variablat kyçe makroekonomike përgjatë vitit 2017 b) një ambient i jashtëm më i favorshëm se parashikimet e mëhershme, i cili i ndikon të hyrat e disponueshme private neto të kompensimit të faktorëve të prodhimit (punëtorëve dhe kapitalit jashtë vendit), si dhe nëpërmjet kërkesës së shtuar për eksporte të mallrave dhe shërbimeve, dhe c) rritja e kredihënies, e shtyrë nga normat më të ulëta të interesit dhe përmirësimi i qasjes në financim, e cila pritet të jetë shtytësi kryesor i brendshëm për konsumin privat në skenarin afat-mesëm.

Figura 6: Kontributi në rritjen reale të BPV-së



Burimi: ASK dhe parashikimet e njësisë makroekonomike

Eksporti i shërbimeve – i cili përfaqëson 18% të BPV-së në 2017, pritet të rritet me një normë reale prej 3.5% në periudhën afatmesme. Parashikimet më optimiste të rritjes në BE ndërlidhen me kërkesë më të madhe për eksportin e shërbimeve Kosovare, sidomos në sektorin e shërbimeve të telekomunikimit. Kontribut tjetër shumë i rëndësishëm është e ndërlidhur me rritjen e shpenzimeve gjatë pushimeve të anëtarëve të diasporës Kosovare. Në tremujorin e tretë të vitit 2017, **bilanci neto i pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN)** ka arritur në -77.2 milionë euro, që është 55% më i lartë krahasuar me tremujorin e tretë të vitit të kaluar. Struktura e aseteve dominohet nga investimet në formën e borxhit që përbën rreth 40.6% të aseteve, pasuar nga portfolio e investimeve që përbën 36.7% të aseteve. Nga

ana tjetër, investimet e huaja direkte vazhdojnë të jenë kategoria më e madhe në kuadër të detyrimeve.

Parashikimi afatmesëm buxhetor

Në përputhje me parashikimin e favorshëm makroekonomik dhe një vlerësimi më të balancuar të rreziqeve ekonomike, korniza afatmesme fiskale parashikohet të zgjerohet në përputhje me parashikimet e rritjes nominale ekonomike. Të hyrat tatimore pritet të jenë mesatarisht rreth 24% të BPV-së, duke filluar nga 24.2% në 2018 dhe pastaj duke u rritur lehtësisht me 0.2 pikë përqindjeje në vitet e njëpasnjëshme. Kjo pasqyron një vlerësim konservativ të përmirësimeve të përmbushjes në krahasim me trendet historike. (*shin Tabelën 2 në Aneks*).

Parashikimet e shpenzimeve për sektorët e politikave buxhetore

Për institucionet e gjyqësorit, mbrojtjes dhe të sigurisë publike, buxheti i vitit 2018 parasheh ndarjet buxhetore në shumën prej 246 milionë eurosh apo 13% financim më të lartë krahasuar me rishikimin e buxhetit 2017. Buxheti shtesë mundëson angazhimin shtesë të gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në këtë sektor, në linjë me masat e reformave për përmirësimin e efikasitetit dhe reduktimin e lëndëve të vjetra. Në krahasim me punësimin aktual, buxheti i vitit 2018 ka krijuar hapësirë për punësimin e 690 profesionistëve shtesë në Këshillat Gjyqësor dhe Prokurorial.

Institucionet e sektorit të sigurisë publike (Ministria e Punëve të Brendshme, Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe Agjencioni Kosovar i Inteligjencës) kanë përfituar gjithashtu nga një rritje prej 13% e buxhetit të tyre, duke krijuar një hapësirë për efikasitet më të lartë në këtë sektor.

Buxheti për institucionet e sektorit shëndetësor në nivel qendror (Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimet Spitalore Universitare) është rritur me 21% krahasuar me buxhetin e rishikuar 2017. Përveç kësaj rritjeje, granti i shëndetësisë primare komunale gjithashtu u rritur me 9%. Në të njëjtën kohë, janë parashikuar kontingjenca shtesë për të filluar zbatimin e skemës së sigurimeve shëndetësore. Për herë të parë në vitin 2018, financimi i përgjithshëm për sektorin

shëndetësor tejkalon 200 milionë euro dhe pritet të vazhdojë me një trend rritës në periudhën afatmesme.

Ndarjet buxhetore për sektorin e arsimit (Ministria e Arsimit, Universitetet Publike dhe Akademia e Shkencave) janë rritur me 22% në nivel qendror. Duke pasur parasysh një rritje prej 4% të granteve komunale për arsim, shpenzimet totale publike për arsim planifikohen në 260.2 milionë euro. Shpenzimet e planifikuara shtesë për këtë sektor, përveç mbështetjes së iniciativave të reja për përmirësimin e cilësisë në arsim, përfshijnë mbulimin e mangësive të konsiderueshme në buxhetin operativ të institucioneve arsimore.

Për institucionet përgjegjëse për **përmirësimin e infrastrukturës dhe konkurrueshmërisë ekonomike**, ndarjet buxhetore të vitit 2018 u rritën me 32.8% krahasuar me rishikimin e buxhetit 2017, duke arritur në 374 milionë euro. Ky sektor i buxhetit përfshin shpenzimet e infrastrukturës publike. Nga ana tjetër, mbështetja financiare për bujqësinë është rritur me 9%, duke arritur një portofol total financimi prej 60 milionë eurosh. Ky sektor, gjithashtu vazhdon të mbështetet fuqimisht nga financimi i donatorëve. Në përgjithësi, për të mbështetur programet e zhvillimit ekonomik, buxheti i vitit 2018 parasheh shpenzime të drejtpërdrejta në shumë prej 434 milion euro. Megjithatë, duhet të theksohet se shpenzimet në drejtësi, arsim, shëndetësi, mjedis dhe qeverisje të mirë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në arritjen e objektivit të zhvillimit ekonomik.

Për të mbështetur **qeverisjen më të mirë**, ndarjet buxhetore të vitit 2018 janë rritur për sektorët e Qeverisjes së Përgjithshme, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Menaxhimit të Financave Publike. Totali i financimit për këto tre sektorë është rritur me 10%, në 149 milionë euro. Buxheti i Agjencisë Kundër Korrupsionit është 10% më i lartë se buxheti i rishikuar 2017, ndërsa buxheti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik është rritur me 9% dhe 10%, përkatësisht. Në të njëjtën kohë, buxheti është rritur gjithashtu për të mundësuar ushtrimin më efikas të funksionit të përgjithshëm të auditimit. Gjithashtu, për të mbështetur funksionimin adekuat të shërbimit diplomatik shtetëror, financimi për Ministrinë e Punëve të Jashtme është rritur.

Së fundmi, për të siguruar që rritja ekonomike është gjithëpërfshirëse dhe forcon kohezionin dhe zhvillimin shoqëror, buxheti është rritur dukshëm për institucionet **në sektorin e Punësimit dhe Çështjeve Sociale si dhe për programet sportive dhe kulturore**. Për këto dy sektorë, financimi total i buxhetit të planifikuar është rritur me 5%, nga 428 milionë në 450.2 milionë euro. Ky buxhet shtesë mbështet një rritje prej 20% të përfitimeve të mirëqenies sociale, fillimin e kompensimit të qytetarëve të lënduar në punë, trashëgiminë e përkohshme të pensioneve, përkrahjen financiare të qytetarëve paraplegjikë dhe kujdestarëve të tyre, si dhe mbështetjen financiare për viktimat e dhunës seksuale. Për veteranët e luftës, mbështetja adekuate sigurohet sipas dispozitave ligjore në fuqi, duke supozuar se reformat do të zbatohen në fund të vitit 2018. Në të njëjtën kohë, buxheti për programet kulturore dhe sportive është rritur me 36%, dhe ndër iniciativat tjera parashiheh fillimin e ndërtimit të stadiumit Kombëtar të Kosovës.

B 2.2. EKONOMIA JO-FORMALE

Qeveria e Republikës së Kosovës në janar të vitit 2014 ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare dhe Planin e Veprimit 2014-2018. Plani i Veprimit 2014-2018 i kësaj strategjie përbëhet prej treguesve kyç të performancës për fazat e ndryshme të procesit operativ të parandalimit të ekonomisë joformale dhe krimit financiar. Treguesit specifikë janë të përcaktuara për proceset e mëposhtme:

- Mbledhja e detyrueshme e tatimit të pagueshëm dhe tarifave doganore;
- Procesi i inteligjencës/zbulimit në lidhje me pastrimin e parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare;
- Hetimi i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare;
- Ndjekja penale sa i përket pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare.

Janë hartuar raportet vjetore për Parandalimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare në Kosovë (2014-2018) për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017. Të njëjta janë publikuar në ëeb faqen e MF¹⁵. Në vitin 2017 me asistencën e BE për Kosovën, projektit 'Mbështetje e Mëtejshme Institucioneve të Kosovës në Luftën Kundër

¹⁵<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/087DCC4C-8744-458B-8C52-6F23F3CC67A1.pdf>

Krimit të Organizuar, Korrupsionit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm’, u hartua ‘Vlerësim mbi shtrirjen e ekonomisë joformale në Kosovë’. Studimit i është dashur të ndjekë të njëjtën metodologji sikurse edhe në angazhimet në vitin 2007 dhe 2014 në mënyrë që të mundësohet krahasueshmëria e të dhënave dhe të arrihet në konkluzione për trendët e informalitetit në vit. Në këtë vlerësim është përdorur një mënyrë më praktike dhe rigoroze për të ardhur tek informacioni që gjendet në shkallën tatimore ligjore; është ndarë në pjesën e tatimit të paguar:

- të ardhurat nga puna
- të ardhurat nga kapitali (qiraja, interesi, fitimi)
- nga konsumi.

Ky vlerësim konkludon me një vlerësim të ekonomisë joformale siç paraqitet në këtë tabelë:


| Vlerësimi i Ekonomisë Joformale të vitit 2014 në bazë të të dhënave statistikore të vitit 2013 (pa përfshirë remitencat) | | Vlerësim për vitin 2017 në bazë të të dhënave statistikore të vitit 2015 (përfshirë remitencat) | |
|--|-------------------|---|-------------------------|
| Ekonomia gri në vlerën Abs | (Milionë €) 1,594 | Ekonomia gri në vlerën | Abs (Milionë €) 1,368.2 |
| Mbetja në vlerën Absolute | (Milionë €) 441 | Mbetja në vlerën Absolute | (Milionë €) 476 |
| Gjithsej në vlerën Absolute | (Milionë €) 2,025 | Mbetja në vlerën Absolute | Milionë €) 1,845 |
| Gjithsej në % të BPV | 32.7 | (Gjithsej në % të BPV | 31.7 |

Në periudhën 2013-2015 ka një zvogëlim të ekonomisë joformale si në vlerën absolute të BPV ashtu edhe në %, gjë e cila tregon një përmirësim në efektivitetin e praktikave të administrimit tatimor si për autoritetet tatimore ashtu edhe për ato doganore. Rezultatet në këtë fushë janë dukshëm më të mira duke konsideruar faktin se kësaj radhe kemi vendosur që në llogaritjen tonë të ekonomisë gri të përfshijmë edhe remitencat e jashtme që vijnë nga jashtë vendit. Në kontrast me këtë, mbetja ku është shumica e veprimtarisë së ekonomisë së zezë është rritur në termat absolute me 35 milionë €, ndërkohë që në termat e BPV-së, ndonëse ka pasur një rënie të lehtë, veprimtaria e ekonomisë së zezë ka mbetur në masë të madhe e pranishme derisa efekti neto i tyre ka absorbuar tkurrjen e ekonomisë gri. Kjo tregon se ka nevojë për përmirësim në fushën e zbatimit të ligjit.

B 2.3. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Investimet e huaja direkte (IHD) në Kosovë në vitin 2017 ishin 255.4 milionë euro ose 16% më të larta krahasuar me vitin paraprak. IHD-të në Kosovë gjatë periudhës 2013-2017 kanë mbajtur një nivel të ngjashëm prej mesatarisht 5% të PBB-së. Kjo është paraqitur edhe në figurën 7. Gjatë vitit 2014 IHD-të janë karakterizuar nga një trend rënës, i theksuar krahasuar me vitet paraprake. Rënia e vlerës së IHD-ve gjatë kësaj periudhe i atribuohet: kosovarizimit të disa kompanive me kapital të huaj (shitja e aksioneve nga ana e aksionarëve të huaj tek sipërmarrësit vendor), shpërndarjes së superdividendes nga disa kompani dhe kthimit të borxhit tek kompania mëmë nga ato kompani që një pjesë të investimeve në Kosovë e kanë në formë të borxhit tek kompania mëmë. Trendi i IHD-ve pati përmirësim në vitin 2015 duke arrit sërish në rreth 5% të PBB-së, por i cili trend pësoi një rënie latente në vitin 2016 ritëm i cili ka përcjellur edhe vitin 2017.

Figura 7: Investimet e huaja direkte në Kosovë në miliona euro dhe si përqindje e PBB-së, 2013-2017




Burimi: BQK, 2018

IHD-të në Kosovë gjatë vitit 2017 kryesisht janë përqendruar në sektorët si: patundshmëri me 73.3% të gjithsej IHD-ve, sektorit të shërbimeve financiare me 21.6%, sektori i shërbimeve tregtare me një pjesëmarrje prej 4%, pasuar nga sektori industrisë me 2.2% të gjithsej IHD-ve.

Siç është paraqitur në Figurën 8, vitet 2014 deri 2017 u karakterizuan me një vlerë të lartë të investimeve në patundshmëri duke mbuluar rreth 75% të gjithsej shumës së IHD-ve. Kjo kategori përbëhet kryesisht nga investime e emigrantëve në patundshmëri, rreth 85% e total

sektorit të patundshmërisë. E dhënë që përforcon rëndësinë e Diasporës në ekonominë e Kosovës dhe vëmendjen që ajo meriton.

Figura 8: Investimet e huaja direkte sipas sektorëve kryesor ekonomik, në përqindje, 2013-2017



Burimi: BQK, 2018

B 2.4. TREGTIA

Republika e Kosovës ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në, e cila ka hyrë në fuqi që nga data 1 prill 2016 dhe është pjesë e CEFTA-s që nga viti 2006. Kosova po ashtu është përfituese e Sistemit të Preferencave Tregtare Autonome nga SHBA-ja, Norvegjia, Japonia dhe Zvicra.

Partnerët kryesorë tregtar përgjatë viteve 2013-2017 kane qenë kryesisht vendet anëtare të BE-së për eksportet dhe në veçanti për importet (22.6% e eksporteve të Kosovës dhe rreth 43% të totalit të importeve në Kosovë). Vendet më të rëndësishme për eksport kane qenë: Gjermania, Holanda, Bullgaria, Austria dhe Italia kurse importi i mallrave vjen kryesisht nga Gjermania, Italia, Greqia, Polonia, Sllovenia dhe Kroacia. Tabela në vijim pasqyron trendin e bilancit tregtar përgjatë viteve 2013-2017.

Tabela 5: Bilanci tregtar 2013-2017 (në .000 eur)

| Vitet | Eksportet | Importet | Bilanci tregtar | Përqindja e mbulimit |
|-------|-----------|-----------|-----------------|----------------------|
| 2013 | 293,842 | 2,449,064 | -2,155,222 | 12% |
| 2014 | 324,554 | 2,538,232 | -2,213,678 | 12.8% |

| | | | | |
|------|---------|-----------|------------|-------|
| 2015 | 325,294 | 2,634,693 | -2,309,399 | 12.3% |
| 2016 | 309,627 | 2,789,491 | -2,479,864 | 11.1% |
| 2017 | 378,010 | 3,047,205 | -2,669,193 | 12.4% |

Burim: Banka Qendrore e Kosovës

Tregtia në Shërbime - Sektori i shërbimeve është një komponent i rëndësishëm i ekonomisë së çdo vendi, i cili jep një kontribut të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në BPV dhe krijimin e vendeve të punës, si dhe siguron inpute të rëndësishme për pjesën tjetër të ekonomisë, duke ndikuar kështu në klimën e përgjithshme të investimeve, që është një përcaktues thelbësor i rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Tregtia në shërbime në Kosovë përgjatë viteve 2013-2017 ka pasur zhvillim të vazhdueshëm dhe ka pasur një trend pozitiv në bilancin tregtar. Tabela në vijim pasqyron bilancin e shërbimeve përgjatë viteve 2013-2017.

Tabela 5: Tregtia në shërbime / bilanci 2013-2017

| Viti | Exporti i Shërbimeve <i>milion euro</i> | Importi i Shërbimeve <i>milion euro</i> | Bilanci <i>milion euro</i> |
|------|--|--|-------------------------------|
| 2013 | 875.1 | 355.1 | 520.0 |
| 2014 | 928.6 | 468.7 | 459.9 |
| 2015 | 951.5 | 494.4 | 457.1 |
| 2016 | 1,130.6 | 491.8 | 638.8 |
| 2017 | 1,330.9 | 526.8 | 804.2 |

Burim: Banka Qendrore e Kosovës

Sa i përket sektorëve kryesorë të cilët kanë kontribuar drejt një bilanci pozitiv tregtar përgjatë viteve 2013-2017 në: Udhëtimet (turizmi), i përcjell nga shërbimet qeveritare, shërbimet e komunikimit (TIK) dhe shërbimet tjera. Shërbimet e udhëtimit dhe turizmit kryesisht i atribuohen diasporës së Kosovës dhe shtetasve të huaj që punojnë në Kosovë. Tabela në vijim pasqyron sektorët kryesorë të shërbimeve përgjatë viteve 2013-2017.

Tabela 6: Eksporti i Shërbimeve: top sektorët 2013-2018

| Viti | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|------|-------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------|---|
| | <i>milio n euro</i> | <i>milio n euro</i> | <i>milio n euro</i> | <i>milio n euro</i> | <i>milio n euro</i> | <i>milio n euro (janar- qersho r)</i> |

| | | | | | | |
|--|-------|-------|-------|-------|---------|-------|
| Udhëtimi | 647.5 | 665.6 | 719.7 | 901.4 | 1,077.4 | 292.5 |
| Shërbime tjera të biznesit | 44.3 | 75.0 | 60.9 | 62.9 | 71.9 | 48.0 |
| Shërbimet kompjuterike, informative dhe te telekomunikimit (ICT) | 59.8 | 77.7 | 54.8 | 48.4 | 64.7 | 29.3 |
| Mallra dhe shërbime qeveritare | 39.0 | 34.7 | 34.8 | 35.5 | 35.8 | 18.1 |

Burim: Banka Qendrore e Kosovës

Trendi negativ i tregtisë në shërbime (sa i përket bilancit të shërbimeve) duket se çdo vit përfshinë transportin dhe shërbimet pensionale. Duke pas një bilanci pozitiv të shërbimeve ka rezultuar në zvogëlimin e deficitit të lartë tregtar në mallra.

Të bërit biznes 2013-2017 - Sipas raportit të Bankës Botërore të të bërit biznes, Kosova ka pasur një ngritje të shpejtë në renditjen e shteteve në zhvillim nga viti 2013 në vendin e 96, deri në vitin 2017 në vendin e 60 kurse në këtë vit (2018) është në vendin e 40-të. Kosova është ndër 10 vendet më atraktive në mbarë botën me përmirësimin më të dukshëm në bërjen e reformave të biznesit. Tabela në vijim përshkruan renditjen e Kosovës përgjatë viteve 2013-2017.

Tabela 7: Rënditja e Kosovës për të bërit biznes gjatë viteve

| Viti | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
|----------|------|------|------|------|------|
| Rënditja | 96 | 86 | 75 | 66 | 60 |

Burim: Banka Qendrore e Kosovës

Kjo ndikon në numrin e përgjithshëm të regjistrimit të bizneseve në Kosovë dhe numrit të bizneseve me pronarë të huaj, ku në vijim i kemi tabelat përgjatë viteve 2013-2017.

Tabela 8: Numri i përgjithshëm i bizneseve të regjistruara

| Viti | Grand Total |
|------|-------------|
| 2013 | 9,485 |
| 2014 | 9,611 |
| 2015 | 10,070 |

| | |
|--------------------|---------------|
| 2016 | 10,553 |
| 2017 | 9,335 |
| Grand Total | 49,054 |

Burim: Banka Qendrore e Kosovës

Tabela 9: Numri i bizneseve te regjistruara me pronarë të huaj


| Viti | Grand Total |
|--------------------|--------------|
| 2013 | 212 |
| 2014 | 150 |
| 2015 | 470 |
| 2016 | 674 |
| 2017 | 767 |
| Grand Total | 2,273 |

Burim: Banka Qendrore e Kosovës

B 2.5. DËRGESAT E EMIGRANTËVE (REMITANCAT)

Remitancat, në përgjithësi kanë ndikim të shumëfishtë në aspektet kryesore të zhvillimit të një vendi. Në Kosovë, të hyrat nga dërgesat e emigrantëve në pesë vitet e fundit kishin një volum që ishte mesatarisht 660 milionë euro në baza vjetore. Konkretisht në vitin 2017 remitancat në Kosovë arritën shumën prej 759 milionë euro, që krahasuar me vitin 2016 paraqet rritje prej 10%. Dërgesat e emigrantëve në vitin 2017 kanë pasur pjesëmarrje prej 12.1% në prodhimin e brendshëm bruto (PBB).


Figura 9: Trendi i hyrjeve të remitancave, 2013-2017



Burimi: BQK

Sa i përket kanaleve të dërgimit të parave nga Figura 10, mund të shihet që rreth 63.8% e dërgesave të emigrantëve transferohen përmes sistemit financiar, ndërsa pjesa tjetër përfshinë dërgesat e emigrantëve në mallra si dhe mjetet tjera që transferohen përmes kanaleve joformale. Burim kryesor i dërgesave të emigrantëve vazhdojnë të jetë Gjermania dhe Zvicra respektivisht me 37 dhe 23% të gjithsej dërgesave të pranuar në Kosovë. Italia dhe Austria përbëjnë respektivisht 5% dhe 4% të gjithsej dërgesave, pasuar nga Belgjika (2%), SHBA-të (7%) dhe Suedia (3%). Për më shumë (shih Tabelën 3 në Aneks).

Figura 10: Dërgesat e migrantëve - sipas kanaleve, në përqindje, 2013-2017




Burimi: BQK

Remitancat dalëse

Dërgesat e emigrantëve të dërguara nga Kosova kanë vlerë relativisht të moderuar që në pesë vitet e fundit kishin një rënie graduale për të arritur vlerën 50 milionë euro në vitin 2017 nga 75 milionë sa ishte në vitin 2013. Shprehur në vlera relative kemi një rënie mesatare prej 10% në baza vjetore. Rënie e cila kryesisht është ndikuar nga reduktimi i stafit në organizatat ndërkombëtare që operojnë në Kosovë.

Figura 11: Trendi i daljeve të remitancave, 2013-2017




Burimi: BQK, 2018

Shërbimet e udhëtimit të visitorëve në Kosovë

Kosova gëzon turizëm të konsiderueshëm nga diaspora, veçanërisht gjatë pushimeve sezonale të verës dhe dimrit. Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit për qëllime personale janë rritur vazhdimisht që nga viti 2013 siç mund të shihet nga Figuren 12 duke arritur në 1,077.4 milionë euro në vitin 2017, të gjitha në një kohë kur numri i vizitave në Kosovë nga agjencitë ndërkombëtare (përfshirë OJQ-të, OKB-të etj.) ka pësuar rënie. Ka shumë pak vizitorë të tjerë në Kosovë, kështu pjesa dominuese e të ardhurave të kësaj kategorie, mbi 90%, mund t'i atribuohet diasporës.


Figura 12: Shërbimet e udhëtimit në miliona euro, 2013-2017



Burimi: BQK

Rëndësia e diasporës mund të shihet edhe nga përqindja e pjesëmarrjes në prodhimin e brendshëm bruto të remitancave që paraqet rreth 11% të PBB, turizmit të diasporës me 16% dhe IHD-ve në patundshmëri 2.5%, siç edhe është paraqitur në Figurën 13. Duke pasur paraqysh që shuma e këtyre tre komponentëve përbën rreth 30% të prodhimit të brendshëm bruto, të hyrat që lidhen me migracionin janë një faktor i rëndësishëm për të mundësuar konsumin e brendshëm të vendit (konsumi plus investimet) dhe për të ndihmuar në ngritje të prodhimit vendor.

Figura 13: Të hyrat nga Diaspora si përqindje e produktit të brendshëm bruto, 2013-2017




Burimi: BQK

Kompenzimi i punëtorëve

Kategoria më e madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave vazhdon të jetë kompensimi i punonjësve, e cila gjatë vitit 2014 kishte bilanc prej 200.4 milionë euro (218.9 milionë euro gjatë vitit 2013). Ndërsa, gjatë vitit 2015 ishte 201.3 milion euro. Kjo rritje vazhdoje edhe përgjatë viteve 2016 dhe 2017 me 199.9 përkatësiht 222.6 milion euro. Kjo kategori kryesisht përbëhet nga të ardhurat e punonjësve në strukturat paralele Serbe që veprojnë në Kosovë. Kontribues tjerë janë punëtorët sezonal si dhe punonjësit në Afganistan dhe Irak.

Figura 14: Kompenzimi i punëtorëve sipas viteve, 2013-2017



Burimi: BQK

B 3. ANALIZA E TREGUT TË PUNËS

B 3.1. TREGUESIT KRYESORË TË TREGUT TË PUNËS

Legjislacioni që rregullon fushën e punësimit dhe të politikave sociale është në përputhje me legjislacionin e BE-së si dhe me parimet kryesore të së drejtës së BE-së. Shkalla e përafrimit ligjor e realizuar gjatë këtyre viteve, sipas vlerësimit të bërë në MSA, 'në përgjithësi mund të vlerësohet se është në nivelin fillestar të saj duke marrë parasysh se legjislacioni i BE-së në fushën e punësimit dhe politikave sociale është shumë i gjerë dhe voluminoz'. Plani konkret për transpozimin e mëtuftjeshëm të legjislacionit evropian është i konkretizuar në Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së.

Strukturat institucionale për shërbimet e punësimit dhe asistencen sociale janë të konsoliduara dhe në funksion të plotë. Mirëpo, këto shërbime të ofruara do të reformohen sipas ndryshimeve të reja të cilat janë në proces të zhvillimit dhe dizajnimt. Sfidë mbetet edhe me tutje kapacitetet e pamjaftueshëm të burimeve njerëzore dhe teknike.

Në nivelin e pushtetit qendror, punësimi dhe mirëqenia sociale, janë sektorë që varen nga angazhimi i shumë institucioneve dhe mekanizmave, duke filluar nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) të cilat zhvillojnë politika për rritjen dhe zhvillimin ekonomik, punësimit dhe mirëqenies sociale.

Mekanizmi kryesor për dialogun ndërmjet institucioneve qeveritare, sektorit privat dhe partnerëve social është Këshilli Ekonomik-Social (KES). Përderisa në aspektin e krijimit të politikave dhe shërbimeve operative çështjet e tregut të punës trajtohen drejtpërdrejtë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Ndërsa zabtimi i këtyre politikave në ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe aftësimin profesional ofrohen nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), e cila ka strukturë të departamenteve dhe divizioneve. Ndërsa, sa i përket ofrimin të shërbimeve, ato ofrohen kryesisht në nivelin lokal sikurse janë Zyrrat e Punësimit dhe Qendrat e Aftësimin Profesional.

Sa i përket politikave të punësimit, MPMS ndan përgjegjësi edhe me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në përpjekjet e përbashkëta për zhvillimin e shkathtësive profesionale përmes arsimit dhe aftësimin profesional si dhe harmonizimin e ofertës dhe kërkesës në tregun e punës. Në anë tjetër, MASHT përqendrohet në arsimin profesional të përgjithshëm formal, MPMS/APRK¹⁶ ofron aftësim profesional për të rritur kryesisht për punëkërkues. Dallimi qëndron në qasjen e tyre, kohëzgjatjen e aftësimin/shkollimit, dhe qëllimit që ato i shërbejnë. E para, zbatohet në arsimin e mesëm të lartë (ISCED 3) ku shkollimi dhe aftësimi zgjasin deri në 3 vite, ndërsa e dyta, përmban aftësim të orientuar kah vendi i punës (ISCED 1-3) që nuk zgjatë më shumë se 3 muaj.

Përveç të qenit prioritet politik në dokumentet strategjike të Kosovës, punësimi dhe mirëqenia sociale janë prioritet edhe i donatorëve dhe agjencive zhvillimore. Dokumenti kornizë i Bashkimit Evropian për asistencë të Kosovës¹⁷ e përcakton mbështetjen për punësimin si një ndër shtyllat kryesore të programit. Ky program synon *'rritjen e përputhjes në mes të programeve të trajnimit dhe arsimit me nevojat e tregut të punës, rritjen e gjithëpërfshirjes së sektorit të arsimit dhe tregut të punës si dhe rritjen e përfshirjes së grupeve të marginalizuara si të papunët afatgjatë, komunitetet e marginalizuara, të rinjtë dhe gratë'*. Po ashtu, Banka Botërore në dokumentin e vet kornizë për mbështetje Kosovës¹⁸ për vitet 2017-2022 përcakton si një ndër 8 objektivat e saj *'rritjen e mundësive për punësim mes grave, pakicave dhe të rinjve'*. Punësimi dhe mirëqenia sociale përcaktohen si prioritete edhe në strategjitë e partnerëve të tjerë zhvillimor.


¹⁶ APRK - Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

¹⁷ Indicative Strategy Paper 2014-2020

¹⁸ Country Partnership Framework

Tregu i punës sipas viteve - Shkalla e papunësisë në Kosovë edhe me tutje mbetet e lartë. Të dhënat e anketës së fuqisë punëtore (AFP) nga viti 2017 tregojnë që rreth 30.5% e fuqisë punëtore (apo rreth 156,500 persona) kanë qenë të papunë (113,000 meshkuj dhe 43,000 femra), rreth 2.5% më e ulët se në vitin 2015. Pjesë e madhe e këtyre të papunëve (72%), kanë qenë pa punë për më shumë se një vit.

Figura 15: Shkalla e Papunësisë sipas viteve, 2013-2017




Burimi: ASK/ Anketa e fuqisë Punëtore

Gjatë periudhës 2013-2017 duke u bazuar në Anketen e Fuqisë Punëtore paraqitet ky trend i papunësisë dhe punësimit.

Papunësia e grave - Shkalla e papunësisë së grave vazhdon të jetë mjaft e lartë ndër vite dhe bazuar në këtë vetëm gjatë vitit 2017 është 36.6%. Kur krahasohet me vitin 2016 shkalla e papunësisë ka pasqyruar rritje për 4.8%. Ndërsa kur krahasohet me vitin 2015 vlerat mbesin konstante dhe nëse krahasohet me vitet 2014 dhe 2013 kemi rënie të këtyre vlerave (shih figurën 16). Kosova përballlet me një nga normat më të ulëta të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore për gratë (20% në vitin 2017 sipas AFP).


Figura 16: Shkalla e papunësisë dhe punësimit, 2013-2017



Burimi: ASK/Anketa e Fuqisë Punëtore

Papunësia tek të rinjtë - Kosovarët e rinj kanë dy herë më pak gjasa, se sa të rritur që të punësohen. Shkalla e papunësisë tek të rinjtë ka qenë 27.4% në vitin 2017. Niveli i inaktivitetit dhe papunësisë mbeten tejet të larta edhe në mesin e të rinjve. Në vitin 2016 niveli i papunësisë tek të rinjtë ishte 52.4%¹⁹. Pjesa e të rinjve joaktivë që nuk janë të punësuar ose duke ndjekur shkollim/trajnim (NEET) është ulur gjatë viteve të fundit (30.1% në vitin 2016, nga 35.3 në vitin 2013).

Figura 17: Shkalla e papunësisë sipas viteve për të rinj, 2013-2017



Burimi: ASK/Anketa e Fuqisë Punëtore

¹⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2016 në Kosovë, 2017.

Bazuar në AFP-në e vitit 2017, 27.6% e të papunëve në Kosovë ishin të rinj (të moshës 15-24 vjeç) me 9.3 pikë diferencë midis meshkujve dhe femrave. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së re është e papunë (52.7%) dhe shkalla e papunësisë tek rinia e gjinisë femërore është më e lartë (63.5 %) krahasuar me meshkujt (48.4%).

Në vitin 2017, të rinjtë në Kosovë kishin dy herë më shumë gjasa të ishin të papunë në krahasim me të rriturit, me shifra pothuajse të ngjashme për meshkujt dhe femrat.

Shërbimet e Punësimit - adresojnë kufizimet në lidhje me ndërmjetësimin ose lidhjen midis ofertës (punëkërkuësve) dhe kërkesës (punëdhënësve) në tregun e punës. Shërbimet e punësimit janë shërbimet e ndërmjetësimit për vendet e lira të punës, këshillim për punësim²⁰ dhe këshilla në karrierë²¹. Sidoqoftë, jo të gjitha ndërmjetësimet shkojnë tek institucionet e tregut të punës. Shumë vende të punës plotësohen përmes rrjetëzimit dhe lidhjeve familjare. Sipas raportit të Bankës Botërore rreth 17% të vendeve private të punës plotësohen përmes institucioneve të tregut të punës (APRK dhe ofruesit jo-publik), përderisa të tjerat plotësohen përmes rrjetëzimeve dhe lidhjeve familjare. Punësimi nëpërmjet kanaleve joformale zvogëlon numrin e kandidatëve të disponueshëm për t'u rekrutuar nga kompanitë dhe u krijon kushte të pafavorshme atyre që nuk kanë lidhje personale ose familjare.

Shërbimet e Migracionit - Ligji Nr. 04/L-20512 përcakton qartë përgjegjësitë e Agjencisë së Punësimit për ofrimin e shërbimeve të ndryshme në lidhje me punësimin e të huajve. APRK-ja përmes divizionit përkatës jep informata dhe këshilla për të huajt të cilët imigrojnë në Kosovë për qëllime të punësimit dhe ofron shërbime për punëkërkuësit kosovarë të cilët kërkojnë punësim jashtë vendit. Edhe përmes Zyrave të Punësimit dhe Qendrave të Aftësimin Profesional janë ofruar shërbime të migrimit për punësim dhe aftësim profesional.

Ligji për Regjistrimin dhe Ofrimin e Shërbimeve për të Papunët, Punëkërkuësit dhe Punëdhënësit, rregullon shërbimet të cilat u duhen ofruar punëkërkuësve kosovarë që kanë për qëllim punësimin jashtë vendit.


²⁰ Përfshin regjistrimin, profilimizimin e papunësuarve dhe ofrimin e asistencë për të kërkuar punë, dhe informata për tregun e punës dhe trajnime, ndihmë për të motivuar klientin gjatë periudhës së kërkimit të punës etj

²¹ Këshilla në karrierë përfshin një numër të shërbimeve dhe aktiviteteve të dizajnuara për të ndihmuar individët për të menaxhuar karrierën e tyre, për të marrë vendime për arsim, trajnime dhe profesione dhe që ato të zbatohen para dhe pas inkuadrimit në tregun e punës (Cedefop, 2008).

Gjatë vitit 2017, APRK-ja ka filluar zbatimin e disa programeve për të përkrahur kosovarët që vendosin të emigrojnë për qëllime të punësimit. Po ashtu, MPMS-ja/APRK-ja në bashkëpunim me GIZ-in dhe Qendrën Informuese Gjermane për Migrim, Aftësim Profesional dhe Karrierë (DIMAK) ka vazhduar bashkëpunimin i cili përfshinë një sërë shërbimesh informuese dhe këshillimesh në fushën e migrimit. Në këtë drejtim janë nënshkruar memorandumet në vijim: Memorandum i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Landesverband Bayerischer Bauinnungen dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH Kosovo (GIZ) i datës 24 shkurt 2017 (MPMS Nr. 54 e datës 24.02.2017), që synon përmirësimin e mundësive për arsimim dhe aftësimin profesional në fushën e ndërtimit në Republikën e Kosovës. Në të njëjtën kohë, disa të rinjve nga Republika e Kosovës do t'u ofrohet mundësia të fillojnë një proces të 'arsimit dhe aftësimin profesional në sistemin dual 2-vjeçar' në Gjermani, në fushën e ndërtimit; dhe - Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Fondacionit Besa dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH Kosovo (GIZ) i datës 18 maj 2017 me të cilin synohet të përmirësohen mundësitë e migrimit qarkor dhe të lëvizshmërisë përmes përmirësimit të arsimit dhe aftësimin. Në fazat e mëvonshme, përvoja e fituar dhe kursimet mund të kontribuojnë në investimet/zhvillimin më të madh të Kosovës.

Përformanca e Shërbimit Publikë të Punësimit 2013-2017 - Ndërmjetësimi në punësim është indikator më i rëndësishëm i performancës së shërbimit publik të punësimit pasi që objektivi kryesor i tij është integrimi i klientëve në tregun e punës. Trendi i rritjes në regjistrimin e vendeve të lira të punës është që nga viti 2014 e këndeje përjashtuar vitin 2017, njëjtë mbesin edhe ndërmjetësimet në punësim (shih Figurën 18).

Figura 18: Vendet e lira dhe ndërmjetësimet në punësim sipas viteve, 2013-2017



Burimi: Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës

Zgjerimi i shërbimeve të punësimit - Si detyrë e Divizionit të shërbimeve të migracionit është edhe informimi i qytetarëve të interesuar për mënyrat e migrimit legal jashtë shtetit. Mënyra e ofrimit të shërbimit në formë të 'one stop shop' ku i njëjti zyrtar për shërbime të punësimit i ofron të gjitha shërbimet do plotësohet më tej duke zgjeruar llojin e shërbimeve dhe informatave të ofruara dhe cilësinë e tyre, me theks të veçantë ofrimin e këshillimit dhe orientimit në karrierë dhe migrimit për punë.

B 3.2. VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR PUNËSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL

Përveç kërkesës së ulët për punë dhe strukturës demografike (numrit të madh të të rinjve që hyjnë në moshë pune çdo vit), rezultatet e dobëta të punësimit tek të rinjtë janë pasojë e disa faktorëve: (i) cilësisë së dobët të arsimit në të gjitha nivelet dhe mospërputhjes së programeve arsimore me kërkesat e tregut, (ii) mungesës së punës praktike në shkollë dhe ndërmarrje, që është posaçërisht e rëndësishme në rastin e arsimit profesional, (iii) informatave të kufizuara mbi kërkesat e tregut të punës, (iv) mungesës së këshillimit dhe orientimit në karrierë²², dhe (v) mungesës së përvojës së punës dhe kontakteve (rrjetëzimit) me punëdhënës potencialë, që lidhet edhe me mungesën e punës praktike të lartcekur, të cilat e bëjnë të vështirë tranzicionin nga shkolla në punë²³. Për më tepër, në mesin e të rinjve që punojnë, më shumë se gjysma e tyre (54.8%) kanë kontratë pune.

B 3.3. NEVOJA TË SHUMËFISHTA PËR MBROJTJE SOCIALE

²² Sfidat e paraqitura në lidhje me sistemin arsimor reflektojnë edhe Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021 dhe Strategjinë e Edukimit dhe Orientimit në Karrierë 2015-2019 nga MASHT.

²³ GIZ, Promovimi i punësimit të të rinjve në Kosovë: Udhëzues për praktikuesit, 2017.

Sistemi i mbrojtjes sociale në Kosovë përfshin transfere monetare në formë të ndihmës së targetuar sociale, transfere monetare kategorike për grupe të caktuara dhe shërbime sociale dhe familjare. Skemat e transfereve monetare përfshijnë pensionet, pensionet për kategoritë e dala nga lufta dhe kategoritë tjera, skemën e ndihmës sociale, skemat për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuar dhe skemën e strehimit për fëmijët pa kujdes prindëror apo të braktisur. Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për kategoritë në vijim: fëmijët me nevoja të ndryshme sociale, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, viktimat e krimeve seksuale, personat e moshuar pa përkujdesje familjare dhe personat me aftësi të kufizuara të të gjitha moshave.

Sistemit pensional në Kosovë është i organizuar në tre shtylla. Shtylla e parë përfshinë pensionin bazë të moshës, pensionin kontribut-pagues deri më 01.01.1999, pensionet e parakohshme dhe të veçanta për kategoritë të cilat nuk kanë kontribuar në fondin pensional. Kjo shtyllë financohet nga buxheti i rregullt i shtetit. Shtylla e dytë përfshinë kursimet e obligueshme pensionale në llogari individuale në Fondin Pensional të Kosovës ku punëdhënësit dhe punëmarrësi kontribuojnë secili me nga 5% të pagës. Kjo shtyllë administrohet nga Trusti Pensional i Kosovës. Shtylla e tretë përfshinë kursimet plotësuese vullnetare, që administrohet përmes fondeve private në Kosovë (aktualisht vetëm një).

Marrëveshjet Bilaterale - Në kuadër të marrëveshjeve për sigurime sociale, është nënshkruar marrëveshja për sigurime sociale me Mbretërinë e Belgjikës. Gjithashtu, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Presidenti për nënshkrim të marrëveshjes nga Ministri i MPMS-së për marrëveshjen me Zvicrën është dorëzuar në Qeveri.

Dialogu Social - Dialogu Social është e rregulluar më Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës. Në bazë të këtij ligji janë përcaktuar kushtet, kriteret dhe procedurat e lidhjes së marrëveshjes kolektive nga partnerët social.

Dialogu Social funksion në nivel tre-palësh dhe dy-palësh. Dialogu social në nivel tre-palësh, përfshinë të gjitha llojet e negociimit dhe konsultimit ndërmjet përfaqësuesve të qeverive, punëdhënësve dhe punësuarve për çështjet që lidhen me interes të përbashkët që përfshinë politikat e nxitjes së punësimit, zbutjen e papunësisë, konkurrencën, produktivitetin e punës, çmimet, pagat dhe pagën minimale, shqyrtimin dhe vlerësimin e politikave sociale si dhe ndërmarrjen e masave për krijimin e qëndrueshmërisë sociale. Dialogu Social në nivel

tre-palësh është i strukturuar dhe funksionon sipas Ligjit Nr.04/L-008 për Këshillit Ekonomiko-Social i miratuar në vitin 2011. Me këtë ligj është rregulluar dhe përcaktuar organizimi, fushëveprimi, format e punës dhe funksionimi i përgjithshëm të Këshillit Ekonomiko-Social, si dhe përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përfaqësimin e partnerëve social në këtë organ trepalësh.

Paga minimale e përcaktuar nga Këshilli Ekonomik Social në Kosovë është 170 € bruto dhe një page minimale më të ulët për punëtorët nën moshën 35 vjet 130 € bruto.

B 4. KAPITALI NJERËZOR

B 4.1. SHKALLA /NIVELI I ARSIMIMIT

Me qëllim të hartimit të politikave arsimore të bazuara në të dhëna statistikore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovë ka krijuar Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA), përmes të cilit gjeneron të dhënat për numrin e përgjithshëm të nxënësve të përfshirë në të gjitha nivelet e arsimit para universitar, duke filluar nga niveli 0 (edukimi parashkollor-para fillor), niveli fillor (klasat 1-5), niveli i mesëm i ulët (klasat 6-9) dhe niveli i mesëm i lartë (klasat 10-12, ngase viti shkollor 2013/14 ka qenë viti i fundit ku brenda sistemit të arsimit në Kosovë ka funksionuar edhe klasa e 13-të). Po ashtu, SMIA grumbullon dhe gjeneron të dhëna edhe për nxënësit e arsimit parauniversitar në të gjitha institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës, sipas moshës dhe gjinisë (*shih Tabelën 4²⁴ në Aneks: Nnxënësit në arsimin publik dhe privat sipas niveleve dhe viteve shkollore, 2012/13-2016/17*). Gjithashtu SMIA ofron edhe të dhënat për Shkallën bruto të regjistrimit (SHBR) në nivelet arsimore (*shih Tabelën 5 në Aneks: Shkalla bruto e regjistrimit (SHBR) në nivelin e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë, 2012/13-2016/17*)


B 4.2. MUNDËSIA PËR TË HYRË NË SISTEMIN ARSIMOR

Sistemi i arsimit në Republikën e Kosovës ofron mundësi të qasjes së barabartë për të gjithë nxënësit pa dallim gjinie, race, etnie, etj. Shkollimi fillor dhe ai i mesëm i ultë (klasat 1-9) është obligativ për të gjithë nxënësit në Republikën e Kosovës, ndërsa gjithë shkollimi parauniversitar (klasat 1-12) në institucionet publike ofrohet pa pagesë për të gjithë nxënësit

²⁴ Pa të dhëna nga shkollat në gjuhën serbe

pa dallim. SMIA gjeneron të dhëna për regjistrimin e nxënësve të arsimit parauniversitar, si dhe ato të braktisjes së procesit mësimor për arsye të emigrimit duke i përpunuar të dhënat sipas nivelit të arsimit, moshës dhe gjinisë (për më shumë shih tabelen 6 në Aneks).


Figura 19: Trendi i nxënësve të larguar jashtë vendit sipas nivelit dhe vitit shkollor, 2013/14-2016/17



Burimi: MASHT-SMIA

Çështja e nxënësve të kthyer në Kosovë, e ka shtyer Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ta trajtoj këtë si një nga prioritetet e saj, me qëllim të ri-integrimit të këtyre nxënësve në sistemin arsimor, duke iu ofruar vazhdim të shkollimit pa pagesë në të gjitha nivelet e arsimit paruniverzitar. Për këtë arsye MASHT ka nxjerr edhe Udhëzimin Administrativ Nr.19/2015 i cili rregullon shkollimin e nxënësve të riadhesuar. Me qëllim të përcjelljes dhe menaxhimit të nxënësve të kthyer, SMIA gjeneron të dhëna edhe për numrin e nxënësve të riadhesuar, bazuar në moshën, gjininë dhe nivelin arsimor, (për më shumë shih tabelën 7 në Aneks).

Figura 20: Trendi i nxënësve të ardhur nga jashtë vendit sipas nivelit dhe vitit shkollor, 2013/14-2016/17




Burimi: MASH-T-SMIA

B 4.3. QASJA NË ARSIMIN E LARTË

Arsimi i lartë në Republikën e Kosovës ofrohet nga universitetet publike dhe bartësit privat të arsimit të larë. Të gjitha këto institucione e zbatojnë vullnetarisht Sistemin e Bolonjës, dhe kreditë (ECTS), edhe pse Kosova ende nuk është anëtare e Bolonjës. Në institucionet publike të arsimit të lartë ofrohen tri cilke të studimit, niveli i studimeve bazike, studime 3 vjeçare, 180 ECTS, përkatësisht studime 4 vjeçare 240 ECTS, grada bachelor, cikli i dytë, studime master studime një vjeçare, 60 ECTS, përkatësisht studime 2 vjeçare 120 ECTS, si dhe ciklin e tretë të studimeve PhD. Ndërsa bartësit privat të arsimit të lartë ofrojnë studime vetëm për ciklin e parë dhe të dytë (Figura 21).

Figura 21: Numri i studentëve në institucione publike dhe private të arsimit të lartë, 2010/11-2016/17



Burimi: MASH-T-SMIA

PJESA C: ANALIZA E GJENDJES SË MIGRIMIT NË SHETET

C 1. IMIGRIMI

C 1.1 REGJIMI I VIZAVE

Republika e Kosovës ka filluar regjimin e vizave për shtetasit e shteteve tjera me Vendimin e Qeverisë për vendosjen e Regjimit të Vizave për të huajt në Republikën e Kosovës, Nr. 12/108, të datës 14.12. 2012, i cili vendim është plotësuar dhe ndryshuar me: Vendimin Nr. 15/158, të datës 29.11.2013; Vendimin Nr. 08/167, të datës 22.01.2014.

Aplikimi i regjimit të vizave ka filluar më 1 korrik 2013, së pari për 87 shtete të ndryshme të botës, kurse pas plotësimit dhe ndryshimit të Vendimit, numri është ngritur në 88 vende të ndryshme të botës. Fillimisht gjatë periudhës së dytë të vitit 2013, procesi ka nisë të aplikohet vetëm në dy njësi të aplikimit dhe atë në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Stamboll dhe në Pikën Kufitare të Aeroportit, ndërsa viteve tjera është zgjeruar. Disa kategori të shteteve të caktuara lirohen nga nevoja për t'u pajisur me vizë hyrëse të Kosovës, siç janë:

- Shtetasit e shteteve të cilët kanë leje qëndrimi biometrik të vlefshëm, të lëshuar nga njëri nga shtetet e Zonës Shengen.
- Po ashtu bartësit e vizës shumë-hyrëse të Shengen-it të vlefshme, lirohen nga nevoja për t'u pajisur me vizë kosovare për hyrje, transit dhe qëndrimi në Kosovë dhe qëndrimi i tyre brenda Kosovës kufizohet në **15 ditë**.
- Shtetasve të: Shteteve anëtare të BE-së; Shteteve anëtare të Zonës Schengen; Selisë së Shenjtë; Principatës së Andorrës; Principatës së Monakos; Republikës së San Marinos; Republikës së Shqipërisë; Malit të Zi dhe Republikës së Serbisë iu lejohet hyrja, kalimi transit dhe qëndrimi deri në **90 ditë**, për një periudhë gjashtë (6) mujore, me letërnjoftim biometrik të vlefshme.
- Bartësit e pasaportave diplomatike dhe zyrtare të lëshuara nga shtetet e Federatës Ruse, Republikës Popullore të Kinës, Egjiptit, Indonezisë, Ukrainës iu lejohet hyrja, kalimi transit dhe qëndrimi deri në **15 ditë** në Kosovë.
- Bartësit e dokumenteve të udhëtimit të vlefshme, të lëshuara nga administratat e regjioneve të veçanta të Republikës Popullore të Kinës: Hong Kongu dhe Makao, lirohen nga nevoja për t'u pajisur me vizë.

- Bartësit e dokumenteve të udhëtimit të lëshuara nga Tajvani, lirohen nga nevoja për të aplikuar për vizë, me kusht që paraprakisht të njoftojnë Misionin Diplomatik/Konsullor të Kosovës.
- Kur dokumentet e udhëtimit të vlefshme, të lëshuara në bazë të Konventës për Statusin e Refugjatit (1951) dhe Konventës për Statusin e Personave pa Shtetësi (1954), sikurse dhe dokumentet e udhëtimit për të huaj të vlefshme, janë të lëshuara nga vendet anëtare të BE-së dhe Zonës *Shengen*, si dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë, Australisë, Japonisë, Zelandës së Re, atëherë bartësit e tyre lirohen nga nevoja për t'u pajisur me vizë kosovare për hyrje, kalim transit dhe qëndrim në Kosovë deri në 15 ditë.
- Bartësit e Dokumenteve të udhëtimit (*Laissez-Passer*) të lëshuar nga OKB, NATO, OSBE, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, janë të liruar nga procedurat për pajisje me vizë që të hyjnë në vend pa marrë parasysh shtetësinë e tyre.


Gjatë vitit 2014 sistemi i vizave është funksionalizuar edhe në 16 Misione Diplomatike/Konsullore të Republikës së Kosovës dhe ka fituar shtrirje shumë më të gjerë në krahasim me vitin 2013, ku regjimi i vizave kishte filluar të zbatohet fillimisht me pilot projektin në Konsullatën e Përgjithshme në Stamboll.

Aplikimi për vizë hyrëse të Kosovës mund të bëhet në këto Misione Diplomatike/Konsullore dhe Pika Kufitare (PK) të Republikës së Kosovës: Nju Jork, Paris, Tiranë, Shkup, Zagreb, Riad, Sofje, Vjenë, Bruksel, Londër, Stamboll, Kanbera, Berlin, Budapest, Tokio, Gjeneve, dhe Pika Kufitare Hani i Elezit, Pika Kufitare Vërmica, Pika Kufitare Aeroporti 'Adem Jashari' dhe Pika Kufitare Jarinë dhe DSHAM (për aplikimet për vazhdim të vizës).

Numri i përgjithshëm i aplikimeve në Misionet Diplomatike/Konsullore dhe pikat kufitare për vizë hyrëse të Kosovës, është 5,148 kërkesa të paraqitura, prej të cilave numri më i madh i kërkesave/aplikimeve është në konsullatën e përgjithshme në Stamboll, 1,937 aplikime, pastaj në ambasadën e Republikës së Kosovës në Tiranë, 985 dhe në ambasadën e Republikës së Kosovës në Shkup, 684 sish.

Gjatë periudhës kohore 2013-2017, gjithsej ka pasur 4,975 kërkesa për vizë hyrëse në Republikën e Kosovës të paraqitura vetëm në Misionet Diplomatike/Konsullore. Nga ky numër janë aprovuar 85% (ose 4,245) të kërkesave dhe janë refuzuar 15% (ose 730).

Figura 22: Kërkesat, aprovimet dhe refuzimet e vizave hyrëse sipas Misioneve Diplomatike/Konsullore për pesë vendet e para, 2013–2017



Burimi: MPJ

Numri më të lartë i refuzimeve për vizë hyrëse të Kosovës kaqenë për shtetasit nga Bosnja dhe Hercegovina me 124 viza të refuzuara, Siria me 121, India me 53, Iraku me 51 dhe Pakistani me 47.

Arsyeja e një përqindje më të lartë të refuzimeve për vizë për shtetasit e Bosnje dhe Hercegovinës, Sirisë dhe Indisë, sqarohet me faktin se aplikuesit nuk kanë qenë në gjendje të dëshmojnë arsyen dhe qëllimin e udhëtimit të planifikuar në Kosovë.

Përposë kërkesave për vizë hyrëse në Republikën e Kosovës të paraqitura në misionet diplomatike/konsullore, aplikime për viza hyrëse ka pasur edhe në Pikat e Kalimit Kufitar (PKK), ku gjithsej kanë qenë 146 kërkesa dhe nga ky numër të gjitha janë aprovuar.

Numrin më të madh i lëshimit të vizave ka qenë PKK Aeroportin Ndërkombëtar 'Adem Jashari'.

C 1.2 TË HUAJT QË QËNDROJNË NË KOSOVË DHE LLOJI I IMIGRANTËVE

Imigrimi i rregullt i shtetsave të huaja në Republikën e Kosovës rregullohet me Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt, i cili ka hyrë në fuqi më 5 shtator 2013. Ky ligj rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjen, qëndrimin dhe punësimin e të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Ky ligj ka filluar me procedurat e plotësimit-ndryshimit gjatë vitit 2017 me qëllim të harmonizimit me legjislacionin Evropian dhe pritet të miratohet gjatë vitit 2018.

Lejet e qëndrimit të lëshuara për të huajt sipas shtetësisë, llojet e lejeve të qëndrimit dhe kohëzgjatja

Sipas ligjit për të huajt, janë dy lloje të lejeve të qëndrimit, lejeqëndrimi i përkohshëm (lëshohet për një periudhë kohore një-vjecare me mundësi vazhdimi) dhe leje-qëndrimi i përhershëm (lëshohet për një periudhë 5-vjecare me mundësi vazhdimi). Si kategori tjetër e imigrimit të rregullt në Republikën e Kosovës është fitimi i shtetësisë, i cili rregullohet përmes Ligjit për Shtetësi, i miratuar në vitin 2013. Kategori e tretë e imigrimit janë të huajt që kanë fituar statusin e paraparë me Ligjin për Azil dhe që kanë qëndruar për një periudhë më shumë se 12 muaj.

Leje qëndrimit e përkohshme në Republikën e Kosovës

Gjatë periudhës pesëvjecare 2013–2017, janë marr gjithsej 18,042 vendime për leje qëndrime të përkohshme. Sipas gjinisë, 9,095 (50.4%) i takojnë gjinisë mashkullore dhe 8,947 (49.6%) gjinisë femërore. Kurse, sipas kategorisë, gjatë kësaj periudhe kohore janë dhënë si vijon: për bashkim familjar 7,231 (40.1%), për punë 8,494 (47.1%), për studime 957 (5.3%) dhe për arsye të tjera 1,360 (7.5%). Sipas statistikave numri i të huajve me leje qëndrim të përkohshëm, për pesë vitet e fundit pasqyron trend të rritjes nga viti në vit siç tregon (Tabela nr. 11).

Tabela 10: Lejeqëndrimet e përkohshme, sipas kategorive, 2013-2017

| Viti | B.familjar | | Punësim | | Studim | | Tjera | | Total |
|--------------|--------------|---------------|--------------|---------------|------------|--------------|--------------|--------------|---------------|
| | Nr. | % | Nr. | % | Nr. | % | Nr. | % | |
| 2013 | 962 | 46.30% | 679 | 32.70% | 128 | 6.20% | 309 | 14.90% | 2,078 |
| 2014 | 1,103 | 41.70% | 1,089 | 41.20% | 134 | 5.10% | 317 | 12.00% | 2,643 |
| 2015 | 1,435 | 41.70% | 1,565 | 45.40% | 187 | 5.40% | 257 | 7.50% | 3,444 |
| 2016 | 1,807 | 39.30% | 2,296 | 50.00% | 227 | 4.90% | 264 | 5.70% | 4,594 |
| 2017 | 1,924 | 36.40% | 2,865 | 54.20% | 281 | 5.30% | 213 | 4.00% | 5,283 |
| Total | 7,231 | 40.10% | 8,494 | 47.10% | 957 | 5.30% | 1,360 | 7.50% | 18,042 |

Burimi: DSHAM


Gjatë kësaj periudhe, numri i lejeve të qëndrimeve të përkohshme ishte në rritje të vazhdueshme (me një mesatare aritmetike prej 24.2% për vit).

Nga analiza e periudhës kohore që trajtohet, mund të vërehet që te dy grupet kryesore, 'Bashkimi Familjar' dhe 'Punësimi', ka një ndryshim që vlen të përmendet, sic është paraqitur në figurën 23.

Në vitin 2013 grupi 'Bashkimi Familjar' prinë me lejeqëndrime ndaj grupit 'Punësim' për 42%, dhe më pastaj, në vitin 2014 përfaqësimi i tyre barazohet, kurse deri në vitin 2017 përfaqësimi i grupit 'Punësimi' ndaj grupit 'Bashkimi Familjar' në mënyrë konstante rritet. Në vitin 2017 raporti krahasues mes këtyre dy grupeve është 48.9% më shumë në favor të grupit 'Punësimi'.

Bazuar në analizat e mësipërme mund të supozohet se Kosova ka ndërmarr hapat e nevojshëm për tu bërë më tërheqës për hapjen e bizneseve të reja apo për të gjetur punësim.


Figura 23: Trendi i leje-qëndrimeve të përkohshme, krahasim i kategorive 'Bashkimi Familjar'/'Punësim' (2013-2017)



Burimi: MPB/DSHAM

Për këtë periudhë, shtetet më të përfaqësuara në numrin e lejeqëndrimeve të përkohshme të dhëna janë: Turqia 5,355 (ose 29.7%), Shqipëria 3,971 (ose 22%), Serbia 2,149 (ose 11.9%), Maqedonia 1,620 (ose 9%), SHBA 1,136 (ose 6.3%), dhe shtetet tjera 3,811 (ose 21.1%).

Figura 24: Leje qëndrimet e përkohshme, sipas afatit kohor, 2013-2017




Burimi: MPB/DSHAM

Nga Figura 24, më lartë shihet qartë që kohëzgjatja 6-12 muaj është i përfaqësuar me 95% gjatë këtyre viteve. Kurse sipas shtetasve, përqindja më e madhe të leje-qëndrimeve të përkohshme me validitet 6-12 muaj janë: nga Turqia 1,733 (ose 34.3%), Shqipëria 1,177 (ose 23.3%), Serbia 572 (ose 11.3%), Maqedonia 465 (ose 9.2%), SHBA 272 (ose 5.4%), dhe shtetet tjera 832 (ose 16.5%).

Lejet e qëndrimit të përhershëm

Numri i përgjithshëm i leje-qëndrimeve të përhershme gjatë gjatë periudhës 2013-2017, kanë qenë 316. Numri i lejeqëndrimeve të përhershme gjatë periudhës kohore në fjalë është pa oscilime të mëdha, pos për vitin 2013 ku shënimet nuk janë plotësisht complete.

Figura 25: Lejeqëndrimet e përhershme të lëshuara në periudhën 2013-2017



Burimi: MPB/DSHAM


Arsyet e lëshimit të leje-qëndrimit të përhershëm janë: bashkim familjar 48 leje (15.2%), punësim me 108 sish (34.2%), studim me 19 sish (6%) dhe arsye tjera 144 sish (45.6%).

Shtetet më të përfaqësuara për nga numri i dhënë i leje qëndrimeve të përhershme janë: Serbia me 68 leje (21.5%), Turqia me 55 sish (17.4%), Gjermania me 36 sish (11.4%), Shqipëria me 31 (9.8%), Maqedonia me 22 sish (7%), dhe shtetet tjera 104 sish (32.9%).

Prodhimi i kartelave të leje qëndrimeve për të huajt

Gjatë periudhës 2013-2017, ARC ka lëshuar në përdorim dizajnin e ri të leje qëndrimeve, si obligim i dal nga Ligji Nr. 04/1-219 për të Huajt, i cili është miratuar në fund të vitit 2013. Dizajni i ri ka zëvendësuar Letërnjoftimet e Përkohshme me Leje qëndrime të Përkohshme dhe Leje qëndrime të Përhershme. Përveç emërimit dhe dizajnit që është ndryshuar, leje qëndrimet përmbajnë zonën MR (Machine-Readable Zone - MRZ), si dhe janë me identifikim elektronik d.m.th të pajisura me çipa të teknologjisë së fundit me një siguri tepër të lartë.

Figura 26: Prodhimi i leje qëndrimeve të përkohshme dhe të përhershme ne vitet, 2013-2017



Burimi: MPB/ARC

Nga figura e sipërme shihet se numri i kërkesave për prodhim të leje qëndrimeve të përkohshme është rritur në vazhdimësi, për dallim nga prodhimi i leje qëndrimeve të përhershme ku shihet se nuk ka pasur ndonjë dallim të madh nga viti në vit.

C 1.3 TË HUAJT QË KANË FITUAR DHE IU ËSHTË REFUZUAR SHTETËSIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS


Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim, përkatësisht Divizioni për Shtetësi në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është autoriteti kryesor shtetërorë përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 04/L-215²⁵ për Shtetësinë e Kosovës, përcakton mënyrat e fitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës, si dhe rregullon çështje të tjera të ndërlidhura me shtetësinë e Republikës së Kosovës. Në nenin 5 është përcaktuar mënyra e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës: me lindje, me adoptim, me natyralizim, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në bazë të neneve 31 dhe 32 të këtij ligji. Për sa i përket dhënies së shtetësisë, një pjesë e kërkesave bëhet nga persona me origjinë nga Kosova. Ligji për Shtetësi i Republikës së Kosovës që rregullon kushtet për fitimin, humbjen apo rifitimin e saj, është ndryshuar në vitin 2011 dhe në vitin 2013. Këto ndryshime kanë sjellë si pasojë lehtësira për dhënien e shtetësisë personave me origjinë të Kosovës. Ligji ka të përfshira dhe dispozita të cilat i lejojnë personat pa shtetësi të fitojnë shtetësinë e Kosovës duke respektuar procedurat ligjore.

²⁵ Të dhënat statistikore për periudhën 2013-2017 burojnë nga Ligji nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës.

Procedurat e aplikimit për fitim të shtetësisë - Parashtrimi i kërkesës për fitim të shtetësisë bëhet personalisht nga aplikuesi në Zyrën Komunale të Gjendjes Civile ku parashtruesi i kërkesës e ka pasur vendbanimin e fundit, po ashtu parashtrimi i kërkesës për fitim të shtetësisë bëhet edhe në Misionet Diplomatike - Konsullore²⁶. Kërkesës i bashkangjiten dokumentet mbështetëse të cilat kërkohen me udhëzim, varësisht sipas cilit kriter të fitimit aplikohet. Zyra e Gjendjes Civile në komunën përkatëse dhe Misionet Diplomatike - Konsullore pas aplikimit dosjet i përcjellin në MPB, përkatësisht në Divizionin e Shtetësisë.

Gjatë periudhës 2013-2017 shtetësinë e Republikës së Kosovës e kanë fituar gjithsej 1,003 persona. Nga numri i përgjithshëm që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës, prin gjinia femërore me 57% (574) në krahasim me gjininë mashkullore e cila përfaqësohet me 43% (429). Kurse sipas grup-moshw: grup-mosha 18-34 vjeç me 49% (494), grup-mosha 35-64 vjeç 37% (375) dhe grup-moshat tjera me 13.4% (134). Nga 1,003 personat, të cilët kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës gjatë periudhës 2013-2017, 75.8% (760) janë Shqiptarë, 6.5% (65) Serbë, 2.2% (22) Turq dhe 13.7% (137) kombësi të tjera.

Figura 27: Numri i personave që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës, 2013-2017



Burimi: DSHAM

Gjatë pesë viteve të fundit siç shihet në figurë, trendët e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës ka qenë proporcional vit pas viti, mirëpo në vitin 2017 kishte një rritje prej 87% të personave që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës në krahasim me vitet tjera.

²⁶ Misionet Diplomatike/Konsullore: Gjermani (Berlin, Frankfurt, Shtuttgart), Austri, Suedi, Holandë, Bullgari, Turqi (Ankara, Stamboll), Zvicër, Slloveni, SHBA, Kroaci.


Arsyeja e kësaj rritje është plotësimi i kriterëve lidhur me afatet kohore të qëndrimit të parapara me ligjet në fuqi.

C 1.4 IMIGRIMI I PARREGULLT

Shtetasit e huaj të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi

Gjatë vitit 2017 janë regjistruar gjithsejtë 2,813 refuzim të hyrjeve të personave në të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar (PKK). Ka një rritje për 2.5% në krahasim me vitin 2016 dhe 40% në krahasim me vitin 2013, ndërsa kemi një rënie për -26% në krahasim me vitin 2015 dhe -0.4% në krahasim me vitin 2014, siç shihet në figurën 28.


Figura 28: Refuzim i hyrjeve të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, 2013-2017



Burimi: Njësia e Analizës së Rrezikut, Inteligjencës dhe Administrim të Dhënave, Departamenti i Kufirit, Policia e Kosovës.

Rritja e numrit të refuzim hyrjeve ndaj të huajve në Republikën e Kosovës ka filluar me hyrjen në fuqi të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin e kushteve të hyrjes dhe Regjimit të Vizave për të huajt në Republikën e Kosovës Nr.15/158 i datës 29.11.2013, siç shihet në figurën 28. Hyrja në fuqi e këtij vendimi sa i përket totalit të refuzim hyrje ka ndikuar në rritjen e refuzim hyrjeve për shtetasit e shteteve anëtare të BE-së dhe Zonës Shengen dhe në rënie e numrit të refuzim hyrjeve për shtetasit e shteteve Aziatike dhe Afrikane, siç shihet në Figuren 29.

Figura 29: Refuzim i hyrjeve të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës sipas kontinenteve, 2013-2017




Burimi: Njësia e Analizës së Rrezikut, Inteligjencës dhe Administrim të Dhënave, Departamenti i Kufirit, Policia e Kosovës.

Arsyet për refuzim hyrje në kufi janë të ndryshme. Shtetasve të shteteve fqinje si Shqipëria, Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi iu është refuzuar hyrja për mungesë të dokumenteve të vlefshme, si dhe për shkak të ndalesave të ndryshme, ndërsa shtetasve të shteteve anëtare të BE-së dhe Zonës Shengen iu është refuzuar hyrja për arsye të mungesës së pasaportave dhe letërnjoftimeve biometrike. Përderisa shtetasve të shteteve Aziatike dhe Afrikane iu është refuzuar hyrja për arsye se nuk kanë pasur viza për të hyrë në Kosovë, apo nuk kanë pasur mjete të mjaftueshme për jetesë dhe nuk kanë mund ta justifikojnë qëllimin dhe kushtet e qëndrimit.

Kalimi i pa-autorizuar i kufirit - Gjatë vitit 2017, 132 imigrantë të parregullt e kanë kaluar kufirin e Republikës së Kosovës dhe kanë hyrë në territorin e Republikës së Kosovës, që përbën një rënie prej -56% në krahasim me vitin 2016. Periudha 2013-2015 sipas të dhënave ka pasur oscilime me një ngritje të konsiderueshme në vitin 2014 duke krahasuar me vitin 2013.

Figura 30: Numri i imigrantëve që kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar, 2013-2017



Burimi: Njësia e Analizës së Rrezikut, Inteligjencës dhe Administrim të Dhënave, Departamenti i Kufirit, Policia e Kosovës

Rritja e trendit të imigrantëve të parregullt të cilët kanë kaluar kufirin në mënyrë të paautorizuar gjatë vitit 2016, ishte si rezultat i lëvizjeve të imigrimit të parregullt në rajon (rruga Ballkanike) si dhe shfrytëzimi i rrugëve alternative përfshirë Kosovën.

Siç shihet në tabelën 8 në aneks, nga gjithsejtë 683 imigrantët e parregullt për periudhën kohore 2013-2017, 40% kanë qenë shtetas të Afganistanit, 37% Sirisë, 4% Libisë, 4% Algjerisë, 4% Pakistani, 3% Irakut, 3% Iranit, 5% të shteteve tjera. Ndërsa sa i përket përkatësisë gjinore dominojnë meshkujt siç shihet në tabelën 12. Nga viti 2014, numri i imigrantëve të parregullt i gjinisë femërore ka pasur një rritje për arsye se imigrantët e parregullt kanë filluar të lëvizin me familje, përfshirë edhe fëmijët e tyre.

Tabela 11: Të huajt që hyrë në Kosovë në mënyrë të parregullt sipas përkatësisë gjinore në përqindje, 2013-2017

| Gjinia/Viti | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
|-------------|------|------|------|------|------|
| Meshkuj | 95% | 89% | 77% | 66% | 80% |
| Femra | 5% | 11% | 23% | 34% | 20% |

Burimi: Njësia e Analizës së Rrezikut, Inteligjencës dhe Administrim të Dhënave, Departamenti i Kufirit, Policia e Kosovës

Nga rastet e trajtuara është vërejtur se imigrantët e parregullt kanë lëvizur në grupe të vogla, të ndihmuar nga kontrabandistët dhe në territorin e Republikës së Kosovës kanë hyrë kryesisht në orët e para të mëngjesit përgjatë vijës së gjelbër të kufirit me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Por një numër i vogël i imigrantëve të parregullt ka hyrë në territorin e Republikës së Kosovës përmes pikë kalimit kufitar me Maqedoninë si klandestin.


Numër i konsiderueshëm i rrugëve të pa autorizuara për kalimin e kufirit, si në afërsi të pikë kalimeve kufitare, po ashtu edhe përgjatë vijës së gjelbër të kufirit me Shqipërinë dhe Maqedoninë në hyrje, me Serbinë dhe Malin e Zi në dalje, e sidomos në ato pjesë të vijës së gjelbër të kufirit ku fshatrat janë afër vijës kufitare, terreni i përshtatshëm kodrinor-malor, janë faktorët fizik që e favorizojnë dukurinë e imigrimit të parregullt me shtetet e lartëcekura.

Duhet theksuar se imigrimi i parregullt nuk ka pasur ndikim në sigurinë e brendshme të shtetit tonë sepse vetëm një numër i vogël të imigrantëve të parregullt kanë ardhur dhe zakonisht kanë shfrytëzuar Kosovën si vend transit për të shkuar në shtetet e BE-së dhe zonës Schengen. Por me rritjen e imigrimit të parregullt, rritet edhe numrit i personave apo grupeve kriminale që merren me kontrabandën e imigrantëve dhe kjo ndikon më rritjen e dyshimeve për elemente radikale të mundshëm në mesin e imigrantëve të cilët do të tentojnë ta rrezikojnë sigurinë e brendshme të vendit tonë apo të shteteve të BE-së.

Shtetasit e huaj të cilët janë zënë me qëndrim të paligjshëm brenda territorit

Shtetasit e huaj të cilët janë zënë me qëndrim të pa ligjshëm brenda territorit të Kosovës gjatë periudhës kohore 2013-2017 ishin 479 persona. Gjatë vitit 2013-2014 numri i rasteve me qëndrim të pa rregullta ka qenë me i lartë, në krahasim me vitet 2015-2017. Arsyeja e kësaj rënie është informimi i të huajve me anë të fletushkave dhe materialit informues në lidhje me kushtet ligjore për hyrje dhe qëndrim në territorin e Republikës së Kosovës. Këto materiale informuese janë shpërndarë në të gjitha pikat e kalimit kufitar dhe kanë rezultuar me uljen e këtij numri.

Figura 31: Të huajt me qëndrim të pa rregullt sipas shtetësisë, 2013-2017



Burimi: DMH/Departamenti i Kufirit, Policia e Kosovës


Siç shihet në figurën 31, në këtë kategori dominojnë shtetas të Shqipërisë dhe Turqisë të cilët kanë qëndruar në mënyrë të pa ligjshme në Republikën e Kosovës (për më shumë shih tabelën 9 në Aneks). Nga totali në përqindje, shtetas të Shqipërisë janë 59%, Turqisë 14%, ndërsa Serbi 3%, Maqedoni 3%, Bullgaria 3%, Moldavi 1% dhe të tjera me 17%. Ndërsa sa i përket gjinisë, 81% i përkasin gjinisë femërore dhe 19% i përkasin gjinisë mashkullore.

Shtetasit të cilët janë zënë me qëndrim të pa ligjshëm brenda teritorit të Kosovës, ndaj të cilëve janë aplikuar rrethanat apo masat lehtësuese siç parashihen në ligjin për të huaj, kryesisht janë sanksionuar me gjobë, duke ju referuar neneve ku kanë bërë kundërvajtje sipas ligjit për të huaj 04/L-219.

Shtetasit e huaj me qëndrim të paligjshëm të urdhëruar të largohen vullnetarisht

Sipas të dhënave për periudhën 2014-2017, 536 shtetas të huaj janë urdhëruar të largohen nga territori i Republikës së Kosovës. Në figurën 32 janë prezantuar të dhënat sipas shtetësisë të personave të urdhëruar të largohen.

Figura 32: Të huajt të urdhëruar të largohen nga territori i Republikës së Kosovës, 2014-2017



Burimi: DSHAM/MPB

Urdhëresat për largim kryesisht ishin për shtetasit nga: Shqipëria 58% (311), Turqia 2.2% (12), Moldavia 1.9% (10), Serbia 1.3% (7), Maqedonia 1.1% (6), (156), kurse nga shtetet tjera.

Shtetasit e huaj të larguar me urdhër largimi me forcë

Departamenti i Kufirit, Policia e Kosovës/Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH), lëshon dhe ekzekuton Urdhër Largim me Forcë. Urdhër Largimi me Forcë shoqërohet me ndalim të hyrjes së të huajit në territorin e Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej një (1) muaji deri në pesë (5) vite. Kjo formë e largimit ka filluar së zbatuari që nga fillimi i vitit 2014. Urdhër Largimet me Forcë janë shqiptuar ndaj shtetasve të huaj të cilët nuk kanë respektuar urdhërin për largim vullnetar, ndaj shtetasve të huaj të cilët kanë hyrë dhe kanë qëndruar paligjshëm në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe në rastet tjera të parapara në Ligjin për të Huajt. Gjatë këtyre viteve 2014-2017, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj ka shqiptuar gjithsej 676 urdhër largime me forcë, të cilat janë ekzekutuar menjëherë duke bërë dëbimin e imigrantëve të parregullt. Ndërsa në vitin 2013 kemi deportuar ose larguar me vendim të Gjykatës gjithsej 95 shtetas të huaj.

Tabela 12: Shtetasit e huaj të larguar me urdhër largimi me forcë sipas shtetësisë, 2013-2017

| Shtetësia | Total | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
|-----------------|------------|-----------|-----------|-----------|------------|------------|
| Shqipëri | 664 | 75 | 33 | 44 | 306 | 206 |
| Maqedoni | 22 | 2 | 2 | 3 | 8 | 7 |
| Bullgari | 14 | 6 | 2 | 4 | 2 | 0 |
| Turqi | 9 | 4 | 0 | 0 | 3 | 2 |
| Indi | 6 | 0 | 0 | 6 | 0 | 0 |
| Francë | 5 | 0 | 0 | 0 | 5 | 0 |
| Shtete tjera | 51 | 8 | 3 | 3 | 15 | 22 |
| Gjithsej | 771 | 95 | 40 | 60 | 339 | 237 |

Burimi: DMH/Departamenti i Kufirit, Policia e Kosovës


Për tu mundësuar ekzekutimi i Urdhër Largimit është e nevojshme dokumentacioni përkatës për kalimin e kufirit, prandaj 95% e shtetasve që janë larguar me forcë ishin të pajisur me dokumente udhëtimi, kështu që nuk është paraqitur vështirësi në ekzekutimin e urdhër largimit me forcë, ndërsa për 5% është paraqitë nevoja për dërgimin e tyre në Qendrën e Mbajtjes për të Huaj, deri në përmbushjen e kushteve për kthimin e tyre në vendin e origjinës.

Numri më i madh i të larguarve janë imigrantë të pa rregullt nga Shqipëria me 90%, pasuar nga vendet tjera me numër të vogël që në tërësi përbëjnë 10%. Kurse në përqindje sipas shtetësisë të urdhër largimeve me forcë gjatë periudhës 2013-2017 gjithsej imigrantë të larguar janë shtetas të Shqipërisë me 86%, pasuar nga shtetasit e Maqedonisë me 3%, Bullgarisë me 2%, Turqisë me 1%, Indisë me 1%, Francës me 1%, dhe nga shtetet tjera me 6%. Ndërsa përqindja sipas përkatësisë gjinore, 56% të gjinisë femërore dhe 44% të gjinisë meshkullore. Sipas moshës, 20-34 vjec përbëjnë 60% dhe 35-75 e përbejnë 40%.

Luftimi i kontrabandimit me migrantë

Gjatë periudhës 2013-2017, ka vazhduar kontrolli sistematik dhe i hollësishëm nga Policia e Kosovës në të gjitha pikat e kalimit kufitar dhe përgjatë vijës së gjelbër të kufirit me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kontrabandës me migrantë. Po ashtu, janë luftuar edhe grupet e organizuara kriminale brenda territorit të cilat janë marrë me kontrabandë me migrantë.

Figura 33: Rastet e iniciuara për kontrabandë me migrantë, 2013-2017



Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrim të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria e Hetimit të Krimit të Organizuar, Policia e Kosovës

Numri i rasteve të iniciuara gjatë viteve 2014 dhe 2015 (65 dhe 46 respektivisht) të ndërlidhur me kontrabandë me migrantë ishte më i lartë se të gjitha vitet tjera të periudhës kohore 2013-2017. Kjo rritje mund të ndërlidhet me fluksin e emigrimit të parregullt të shtetasve Kosovare në vendet e BE-së dhe zonës Schengen (2014 dhe 2015), e cila ka rezultuar me rritjen e kontrabandës me migrantë gjatë këtyre dy viteve sic shihet në edhe nga figura 33.

Ndërsa sa i përket imigrimit të parregullt, gjatë viteve 2015 dhe 2016 Kosova ka qenë më së shumti e prekur nga kjo dukuri, kështu që numri i rasteve të iniciuara për kontrabandë me imigrantë është me i lartë se vitet tjera. Kontrabanda me emigrantë dhe imigrantë vazhdon të jetë ende prezente në vendin tonë por jo në përmasat e viteve parakrake.

Siç shihet në tabelën 14, numri i personave të dyshuar për kontrabandë me migrantë është me i lartë në vitin 2013, 2014 dhe 2015, në krahasim me vitet 2016 dhe 2017. Nga totali i 293 personave të dyshuar për kontrabandë me migrantë: 86% janë shtetas nga Kosova, 5% shtetas nga Shqipëria, 4% shtetas nga Turqia, 4% shtetas nga Serbia, dhe 1% shtetas nga Maqedonia.

Tabela 13: Shtetësia e personave të dyshuar për kontrabandë me migrantë, 2013-2017

| Shtetësia/viti | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | Total |
|----------------|------|------|------|------|------|-------|
| Kosovë | 66 | 82 | 63 | 15 | 27 | 253 |
| Shqipëri | 4 | 0 | 0 | 8 | 1 | 13 |
| Turqi | 6 | 1 | 3 | 0 | 1 | 11 |

| | | | | | | |
|-----------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|
| Serbi | 2 | 4 | 1 | 3 | 1 | 11 |
| Maqedoni | 0 | 3 | | 0 | 1 | 4 |
| Indi | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 |
| Gjithsej | 78 | 90 | 68 | 26 | 31 | 293 |

Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrim të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria e Hetimit të Krimit të Organizuar, Policia e Kosovës

Trafikimi me Qenie Njerëzore²⁷

Drejtoria e Hetimeve të Trafikimit me Qenie Njerëzore, është Drejtori e specializuar e Policisë së Kosovës e ngarkuar me përgjegjësinë e hetimit të rasteve të trafikimit me njerëz dhe veprave tjera që ndërlidhen me trafikimin. Kjo Drejtori është e strukturuar nën Divizionin Kundër Krimit të Organizuar brenda Departamentit të Hetimeve të Policisë së Kosovës, dhe ka mandat të kryej hetime dhe operacione kundër trafikimit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Identifikimi i viktimave – Shumica e viktimave të trafikimit ende gjenden/lokalizohen dhe identifikohen në lokale nate, bare, restorante, por është shfaqur edhe dukuria e identifikimit të viktimave në shtëpi private dhe apartamente.

Forma e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit në Kosovë – bazuar në rastet e hetuara, statistikat tregojnë se shfrytëzimi për prostitucion të detyruar (shërbime seksuale) është forma kryesore, kurse format tjera të shfrytëzimit të viktimave si p.sh lypësit e detyruar, punë dhe shërbime të detyruara janë më të rralla.

Drejtoria e Hetimit të Trafikimit me Qenie Njerëzore gjate periudhës 2013-2017 ka trajtuar 30 viktima të trafikimit me qenie njerëzore që ndërlidhen me imigrimin.

Tabela 14: Viktimat e trafikimit të identifikuara sipas vendit të origjinës/shtetësisë 2013-2017

| Viti | Shqipëri | Serbi | Rumani | Filipine | Moldavi | Total |
|------|----------|-------|--------|----------|---------|-------|
| 2013 | 7 | 1 | 0 | 0 | 0 | 8 |
| 2014 | 4 | 1 | 1 | 0 | 0 | 6 |
| 2015 | 4 | 1 | 0 | 0 | 0 | 5 |

²⁷ Për qëllim të këtij Profili, vetëm viktimat e huaja të trafikimit në Kosovë dhe viktimat Kosovare të trafikimit jashtë Kosovës janë marr në konsideratë.

| | | | | | | |
|-------|----|---|---|---|---|----|
| 2016 | 4 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 |
| 2017 | 5 | 0 | 0 | 1 | 1 | 7 |
| Total | 24 | 3 | 1 | 1 | 1 | 30 |

Burimi: Drejtoria e Trafikimit me Qenie Njërzore/Policia e Kosovës

Sic shihet në tabelën 15, kemi pothuajse një trend të njëjtë të kësaj dukurie për periudhën 2013-2017. Të gjitha viktimat janë të gjinisë femërore dhe të moshës madhore, ku dominuese është mosha nga 20-30 vjeçe.

Ndër viktimat e trafikimit dominojnë shtetasit nga Shqipëria me 80%, Serbia 10%, Rumania 4%, ndërsa nga Filipinet dhe Moldavia me nga 3%.

Viktimat e trafikimit nga Shqipëria, Serbia, Rumania dhe Filipine pas marrjes së shërbimeve të parapara me ligj dhe sipas procedurës standarde të veprimit (mbrojtje, siguri, strehim, kujdes shëndetësor) janë ri-atëdhësuar vullnetarisht në vendin e origjinës, ndërsa një viktimë nga Moldavia iu është mundësuar dhënja e leje qëndrimit të përkohshëm në Republikën e Kosovës në përputhje me me ligjin për të huaj dhe iu është ofruar strehim dhe shërbime të parapara sipas procedurës standarde të veprimit për personat e trafikuar.

Trafikimi me njerëz është një dukuri kriminale e ndërlikuar dhe ky krim zakonisht shoqërohet/përcillet edhe me veprime tjera kriminale, po ashtu trafikantët dhe grupet kriminale përpiqen në vazhdimësi të gjejnë mënyra dhe forma të ndryshme të kryerjes së veprës penale duke e ndryshuar modus-operandin.

Trendët e trafikimit në Kosovë – aktualisht trendët e këtij fenomeni kriminal janë duke shkuar në drejtim të organizimit të rrjeteve fleksibile të të grupeve kriminale (grupe të vogla, pa organizim të mirëfilltë).

Natyra e krimit të trafikimit me njerëz – konsiderohet se natyra e këtij krimi është konspirative/fshehur dhe se shumica e viktimave janë të kërcënuara, shantazhuara, frikësuara dhe të mashtruar duke u shfrytëzuar në mënyrë sistematike nga trafikantët, prandaj viktimat nuk vet-deklarohen (nuk i raportojnë vet rastet në polici), dhe as nuk kanë guxim të flasin për gjendjen në të cilën ndodhen edhe kur zbatuesit e tjerë të ligjit janë në kontakt dhe bisedojnë me to.

Faktorët e brendshëm – që kanë ndikuar në këtë ndryshim të trendit të trafikimit konsiderohen: nxjerrja e ligjeve të reja, ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe ligji për të huajt dhe zbatimimi i regjimit të vizave nga Kosova për 87 shtete të botës. Të gjitha këto ligje kanë ndikuar që trafikantët të kenë më të vështirë rekrutimin e viktimave nga shtetet tjera dhe transportimin dhe sjelljen e tyre në Kosovë.

Faktorët e jashtëm – po ashtu edhe këta faktorë mund të kenë ndikuar në këtë çështje si p.sh. anëtarësimi i Rumanisë dhe Bullgarisë në Bashkimin Evropian, liberalizimi i vizave nga ana e BE-së për shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe për shtetet si Molllovakia, Ukraina dhe Gjeorgjia. Sipas të dhënave të kësaj periudhe, Republika e Kosova nuk është vend i preferuar i destinacionit pasi që viktimat potenciale nga këto vende tashmë lëvizin lirshëm në vendet prëndimore.

C 1.5 AZILI DHE PËRCAKTIMI I STATUSIT TË MBROJTJES NDËRKOMBËTARE

Azil-kërkuesit në Kosovë


Procedura e azilit në Kosovë është rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-217 për Azil, i cili rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, personave me status refugjati, si dhe personave të cilëve iu është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme.

Në Republikën e Kosovës gjatë periudhës kohore 2013-2017 janë regjistruar gjithsej 691 azilkërkues, shumica e tyre nga shtetet e Lindjes së Mesme dhe shtetet nga Afrika Veriore. Sipas përkatësisë gjinore, meshkujt përfaqësohen me 523 (75.7%) kurse femrat me 168 (24.3%).

Sipas grup-moshës më e përfaqësuar është grup-mosha 18-34 vjeç me 50.2%, grup-mosha 0-13 vjeç me 24.9%, grup-mosha 35-64 vjeç me 16.5%, kurse grup-mosha 14-17 vjeç me 7.7%. Vërehet ngritja e konsiderueshme e numrit të azilkërkuesve në grup-moshën 0-13 vjeç, që mund të konkludohet se kjo grup-moshë lëviz me familjet e tyre për tu larguar nga zonat e konfliktit dhe të pasigurta (si nga Siria dhe Afganistani). Nga numri i përgjithshëm i kësaj kategorie 5.06% ishin të mitur të pashoqëruar.

Vendet kryesore të origjinës së azilkërkuesve janë: Afganistani 272 (39.4%), Siria 242 (35%), Libia 25 (3.6%), Algjeria 25 (3.6%), Pakistani 25 (3.6%), kurse shtetet tjera janë përfaqësuar me 102 (14.8%) azilkërkues (*shih Tabelën 10 në Aneks*).

Figura 34: Azil-kërkuesit në Republikën e Kosovës sipas grup-moshës, 2013-2017



Burimi: DSHAM/MPB

Në periudhën kohore 2013-2017, prej numrit të përgjithshëm të kërkesave për azil, 2% (14) iu është dhënë statusi i mbrojtjes plotësuese, 87.3% (603) ndërprerje e procedurës, 3.18% (22) ndërprerje vullnetare të procedurës, 1.9% (13) refuzim i kërkesës, 1.9% (13) refuzim sipas procedurës së përshpejtuar, dhe 3.7% (26) përfshihen kategoritë tjera.

Azilkërkuesve u janë ofruar shërbime shëndetësore të natyrave të ndryshme falas, ndihmë juridike, administrative, asistencë sociale dhe psikologjike, shujta ditore, veshmbathje, pako higjienike dhe format tjera të ndihmës fizike. Kurse të gjuhës Shqipe u janë ofruar dy herë në javë. Kohëzgjatja e qëndrimit të azilkërkuesve në Kosovë në vitin 2017 është rritur (26 ditë) krahasuar me vitin 2016 (13-14 ditë).

Trendet tregojnë se lëvizjet e migrantëve drejt shteteve perëndimore dhe rrugëtimi i tyre nga vendet e origjinës nëpër 'Rrugën Ballkanike' ka ndryshuar, gjë që reflektohet në numrin e azilkërkuesve në Republikën e Kosovës, numër i cili është dukshëm më i vogël në vitin 2017 (për 109%) krahasuar me vitin 2016.

C 2. EMIGRIMI

C 2.1 KËRKESAT PËR VIZA


Përgjatë periudhës 2013-2017, Kosova ka vazhduar të mbetet i vetmi vend në rajonin e Ballkanit Perëndimor për të cilin aplikohet regjimi i vizave në zonën Schengen. Si rrjedhojë e saj, shtetasit e Republikës së Kosovës duhet të aplikojnë për viza Schengen në Misionit Diplomatike/Konsullatat respektive të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen të akredituara në Kosovë dhe vendet e rajonit.

Sipas të dhënave të publikuara në sistemin e informimit për viza Schengen²⁸ gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 337,322 kërkesa të përgjithshme për viza, me përjashtim të vitit 2014 për të cilin vit mungojnë të dhënat, ku sipas shteteve prinë Gjermania me 34% të kërkesave (114,173), pasuar nga Zvicra me 31% (104,556), Italia me 9% (30,636), Greqia me 7% (24,044), Hungaria me 5% (17,797), Sllovenia me 5% (16,537) dhe shtetet tjera me 9% (29,579).

Figura 35: Numri i kërkesave, viza të lëshuara dhe të refuzuara sipas shteteve, 2013-2017²⁹

²⁸ www.schengenvisainfo.com, qasur me 21.11.2018

²⁹ Të dhënat për vitin 2014 mungojnë.




Burimi: Statistikat e vizave Schengen

Nga numri i përgjithshëm i aplikimeve për vizë Schengen përgjatë periudhës 2013-2017 (përfshirë vitin 2014), vendime pozitive apo viza të lëshuara janë rreth 80% (256,667).

Në anën tjetër, nga numri i përgjithshëm i kërkesave për vizë Schengen, rreth 20% (68,583) janë vendime për refuzim të vizës Schengen.

Gjatë kësaj periudhe, numri i kërkesave për vizë Schengen pothuajse ishte lineare duke u rritur për 2% duke krahasuar vitin 2017 (90,475) me vitin 2013 (88,875). Kurse vendime pozitive përgjatë këtyre viteve ishin pothuajse lineare duke u sjellur me një mesatare rreth 65,000 viza të lëshuara. Nga shiftrat e prezantuara mund të konkludohet se edhe pse në vitin 2017 ka patur më shumë kërkesa për viza Schengen, përqindja e refuzimeve ishte më e vogël (-11%) krahasuar me vitin 2013.

Figura 36: Numri i kërkesave, viza të lëshuara dhe të refuzuara sipas viteve, 2013-2017




Burimi: Statistikat e vizave Schengen

C 2.2 SHITETASIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME LEJE QËNDRIMI TË VLEFISHME NË SHITETET ANËTARE TË BE-SË DHE ZONËS SCHENGEN

Sipas të dhënave vjetore nga Eurostat-it³⁰, numri i përgjithshëm i shtetasve Kosovarë me leje qëndrim të vlefshëm në shtetet e BE-së dhe zonës Schengen në periudhën kohore 2013 - 2017, ishte 106,469 persona. Që nga viti 2013 ka një rritje graduale përjashtimisht vitit 2016 ku ka pasur rënie për - 2.2% në krahasim me vitin 2015. Për periudhën 2013-2017 numri i shtetasve Kosovarë me lejeqëndrim të vlefshëm në shtetet e BE-së dhe zonës Schengen është rritur për 16.5%.

³⁰ http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_resfirst&lang=en, Korrik 24. 2018

Figura 37: Leje qëndrimet e vlefshme të kosovarëve në shtetet e BE-së, 2013-2017




Burimi: EUROSTAT

Arsyet e marrjes së lejeve të qëndrimit të shtetasve Kosovarë në shtetet anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen janë si në vijim: bashkimi familjar 61.6% (65,623), punësim 11.6% (12,306), edukimi 3.5% (3,719), dhe kategoria të tjera 23.3% (24,821).

Nga numri i përgjithshëm i personave me leje-qëndrim të rregullt në vendet e BE-së dhe Zonës Schengen sipas shteteve prin Gjermania me 45.9% (48,866), Italia me 11.6% (12,393), Franca me 8.2% (8,760), dhe shtetet tjera (për më shumë shih Tabelën 11 në Aneks)

Figura 38: Shtetasit Kosovarë me leje qëndrimi të vlefshme në shtetet anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen sipas arsyes së qëndrimit, 2013-2017



Burimi: Eurostat

Sa i përket emigrimit të shtetasve të Republikës së Kosovës me leje-qëndrimi të vlefshme në shtetet anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen, gjatë pesë viteve të fundit vërehet një trend linear nga viti në vit, pos te kategoria Bashkimi Familjar dhe Puna. Lidhur me këtë, nga figura 38

vërehet që nga viti 2015 ndodhë ndryshimi në raport mes këtyre dy kategorive. Sa i përket kategorisë së punësimit, në periudhën dyvjeçare 2015-2017 trendi është në rritje e sipër. Në vitin 2017 ka patur rritje për 150% krahasuar me vitin 2016, kurse viti 2016 ka patur rritje për rreth dyfishit krahasuar me vitin 2015. Trendi i rritjes së theksuar së kategorisë së punësimit për rreth gjashtëfishin nëse krahasojmë vitin 2017 me vitin 2015. Kurse kategoria bashkimi familjar shënon rënie në vitin 2016 për 23.3% krahasuar me vitin 2015, kurse në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 ka patur rënie për 4.2%. Nga ana tjetër, nga viti 2015 deri në vitin 2017 ka rënie për 26.5% të kategorisë së bashkimit familjar.

C 2.3 LIRIMI NGA SHETËSIA


Sipas Ligjit për Shtetësi Nr. 04/L-215, shtetësia e Republikës së Kosovës humbet me lirim nga shtetësia, me privim të shtetësisë dhe në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Procedurat për fitimin dhe humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës dhe çështjet tjera lidhur me shtetësinë janë përcaktuar përmes Ligjit Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Republikës së Kosovës.

Gjatë periudhës 2013-2017, gjithsejtë 27,727 persona janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës.

Nga numri i përgjithshëm i lirimimit nga shtetësisë e Republikës së Kosovës sipas përkatësisë gjinore prijnë meshkujt me 53% (14,443) ndaj gjinisë femërore me 47% (12,998), kurse sipas moshës me 50% (13,596) prin grup-mosha 1-34 vjeç, me 25% (6,818) grup-mosha 35-64 vjeç kurse me 25% (7,027) grup-moshat tjera. Për më tepër, sipas shtetit (ku personi i liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës ka fituar shtetësinë e re) prin Gjermania me 85% (23,251), Austria me 9% (2,415), Holanda me 2% (527), shtetet tjera me 5%(1,248).

Figura 39: Numri i përgjithshëm i personave që janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës sipas gjinisë 2013-2017



Burimi: DSHAM/MPB

Arsyeja e heqjes dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës vjen si rezultat i fitimit të shtetësisë së ndonjë vendi kryesisht të Bashkimit Evropian i cili nuk lejon dy shtetësi për shtetasit e shteteve që nuk janë pjesë e Bashkimit Evropian.

Gjatë pesë viteve të fundit siç shihet në figurën 39, trendët e lirimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës ka qenë proporcional vit pas viti, vetëm në vitin 2016 kishte një rritje prej 21.4% të personave që janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës në krahasim me vitet tjera.

C 2.4 EMIGRANTËT E PARREGULLT


Kjo pjesë ka për qëllim të ofroj një analizë rreth emigrimit të parregullt të shtetasve nga Republika e Kosovës drejt shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, për periudhën pesë vjeçare (2013-2017) sipas: refuzimit të hyrjes në kufi ose të zënë në kufi, qëndrimit të parregullt, urdhërit për largim dhe largimit, bazuar në të dhënat dhe burimet e publikuara nga Eurostat dhe të përditësuara me 23.05.2018³¹.

³¹ <http://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>

Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose të zënë në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen

Për periudhën 2013-2017 rreth 6,865 shtetas të Republikës së Kosovës u refuzuan ose u zunë në kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen. Nga numri i përgjithshëm i refuzimeve të regjistruara, Kroacia (2,695) kishte numrin më të lartë, e përcjellur nga Franca (1,200) dhe Hungaria (775) që së bashku këto tre shtete anëtare të BE-së përbënin pothuajse tre të katërtat (68%) nga numri i përgjithshëm.

Figura 40: Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose të zënë në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, sipas shteteve, 2013-2017




Burimi: Eurostat

Shtetasit kosovarë që iu është refuzuar hyrja në BE dhe zonën Schengen, nga viti 2013 (1,465) krahasuar me vitin 2015 (1,185) ka rënë për -19%, përpara se të rritet gjatë dy viteve të njëpasnjëshme 2016 (1,300) dhe 2017 (1,600). Kryesisht refuzimet ishin në rrugët tokësore me 81% (5,056) pasuar me ato detare 4% (286) dhe ajrore 15% (1,035) (Për më shumë shih tabelën 12 në Aneks).

Arsyet kryesore për refuzimin e hyrjes në kufijtë e jashtëm të BE-së dhe zonës Schengen ishin që shtetasit Kosovarë nuk ishin në gjendje të justifikonin qëllimin dhe kushtet e qëndrimit dhe të mos posedonin një vizë ose leje qëndrimi të vlefshëm. Për periudhën e lartcekur, nga numri

i përgjithshëm, 69% (4,230) janë refuzuar të hyjnë në BE dhe zonën Schengen për arsye të vizës apo qëndrimit jo të vlefshëm.

Figura 41: Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi sipas arsyes së refuzimit, 2013-2017



Burimi: Eurostat

Kurse arsyet e tjera për refuzimin e hyrjes së shtetasve Kosovarë në kufijtë e BE-së dhe zonën Schengen ishin: dokumente jo të vlefshëm 26% (1,615), vizë apo leje qëndrimi të falsifikuar 3% (155) dhe dokumente të udhëtimit të falsifikuara 2% (100).

Figura 41 më lartë, tregon se numri i vizave apo qëndrimit jo të vlefshëm nga viti 2013, krahasuar me vitin 2015 ka rënë për -16%, kurse gjatë viteve 2016 dhe 2017 ka pasur një rritje të lehtë prej 8%, gjersa për arsye të refuzimit për dokumente jo të vlefshme ka pësuar rritje në vitin 2017 prej 42% krahasuar me vitin 2016. Gjithashtu, për dokumente të udhëtimit të falsifikuara dhe vizë apo leje qëndrimi të falsifikuar vitet paraprake tregojnë një trend linear, përveç vitit 2017 i cili tregon se ka pasur një rritje të lehtë.

Shtetas Kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen


Numri i shtetasve Kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të paligjshëm brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen për periudhën 2013- 2017 ishte gjithsej 123,415

persona. Sipas të dhënave vjetore për këtë periudhë, numri më i madh i shtetasve Kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të paligjshëm brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen ishte në: Hungari 48% (59,155), Gjermani 29% (36,240), Zvicër 7% (8,245), Austri 5% (5,705), Francë 4% (5,340), dhe shtetet tjera me 7% (8,730).

Nga numri i përgjithshëm i shtetasve të Republikës së Kosovës të zënë me qëndrim të parregullt në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen sipas gjinisë, tregon që 77% (93,760) ishin meshkuj gjersa 23% (28,670) femra.

Më shumë se gjysma nga numri i përgjithshëm, (62%) ishin të moshës 18-34 vjeç duke u përcjellë nga grup-mosha 35 vjeç e më shumë me (19%) dhe grup-mosha nën 18 vjeç me 19% (14% grup-mosha më pak se 14 vjeç dhe 5% grup-mosha 14 deri 17 vjeç).

Figura 42: Shtetasit Kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, sipas pesë shteteve kryesore, 2008-2017



Burimi: Eurostat


Figura 42 më lartë, ofron një pasqyrë të rrjedhave të të dhënave në dispozicion për shtetasit Kosovarë të cilët ishin subjekt i qëndrimit të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen. Në bazë të këtyre të dhënave, gjatë periudhës 2013-2015, trendi i shtetasve Kosovarë të cilët ishin subjekt i qëndrimit të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen u rrit për dyfishin deri në fund të muajit shkurt të vitit 2015, për të arritur shifrën më të lartën të regjistruar që nga viti 2008, përpara se të pësonte rënie të vazhdueshme nga muaji mars i po të njëjtit vit dhe gjatë dy viteve të njëpasnjëshme

2016 dhe 2017 për rreth gjashtëfishit të numrit të përgjithshëm (52,310). Kjo rritje gjatë periudhës së cekur ishte si pasojë e fenomenit të emigrimit të parregullt të Kosovarëve në drejtim të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, gjatë viti 2014 dhe 2015.

Shtetasit Kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen

Sipas të dhënave për periudhën 2013-2017, 64,280 shtetas të Republikës së Kosovës u urdhëruan të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen. Në figurën 43 paraqetet informacion për shtetasit Kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen (2013-2017). Urdhëresat për largim kryesisht ishin nga: Gjermania 33% (20,970), Franca 19% (12,315), Hungaria 9% (5,680), Austria 9% (5,670), Belgjika 8% (5,205), Suedia 6% (4,025), Zvicra 4% (2,425) dhe shtetet tjera 7% (7,990).

Figura 43: Shtetasit Kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, 2013-2017



Burimi: Eurostat


Numri i urdhër largimeve për shtetasit e Republikës së Kosovës në Gjermani ka rënë për katërfishin ndërmjet 2015 (10,625) dhe 2017 (2,160), ndërsa në Hungari për rreth trefishin (2015 prej (1,075) në 2017 (285)). Rënia e numrit të urdhër largimeve për shtetasit Kosovar vazhdoi edhe nga të gjitha shtetet e BE-së dhe zonës Schengen për dyfishin vitin 2017 (7,570) krahasuar me vitin 2015 (10,675).

Shtetasit e Republikës së Kosovës të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen në bazë të urdhrorit për largim

Të dhënat për shtetasit e Republikës së Kosovës të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen pas një urdhri për largim, tregojnë se për periudhën 2013-2017 numri i të larguarve ka qenë 49,410 persona që në krahasim me periudhën 2008-2012 (17,785) përbën një rritje prej 178%.

Nga numri i përgjithshëm i shtetasve të Republikës së Kosovës të urdhëruar të largohen pas një urdhri për largim nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe zonës Schengen në periudhën 2013-2017: 62% (30,685) u urdhëruan të largohen nga Gjermania, 7% (3,475) nga Hungaria, 7% (3,305) nga Austria, 6% (3,165) nga Suedia, 5% (2,205) nga Franca, 3% (1,330) nga Belgjika, 3% (1,565) nga Kroacia dhe 7% (3,680) nga shtetet tjera.

Figura 44: Shtetasit Kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen në bazë të urdhrorit për largim sipas shteteve dhe viteve, 2013-2017



Burimi: Eurostat

Shtetasit e Republikës së Kosovës të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen pas një urdhri për largim, nga viti 2013 (5,945) krahasuar me vitin 2015 (19,045) ka patur një rritje për rreth më shumë se trefishin, pasuar me një rënie dy viteve të njëpasnjëshme gjatë periudhës 2016 (13,295) dhe 2017 (6,285) për dyfishin krahasuar me vitin 2015. Rritja e dukshme në vitin 2015 ka qenë si pasojë e shkaktuar nga emigrimi i parregullt i qytetarëve të Republikës së Kosovës në drejtim të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen (Për më shumë shih Tabelën 15 në Aneks).

C 2.5 AZILKERKUESIT KOSOVARE NE SHTETET E BE-SE DHE ZONES SCHENGEN

Për periudhën 2013-2017, numri i kërkesave për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë³² nga shtetasit Kosovarë në shtetet anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen, ishte 134,550 persona që krahasuar me numrin e përgjithshëm të kërkesave për azili³³ (152,170) ishte për 18,000 ose (-13.1%) më i ulët.

Të dhënat sipas gjinisë për numrin e kërkesave për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë të shtetasve Kosovarë, tregojnë se kërkesat për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë kryesisht dominohen nga meshkujt, me 63% (88,010), ndërsa gjinia femërore përfaqësohet me 37% (52,405).

Sipas moshës përqindja më e madhe e kërkesave për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë ishin ndërmjet moshës 18-34 vjet me 48% (63,950), mosha më pak se 14 vjet (fëmijë) me 28% (38,140), mosha nga 35 në 64 vjet me 18% (23,915) kurse moshat tjera ishin më pak të përfaqësuara si mosha nga 14 në 17 vjet me 6% (8,080). Mosha më pak se 14 vjet me 28% e përfaqësuar në këtë periudhë tregon se fluksi i emigrimit ka qenë i përbërë edhe nga një numër i konsiderueshëm i familjeve Kosovare të cilat bënë kërkesë për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë.

Për periudhën 2013-2017, struktura e kërkesave për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë nga shtetasit Kosovarë drejt shteteve anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen ishte në: Hungari 38% (50,800), Gjermani 37% (50,005), Francë 12% (16,480), Suedia 3% (4,410), Austri 3% (4,315), dhe shtetet tjera me 7% (8,530).


Të dhënat statistikore tregojnë se numri i kërkesave për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë regjistroi një rënie të konsiderueshme deri në fund të vitit 2017 krahasuar me vitin 2015.

³² Aplikanti për herë të parë për mbrojtjen ndërkombëtare (i përkufizuar nga neni 2(h) dhe 2(i) të Direktivës së Kualifikimit 2011/95/EU) është një person që ka depozituar një aplikim për azil për HERË TË PARË në një Shtet Anëtar të caktuar. Shprehja "herë të parë" nuk nënkupton afate kohore dhe prandaj një person mund të regjistrohet si aplikant për herë të parë vetëm nëse ai ose ajo nuk ka aplikuar asnjëherë për mbrojtje ndërkombëtare në shtetin raportues në të shkuarën, pavarësisht faktit që ai rezultoi se ka aplikuar në Shtet tjetër Anëtar të Bashkimit Europian.

³³ Aplikant për azili i referohet një shtetasi të një vendi të tretë ose personi pa shtetësi që ka depozituar një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare ose që është përfshirë në një aplikim të tillë si anëtar i familjes në lidhje me të cilin nuk është marrë akoma një vendim përfundimtar gjatë periudhës së referencës.

Analiza, në këtë kontekst, bazohet në informacionet e marra nga bazat e të dhënave ndërkombëtare (Eurostat)³⁴. Sipas këtyre të dhënave, kërkesat për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë nga Kosova në shtetet anëtare të BE-së dhe Zonën Shengen, gjatë periudhës 2013-2015, u katërfishuan deri në fund të muajit shkurt të vitit 2015, për të mbërritur shifrën më të lartën të regjistruar që nga viti 2008. Kjo rritje gjatë periudhës së cekur ishte si pasojë e fenomenit të emigrimit të parregullt të Kosovarëve në drejtim të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, gjatë viti 2014 dhe 2015, e cila ka qenë kryesisht e shkaktuar për arsye ekonomike dhe sociale në vend, por edhe nga faktorët tjerë tërheqës siç mund të jenë ndryshimi i legjislacionit të azilit në Hungari gjatë vitit 2013, largimi i Kosovës nga lista e vendeve të sigurta nga ana e Francës, por edhe arsyet tjera që kanë të bëjnë me qarkullim relativisht të lehtë dhe më pak të kushtueshëm përgjatë territorit të Serbisë për në Hungari.

Figura 45: Trendi i kërkesave për azil dhe i kërkesave për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë të shtetasve Kosovarë drejt shteteve anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen, 2013-2017



Burimi: Eurostat


Nga muaji mars i vitit 2015, kërkesat për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë nga Kosova në shtetet anëtare të BE-së dhe Zonën Schengen filluan të pësojnë rënie të vazhdueshme. Kështu që gjatë dy viteve të njëpasnjëshme 2016 dhe 2017, kërkesat për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë, pësuan rënie të konsiderueshme për rreth dymbëdhjetëfishit (5,455 në vitin 2017), krahasuar me numrin e përgjithshëm (67,470) të vitit

³⁴ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database> (eurostat), e përditësuar më 24.08.2018

2015. Kjo rënie e konsiderueshme e numrit të azilkërkuesve Kosovarë në shtetet e BE-së dhe Zonën Schengen, gjatë kësaj periudhe është rezultat i masave parandaluese të ndërmarra nga autoritetet vendore si: kontrollit të forcuar në dalje në pikat e kalimit kufitar, hetimeve dhe ndjekjes së grupeve kriminale që merren me kontrabandim me migrant, fushatave të informimit dhe senzibilizimit për rreziqet dhe pasojat e migrimit të parregullt, bashkëpunimit rajonal, zbatimit efikas të politikave të ri pranimit dhe ri-integrimit, reformave qeveritare lidhur me zhvillimin socio-ekonomik dhe mirëqenien sociale. Gjithashtu ishte edhe si rezultat i masave parandaluese të ndërmarra nga shtetet e BE-së dhe zonës Schengen si: ndryshimi i politikave të azilit në vendet anëtare të BE-së (shkurtimi i kohës së shqyrtimit të procedurës së azilit) dhe unifikimi i listave të vendeve të sigurta nga shtetet anëtare të BE-së.

Të dhënat për vendimet përfundimtare pozitive, bazuar në kërkesat për mbrojtjen ndërkombëtare të shtetasve nga Kosova në shtetet anëtare të BE-së dhe Zonën Schengen, për periudhën 2013-2017 ishin gjithsej 2,570, që në krahasim me periudhën pesëvjeçare paraprake kishte një rënie të vogël prej -1.5% (2,610).

Figura 46: Trendi i vendimeve përfundimtare pozitive për shtetasit Kosovarë, 2013-2017



Burimi: Eurostat

Numri më i madh i vendimeve përfundimtare pozitive për shtetasit Kosovarë, u regjistrua në Francë me 61% (1,575) që përbënë më shumë se gjysmën e vendimeve të lëshuara të numrit të përgjithshëm, Gjermani me 20% (515), Suedi me 7% (190) dhe 12% në shtetet tjera.

Në bazë të këtyre të dhënave, gjatë periudhës 2013-2015, trendi i vendimeve përfundimtare pozitive paraqet një vijë lineare për tri vitet e fundit.

C 3. DIASPORA DHE MËRGATA

Roli i diasporës përgjatë etapave të ndryshme të historisë së Republikës së Kosovës është i rëndësishëm së veçantë. Rëndësia e diasporës në proceset e ndryshme të konsolidimit të shtetit të Republikës së Kosovës vazhdon të mbetet i pazëvendësueshëm. Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS), ka bashkëpunuar me të gjitha mekanizmat vendor dhe ndërkombëtar me qëllim të realizimit të objektivave për të përkrahur diasporën duke u përqendruar në ruajtjen e identitetit kombëtar, kulturor e arsimor, për çka janë themeluar Qendrat Kulturore të Diasporës dhe Mërgatës, si dhe institucionalizimin e mësimin plotësues, por edhe në krijimin e mekanizmave të tjerë për angazhimin më të organizuar të diasporës në zhvillimin socio-ekonomik.

Për të promovuar angazhimin e diasporës në zhvillimin socio-ekonomik, MDIS ka iniciuar themelimin e rrjeteve të bizneseve të diasporës dhe deri në fund të vitit 2017 janë themeluar 22 rrjete të bizneseve në vendet ku jeton dhe vepron diaspora jonë, të cilat bazuar në Strategjinë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018 do të mund të ndihmojnë në tërheqjen e investimeve në Kosovë dhe të jenë koordinuese të bizneseve të diasporës me bizneset të cilat veprojnë në Kosovë. Në këtë mënyrë, pritet që investitorët të jenë më të informuar lidhur me mundësinë e investimeve në Kosovë.

Procesi i regjistrimit të diasporës, ekonomive familjare dhe shoqatave, si një nga projektet me prioritet të Qeverisë, ka filluar në vitin 2014, në kuadër të këtij procesi, deri në qershor të vitit 2017 janë regjistruar 342,800 pjesëtar të diasporës. Projekti i regjistrimit të diasporës ka ofruar një pasqyrë më të saktë demografike të diasporës në botë. Përmes të dhënave që kanë dal nga ky regjistër, janë marr informata mbi arsyet e migrimit, moshën dhe gjininë e mërgimtarve, nivelin e shkollimit të tyre, punën dhe profesionet e tyre, nivelin e integritit të diasporës në shoqëritë e vendeve ku jetojnë, si dhe gjendjen e tyre ekonomike. Përmes të dhënave dhe të gjeturave nga ky regjistër, MDIS dhe institucionet e tjera në të ardhmen do të mund të hartojnë politika që kanë për qëllim promovimin e diasporës Kosovare, promovimin dhe avancimin e të drejtave politike dhe sociale të tyre dhe si promovimin e angazhimit të diasporës për zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës.

Nga rezultatet e Regjistrimit të Diasporës, rezulton se më tepër se 55% e popullatës që nuk është prezente në Republikën e Kosovës, është në mes të moshës 20 dhe 50 vjeç dhe vetëm 14% janë

50 vjeç e më tepër. Kjo do të thotë se shumica e diasporës së Kosovës përbëhet nga popullsia aktive e punës dhe ka ndikim në rritjen e remitencave që dërgohen në Kosovë, siç edhe konfirmojnë të dhënat nga BQK-ja.

Potenciali Socio-Ekonomik i Diasporës për Zhvillimin e Kosovës - Ndikimi i diasporës në zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, përkundër faktit se nuk është i drejtpërdrejtë, është i pamohueshëm. Siç është cekur edhe më lartë, remitencat që dërgohen çdo vit nga diaspora, sipas të dhënave të BQK-së shihet një trend në rritje (në vitin 2013, ishin 573.4 milion € ndërsa në vitin 2017, ishin 759.2 milion €) dhe ndikojnë në rritje të konsumit, duke e zbutur kështu deficitin tregtar të Kosovës. Për këtë arsye, me iniciativën e MDIS, në bashkëpunim me UNDP-në është bërë një studim mbi orientimin e dërgesave në zhvillim ekonomik. Hulumtimi për kanalizimin e remitencave nga konsumi në projekte të mundshme investuese, ka rezultuar se sektor me potencial më të lartë të zhvillimit për orientimin e remitencave, janë teknologjia informative dhe bujqësia. Ky program pritet që në të ardhmen të realizohet si i tillë.

Si rezultat i aktiviteteve në krijimin e rrjetit ndërkombëtar të bizneseve në diasporë dhe inicimi i krijimit të fondit të përbashkët për investim, sipas të dhënave të deritashme janë krijuar rreth 5,500 biznese të diasporës në 22 shteteve të ndryshme.

Përveç potencialit ekonomik e financiar, të cilin Republika e Kosovës e ka pranuar me vite nga diaspora dhe që ka ndihmuar edhe në rimëkëmbjen e shtetit e në avancimin e ekonomive familjare, diaspora jonë ka ende të pashfrytëzuar potencialin njerëzor e intelektual të saj. Me shfrytëzimin e projektit të regjistrimit të diasporës do të posedojmë më shumë informata lidhur me profesionet dhe profilet arsimore të pjesëtarëve të diasporës, duke iu mundësuar apo orientuar ata në fushat të cilat kërkohet ekspertiza të cilën ata e posedojnë.

Nga regjistri i diasporës pritet të dalin edhe projektet tjera të natyrës digjitale, sikurse krijimi i një baze të dhënash me profilin e profesionistëve ku do të mund të regjistrohen pjesëtarët e diasporës nga e gjitha bota dhe të kenë qasje online. Në këtë bazë të të dhënash planifikohet të ketë shkëmbim të përvojave, si dhe do të identifikohen nevojat dhe mundësitë për kontributin e ekspertëve në fusha të ndryshme dhe në këtë mënyrë synohet që të stimulohet kthimi i trurit duke i angazhuar diasporën në çështje me rëndësi për zhvillimin e vendit dhe avancimin e tyre profesional.

C 4. RIPRANIMI DHE RIINTEGRIMI I SHETASVE TË KOSOVËS TË KTHYER NGA VENDET E HUAJA

C 4.1. RIPRANIMI VULLNETAR DHE ME FORCË

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM), përkatësisht Divizioni për Ri-pranim dhe Kthim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është autoriteti kryesor shtetërorë përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 03/1-208 për Ri-pranim si dhe marrëveshjeve bilaterale të ri-pranimit. DSHAM zbaton procedurat për ri-pranimin të një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaji, i cili nuk përmbush më kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit kërkues.


Procesi i ri-pranimit/riatdhimit fillon në bazë të një urdhri zyrtar apo një vendimi gjyqësor nga një shtet pritës, që ia mohon personit apo familjes statusin ligjor në atë shtet. Pas këtij vendimi, shteti kërkues dërgon kërkesë për ri-pranim autoriteteve kompetente për verifikim nëse personi në fjalë është shtetas i Republikës së Kosovës apo i huaj i cili plotëson kushtet për ri-pranim duke u bazuar në marrëveshjet për ri-pranim apo Ligjit për Ri-pranim. Pas verifikimit të kërkesës dhe konfirmimit për ri-pranim nga autoriteti kompetent, personi mund të kthehet në vend. Në momentin e arritjes së tij/saj në aeroport, institucionet e Republikës së Kosovës varësisht nga fusha e përgjegjësisë të tyre, janë të obliguara ta pranojnë personin, të ofrojnë ndihmën e nevojshme shëndetësore, sociale apo ndonjë ndihmë tjetër ashtu siç është kërkuar nga shteti kërkues në momentin e dërgimit të kërkesës për Ri-pranim. Të ripranuarit të cilët kthehen në pikat e kalimit kufitar i takojnë kategorive të të kthyerve me forcë dhe vullnetar.

Të dhënat tregojnë se numri i të ripranuarve (me forcë dhe vullnetarë) gjatë pesë viteve të fundit është 46,053 persona. Nga ky numër të ripranuarit nga shtetet anëtare të BE-së, (vetëm në raport me shtetet me të cilat nuk ka marrëveshje bilaterale) janë 0.8%, kurse numri i të ripranuarve nga shtetet e treta (vetëm në raport me shtetet me të cilat nuk ka marrëveshje bilaterale të ripranimit) është 0.6%. Ndërsa nga shtetet anëtare të BE-së (bazuar në marrëveshjet bilaterale) janë ripranuar 91%, kurse nga shtetet e treta bazuar në marrëveshjet bilaterale janë ripranuar 8.1%. Të dhënat tregojnë se ripranimi i personave të riatdhesuar në

98% të rasteve bëhet me shtete me të cilat Kosova ka marrëveshje të ripranimit, kurse në 2% të rasteve bëhet duke zbatuar ligjin e ripranimit.

Nga numri i përgjithshëm i të ripranuarve gjatë kësaj periudhe 2013- 2017, sipas mënyrës së kthimit janë: me forcë 54.3% (25,019)³⁵ dhe vullnetar të asistuar nga IOM 45.7% (21,034)³⁶. Sipas këtyre të dhënave ka një rritje prej 16% e të ripranuarve me forcë në krahasim me ata vullnetarë.

Figura 47: Ripranimi vullnetarë dhe me forcë sipas viteve, 2013-2017



Burimi: MPB (PK), IOM

Të dhënat sipas gjinisë për numrin e të ri-pranuarve me forcë të shtetasve Kosovare tregojnë se numri i të ripranuarve kryesisht dominohet nga meshkujt me 72% (18,064), ndërsa gjinia femërore përfaqësohet me 28% (6,955). Poashtu sipas të dhënave të IOM-it, nga numri i përgjithshëm i të ripranuarve vullnetarë (21,034) dominon gjinia mashkullore me 67% (14,042), ndërsa gjinia femërore me 33% (6,992).

Në bazë të dhënave gjatë këtyre pesë viteve numri me i madh i të ripranuarve me forcë dhe vullnetarë vërehet të grup-moshat 18-34 (21,569 ose 47%) dhe 35-64 (12,029 ose 26%), poashtu edhe grup-mosha 6-13 (5,971 ose 13%) kanë numër të madh të ripranuarve dhe nga kjo nënkuptojmë se gjatë kësaj periudhe edhe numri i familjeve të kthyer ka qenë i madh. Siç

³⁵ Burimi: PK/MPB


³⁶ Burimi: IOM

vërehet në të dhënat për grup-moshat, kryesisht dominon grup-mosha aktive për punë (18-34 vjeç), e që rrjedh nga emigrimi i parregullt i viteve 2014 dhe 2015 i shkaktuar kryesisht për arsye socio-ekonomike.

Nga (tabela 17 në Aneks), lidhur me ripranimin me forcë dhe vullnetarë sipas shteteve, gjatë periudhës 2013-2017 prinë Gjermania me 63% (29,249), Zvicra me 6% (3,071), Franca me 6% (2,889), Austria me 6% (2,848) Hungaria me 4% (1,895) dhe shtetet tjera me 13% (6,194).

Në figurën 48 janë paraqitur komunat sipas numrit të të ripranuarve me forcë gjatë periudhës 2013-2017, ku prijnë komunat si në vijim: Prishtina me 11%, Podujeva me 8%, Gjlani me 7%, Mitrovica me 7%, Ferizaj me 7%, ndërsa komunat tjera me 60%.

Figura 48: Ripranimi me force sipas komunave, 2013-2017



Burimi: PK

Trendi i ripranimit gjatë periudhës 2013-2017 (shih figurën 47) ka lëviz me një mesatare rreth 9,000 persona në vit. Mirëpo, vitet 2015 dhe 2016 kanë shënuar numrin më të madh të të ripranuarve që nga viti 2008 si rezultat i emigrimit të parregullt gjatë viteve 2014 dhe 2015. Që nga viti 2016 trendi i personave të ripranuar është në rënie të vazhdueshme dhe kjo si rezultat i rënies së emigrimit të parregullt.

C 4.2 RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË RIATDHESUAR

Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR-ja) është përgjegjës për menaxhimin e riintegrit të personave të riatdhesuar, përfshirë hartimin e politikave, legjislacionit, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave të riintegrit.

Institucionet e përfshira në koordinimin e procesit për riintegrim janë: MPMS, MMPH, MSH, MASHT, MAPL, MBPZHR, bazuar në mandatin e tyre kanë përgjegjësi t'i reflektojnë politikat e riintegrit në kuadër të politikave sektoriale të tyre dhe t'u ofrojnë autoriteteve komunale mbështetje adekuate teknike, e financiare për përfshirje të personave të riatdhesuar në mekanizmat e mbrojtjes sociale dhe ekonomike brenda mandatit të tyre.

DRPR-ja koordinon procesin e riintegrit të personave të riatdhesuar me nivelin lokal, përmes koordinatorëve rajonal, të cilët së bashku me Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete bashkërendojnë procesin me drejtoritë tjera komunale për mbështetje të cilën e organizojnë si pjesë e shërbimeve komunale dhe shërbimeve tjera publike lokale, në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë ndërmjet autoriteteve lokale të mirëqenies sociale, shëndetësisë, punësimit, arsimit, banimit dhe ofruesit tjerë të shërbimeve, sipas kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Gjatë periudhës 2013-2017, Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR) në kuadër të skemave të ndryshme emergjente dhe të riintegrit të qëndrueshëm janë mbështetur 18,344 personat të riatdhesuar. Që nga viti 2015 (2,912 persona) numri i përfituesve nga programi për riintegrim ka shënuar rritje të konsiderueshme gjatë viteve 2016-2017 (10,773 persona), si rezultat i emigrimit të parregullt të Kosovarëve gjatë viteve 2014 dhe 2015, plotësim-ndryshimit të Rregullores për Riintegrim, si dhe decentralizimit të shërbimeve në kuadër të Programit për Riintegrim.

Sipas përkatësisë etnike numri më i madh i përfituesve gjatë kësaj periudhe, janë të komunitetit Shqiptarë me 58,5% (9,337), pasuar nga komuniteti Romë me 18.4% (2,934), Ashkali 13.3% (2,132), Egjiptas 3.3% (526) dhe komunitete tjera.


Ndërsa, sipas komunave të origjinës, numri më i madh i përfituesve janë nga komuna e Prishtinës me 7.8 % (1,244), Mitrovicës me 7.5% (1,205), Gjakovës me 7.1% (1,145), Fushë

Kosovës me 7% (1,130), Ferizajit me 6.7% (1,072), Podujevës me 6% (982) dhe Gjilanit me 6% (970).

Numri më i madh i personave që kanë përfituar nga skemat për riintegrim janë të riatdhesuarit nga Gjermania me 67% (10,734), Suedia me 5% (881), Franca me 5% (872), Belgjika me 5% (740), Zvicra me 4,5% (718), Austria me 3% (502) Luksemburgu 1.3% (204).

Nga skemat për Riintegrim, një kujdes më të veçantë i kushton fëmijëve dhe grupeve të cenueshme si kategori më të ndjeshme dhe gjatë kësaj periudhe, janë mbështetur mbi 600 persona të riatdhesuar për periudhën 2013 - 2017.


Figura 49: Ndihma menjëherë pas arritjes dhe ndihmat emergjente brenda 12 muajve pas riatdhesimit, 2013-2017



Burimi: DRPR/MPB

Sa i përket ndihmës emergjente nga skemat për riintegrim, gjatë vitit 2015 deri 2017 vërehet një rritje e konsiderueshme e përfituesve veçanërisht në skemën e transportit për vitin 2015 për 83% (1,895) përfitues në krahasimin me vitin 2013 (316) përfitues, po ashtu rritje rrjedhëse ka pasur edhe në skemën e akomodimit të përkohshëm si dhe paketot e ndihmës për dimër si rezultat i emigrimit të parregullt të viteve 2014 dhe 2015.

Figura 50: Ndihma për ri-integrim të qëndrueshëm, 2013-2017



Burimi: DRPR/MPB

Po ashtu, në kuadër të skemave për ri-integrim të qëndrueshëm, gjatë vitit 2016 vërehet një rritje e konsiderueshme 89.6% (615) e përfituesve në skemën e financimit të themelimit të bizneseve në krahasim me vitin 2015 (64) përfitues, ndërsa në skemën e punësimit në vitin 2017 kemi një rritje për 98,8% (350) përfitues në krahasimin me vitin 2014 (4) përfitues. Gjithashtu ka pasur edhe në skemat aftësimin profesional, trajnimin për punë, dhe shërbime tjera (shih figurën 50).

C 5. PERSONAT E ZHVENDOSUR BRENDA VENDIT DHE JASHTË VENDIT

Kthimet Vullnetare

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) sipas mandatit të saj në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, synon të arrijë kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur brenda dhe jashtë vendit si dhe lehtësimin e integritimit dhe stabilizimin e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Tabela e mëposhtme përshkruan kthimet vullnetare nga zhvendosja në Malin e Zi, Serbi, Maqedoni dhe brenda Kosovës për vitet 2013-2017.

Tabela 15: Të kthyerit vullnetar të raportuar nga UNHCR, 2013-2017

| Etnitetet | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | Total | % |
|--------------------|------------|------------|------------|------------|------------|-------------|------------|
| Shqiptarë | 103 | 50 | 20 | 39 | 11 | 223 | 6.71 |
| Ashkali/Egjiptianë | 202 | 151 | 221 | 159 | 159 | 892 | 26.85 |
| Boshnjakë | 40 | 9 | 18 | 11 | 2 | 80 | 2.41 |
| Romë | 132 | 55 | 85 | 66 | 171 | 509 | 15.32 |
| Goran | 2 | 21 | 23 | 0 | 1 | 47 | 1.42 |
| Serb | 345 | 398 | 429 | 299 | 148 | 1549 | 46.63 |
| Tjerë | 1 | 1 | 6 | 8 | 6 | 22 | 0.66 |
| Gjithsej | 825 | 685 | 802 | 582 | 498 | 3322 | 100 |

Burimi: UNHCR

Në mesin e Personave të Zhvendosur, disa nga problemet që lidhen me procesin e kthimit janë: periudha e gjatë e marrjes së vendimit, proceset e përzgjedhjes, mungesa e infrastrukturës, mbështetja e institucioneve (në fushën socio-ekonomike). Gjithashtu, në varësi të vendndodhjes së kthimit, janë theksuar edhe çështjet e sigurisë dhe të sundimit të ligjit, me theks të veçantë për komunitetet që jetojnë në veri të Kosovës.

Përveç kësaj, gatishmëria për t'u kthyer është kushtëzuar me: mundësinë e punësimit, çështjen e zënies të pronave, përdorimin e gjuhës dhe çështjen e sigurisë. Lidhur me alternativën për vendin e origjinës, Personat e Zhvendosur kanë theksuar gatishmërinë e tyre për t'u kthyer në vende të tjera (vendet me koncentrim më të madh të një komuniteti), megjithatë moshë dhe

niveli i integritit të të kthyerve të mundshëm/ardhshëm në vendin prej nga janë zhvendosur janë të gjithë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në gatishmërinë për tu kthyer.

Është e rëndësishme të theksohet se kriteret e pranueshmërisë dhe prioritizimit të ndihmës, sipas rregullave dhe rregulloreve të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK), bazohen në statusin e zhvendosjes, cenueshmërisë dhe zotërimit të pronës, ndër faktorët e tjerë. Për shembull, një nga kriteret e pranueshmërisë/prioritizimit të ndihmës është zotrimi i pronës në vendin e zhvendosjes dhe 33% e të zhvendosurve (të gjithë në Serbi) posedojnë objekte banimi në vendin e zhvendosjes. Si pasojë, 465 familje që zotrojnë prona në vendin e zhvendosjes nga 1,278 që dëshirojnë të kthehen, nuk do të jenë prioritet për ndihmë në banim.

Moshat më të vjetra të Personave të Zhvendosur kanë shprehur gatishmërinë për të qëndruar në Kosovë. Nga ana tjetër, brezat e rinj nuk shohin një të ardhme në Kosovë. Gatishmëria për të qëndruar në Kosovë ndryshon tek grup-moshat dhe komunitetet e ndryshme.

Disa pika rekomandimi janë paraqitur më poshtë:

- Perspektiva e punësimit luan një rol shumë të rëndësishëm (sidomos për brezat e rinj);
- Zgjidhja e çështjes së banimit kryesisht për familjet Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të cilët janë të gatshëm të kthehen dhe të qëndrojnë, por çështjet që ndërlidhen me alokimin e tokës nga ana e Komunave përkatëse kanë ngecur;
- Investime infrastrukturore në zonat e banuara me komunitetet pakicë (ndriçimi i rrugëve, sistemet e ujërave të zeza, furnizimi me ujë). Pjesëtarët e komunitetit lokal që nuk kanë lëshuar vendin janë shprehur të lumtur me vetë faktin që jetojnë në shtëpitë e tyre;
- Vizitat nga zyrtarët komunalë dhe palët e tjera të interesuara kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm për kthimin. Gjërat ushqimore dhe jo-ushqimore të ofruara si ndihmë nga palët e ndryshme kanë qenë të mirëpritura.

Shtëpitë e ndërtuara dhe të banuara gjatë periudhës 2013-2017

Raportet e MKK-së tregojnë se gjatë periudhës 2013-2017 janë ndërtuar 235 shtëpi dhe 75 banesa (financuar nga MKK-ja), ndërsa 281 shtëpi dhe 69 renovime të vogla (financuar nga akterë të jashtëm, kryesisht zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Ambasada Britanike si dhe Ambasada Amerikane në Beograd).

Tabela 16: Shtëpitë e ndërtuara nga MKK-ja dhe akterët e jashtëm, 2013-2017

| Shtëpitë e ndërtuara | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | Total |
|-------------------------------|------------|------------|------------|------------|-----------|------------|
| MKK | 127 | 66 | 10 | 76 | 31 | 310 |
| EU/IOM | 30 | 0 | 118 | 49 | 7 | 204 |
| EU/UNHCR | 0 | 30 | 31 | 0 | 0 | 61 |
| Amb.Britaneze /DRC | 0 | 7 | 12 | 17 | 8 | 44 |
| Amb.Amerikane në Beograd/ DRC | 19 | 8 | 7 | 0 | 7 | 113 |
| Gjithsej | 176 | 111 | 178 | 142 | 53 | 660 |

Burimi: UNHCR

Qendrat kolektive

Në bazë të raporteve të UNHCR-së në fund të vitit 2017, në Kosovë ende ka pasur 464 PZHBV dhe refugjatë të vendosur në 28 qendra kolektive. *Tabela 18 në Aneks* paraqet Qendrat Kolektive në Kosovë.

Projekti i ndërtimit të ndërtesave në Komunën e Shtërpcës për të gjithë personat që gjenden në Qendra Kolektive në këtë Komunë, është në zbatim e sipër. Bashkimi Evropian ka ndarë fondet për këtë projekt ndërsa zbatimi bëhet nga Këshilli Danez për Refugjatë (DRC-ja) dhe parashihet që në 2018 të përfundoj.

PJESA D: POLITIKAT DHE PROGRAMET E MIGRIMIT DHE EFEKTIVITETI I TYRE NË MENAXHIMIN E MIGRIMIT DHE SFIDAVE TË ZHVILLIMIT

D 1. KORNIZA E POLITIKAVE DHE LIGJEVE NË FUSHËN E MIGRIMIT NË KOSOVË

Gjate periudhës 2013-2017, Republikës e Kosovës ka ndërmarr një varg reformash që kishin për qëllim avancimin e mekanizmave për menaxhimin e migrimit, si dhe parandalimin dhe zvogëlimin e efekteve negative që burojnë nga migrimi i parregullt si dhe promovimin e migrimit për qëllim të zhvillimit ekonomik të vendit. Në këtë aspekt, Republika e Kosovës ka ndërmarrë një sërë veprimesh duke hartuar dhe miratuar një numër ligjesh dhe aktesh nënligjore, dokumente strategjike dhe dokumente të tjera që ndërlidhen me këtë fushë.

Në mesin e këtyre politikave vlen të veçohen Ligji për Azil, Ligji për të Huaj, Ligji për Kontrollin e Kufirit, Ligji për Shtetësi, Ligji për Ri-pranim, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Ligji për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit si dhe aktet nënligjore që burojnë nga ligjet e përmendura më lart. Po ashtu, janë hartuar dhe miratuar strategjitë për periudhën kohore 2013 – 2018 si në vijim: Strategjia për Migracion, Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Strategjia për Luftimin e Trafikimit me Njerëz, Strategjia për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën. Vlen të theksohet së gjatë vitit 2017 ka filluar procedura për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve si në vijim: Ligji për Azil, Ligji për të Huaj, Ligji për Kontrollin e Kufirit, me qëllim të harmonizimit me Acquis të BE-së, për arsye se nga viti 2014 deri në vitin 2017 janë ndryshuar një sërë aktesh normative të BE-së.

D 1.1. KORNIZA E POLITIKAVE

Republika e Kosovës ka zhvilluar politikat dhe dokumentet strategjike në fushën e migrimit, duke përfshirë ato që adresojnë menaxhimin e integruar të kufirit, parandalimin e migrimit të parregullt, aspektet zhvillimore dhe lidhen me migrimin, rolin e diasporës, ripranimin,

riintegrimin e personave të riadhesuar, si dhe luftimin dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, të cilat dokumente janë të listuara si në vijim:

Strategjia Shtetërore për Migrim dhe Plani i Veprimit 2013 - 2018³⁷ është dokumenti kryesor nacional i politikave për fushën e migrimit. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj strategjie është avancimi i një sistemi transparent dhe efektiv për menaxhimin e migrimit të rregullt, si dhe parandalimin të gjitha formave të migrimit të parregullt. Strategjia dhe plani i veprimit parasheh masa specifike për krijimin e kapaciteteve dhe strukturave administrative përgjegjëse për parandalimin e migrimit të parregullt, promovimin e migrimit të rregullt dhe qarkor dhe transformimin e migrimit në faktorë të zhvillimit ekonomik të vendit.

Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën, si dhe Plani i Veprimit 2013 - 2018³⁸, si dokument i parë strategjik nëpërmjet së cilës synohet të sigurohen avancimi i të drejtave politike e sociale të diasporës, ruajtja e identitetit kulturor e gjuhësor të diasporës, shmangia e asimilimit, ndihma për integrimin në vendet ku jetojnë dhe lehtësira maksimale ligjore e administrative për ata që duan ta ndihmojnë zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Strategjia Nationale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2015 - 2019, është dokumenti kryesor nacional i politikave për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz. Strategjia ka për qëllim të avancojë koordinimin dhe harmonizimin e veprimeve ndër-institucionale, të intensifikojë ndjekjen ligjore dhe ndëshkimin e shkelësve të ligjit, si dhe të siguroj përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj viktimave të trafikimit.

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit 2013 - 2018³⁹ është dokumenti kryesor nacional i politikave për menaxhimin dhe kontrollin e kufirit shtetëror. Qëllimi i saj është kontrolli dhe mbikëqyrja efektive e kufirit shtetëror, bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha autoriteteve kompetente të përfshira në kontrollin e kufirit dhe lehtësimi i lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave, si dhe vendosja e një sistemi efikas dhe efektiv për menaxhimin e

³⁷ https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia_per_Migrim_SHQ.pdf

³⁸ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Diasporen_dhe_plani_i_veprimit_2013-2018.pdf

³⁹ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_MIK_2013-2018.pdf

integruar të kufirit, në mënyrë që të arrihet qëllimi i përbashkët i kufijve të hapur dhe të sigurt.

Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Kosovë dhe Plani i Veprimit 2013 - 2017⁴⁰ është dokumenti kryesor nacional i politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Qëllimi i saj është riintegrimi i shtetasve të Kosovës të riatdhesuar, përmes krijimit të kushteve më të përshtatshme për riintegrim të qëndrueshëm në shoqëri.

Politikat e regjimit të vizave - Republika e Kosovës e ka vendosur regjimin e vizave me 88 vende, kryesisht të kontinentit të Azisë dhe kontinentit të Afrikës. Për më tepër, sistemi i SIVK-ut është shtrirë në 16 misione diplomatike dhe konsullore të Kosovës, nga ku lëshohen viza për qytetarët e këtyre shteteve.

D 1.2. KORNIZA LIGJORE NË FUSHËN E MIGRIMIT

Korniza ligjore në fushën e migrimit është hartuar në përputhje me *acquis* të BE-së si pjesë e procesit të integritimit Evropian si dhe në bazë të kërkesave nga procesi për liberalizim të vizave me BE-në. Fusha e migrimit në Kosovë është rregulluar me legjislacionin në vijim:

Ligji Nr. 04/L-069 për të Huajt rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjet, dhe qëndrimin e të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Ky ligj në shtator të 2013 është shfuqizuar me Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt, i cili kishte për qëllim harmonizimin me *Aquis* të BE-së. Ligji i ri përveç kushteve të përmendura me lart rregullon edhe çështjen e punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Me miratimin e Ligjit të ri për të Huajt është bërë inkorporimi i Ligjit për Dhënien e Lejes për Punë dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës në kuadër të Ligjit të ri për të Huajt dhe një sërë ndryshimesh me qëllim të lehtësimit të procedurës për lëshimin e lejes së punës për të huajt, procedurën për urdhër largimin vullnetarë dhe urdhër largimin me forcë dhe shqiptimin e gjobave për të huajt, po ashtu është rregulluar çështja e trafikimit të huajve në Republikën e Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-073 për Azil, ky ligj rregullon dhënien e azilit dhe njohjen e statusit të refugjatit, dhënien e statusit të mbrojtjes plotësuese apo të përkohshme, personave që

⁴⁰ http://www.kryeministris.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Riintegrimin_e_Personave_te_Riatdhesuar

kanë nevojë, si dhe kthimin e tyre në vendin e originës, të prejardhjes ose në një vend të tretë. Në shtator të 2013 është shfuqizuar Ligji për Azil me Ligjin Nr. 04/L-217 për Azil, më qëllim të harmonizimit me Acquis të BE-së dhe përcaktimit të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të azilkërkuesve sipas direktivave të BE-së. Ligji i ri, rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, personave me status refugjati, si dhe personave të cilëve iu është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme. Ky Ligj është në procedurës të plotësim/ndryshimit dhe pritet të miratohet në pjesën e parë të vitit 2018.

Ligjin Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës përcakton mënyrën e fitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë Republikës së Kosovës dhe rregullon çështjet tjera të ndërlidhura me shtetësinë e Republikës së Kosovës. Me këtë ligj është i rregulluar natyralizimi i personave me status të refugjatit, si dhe natyralizimi i bashkëshortit të personit të natyralizuar.

Ligji Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror. Ky ligji rregullon kontrollin kufitar, kompetencat e policisë brenda shtetit, bashkëpunimi ndërmjet organeve shtetërore të cilat kanë kompetencë në menaxhimin kufitar dhe përgjegjësitë e tri agjencive të MIK -ut (Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, dhe Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit). Në shtator 2013, ligji është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. . 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, me qëllim të harmonizimit me Acquis të BE-së. Ndryshimet kryesore në ligjin e ri kanë të bëjnë kryesisht me përkufizimet dhe emërtimin e ligjit.

Ligji Nr. 04/L-216 për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, rregullon bashkëpunimin ndërmjet të gjitha autoriteteve që janë të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe zbatimi i strategjive të përbashkëta të këtyre autoriteteve, në mënyrë që detyrat e parapara për këto autoritete dhe masat individuale që kanë të bëjnë me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve të kundërligjshme penale, kontrollin, monitorimin dhe bashkëpunimin përkatës ndërkombëtar, të përmbushen në mënyrë të duhur, efikase dhe efektive.

Ligji Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz

në të gjitha format e tij. Gjithashtu, ky Ligj parasheh masat për mbrojtjen e viktimave të trafikuar, përfshirë sigurimin e të drejtave, si ndihmë juridike, ndihmë mjekësore, mbështetje psiko-sociale, sigurimi i kompensimit dhe të drejtave të tjera, për të gjithë personat që supozohen të jenë ose që identifikohen si të trafikuar, pavarësisht gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim të parandalimit dhe luftimit të trafikimit më njerëz dhe sigurimit të ndihmës, si dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuar.

Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës.

Ligjin Nr. 03/L-208 për Ripranim, përcakton rregullat dhe procedurat për ripranimin e një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaji, i cili nuk përmbush ose nuk përmbush më, kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit kërkues. Zbatimi i legjislacionit për ripranim ka përparësi sa i përket bashkëpunimit për ripranim me vendet me të cilat Republika e Kosovës ende nuk ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për ripranim.

Ligji Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile - ky ligj rregullon kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën ka për qëllim ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës, dhe lidhshmërinë e tyre me institucionet e Republikës së Kosovës. Po ashtu, ka për qëllim që të ndihmoj në organizimin e mërgimtarëve në shtetet e ndryshme ku jetojnë ata, si dhe të ndihmoj, nxit dhe zhvilloj marrëdhëniet ndërkulturore në mes të Republikës së Kosovës me shtetet ku mërgimtarët janë prezent.

Ligji Nr. 02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin, rregullon lajmërimin dhe ç'lajmërimin e vendbanimit dhe vendqëndrimit të qytetarëve, lajmërimin dhe ç'lajmërimin e mysafirrit, ndërrimin e adresës së banimit, kompetencat dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave përkatëse.

D 1.3. KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E MIGRIMIT

Përveç dokumenteve të përgjithshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat kanë zbatim të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, të parapara në nenin 22 të Kushtetutës, dokumentet kyçe të së drejtës ndërkombëtare në fushën e migrimit janë Konventa e OKB-së për të Drejtat e Migrantëve dhe Pjesëtarëve të Familjeve të tyre, si dhe Konventa e Gjenevës për Statusin e Refugjatit e vitit 1951.

D 2. PASQYRË E KORNIZËS INSTITUCIONALE KOMBËTARE DHE PARTNERËVE NË FUSHËN E MIGRIMIT

D 2.1. INSTITUCIONET VENDORE NË FUSHËN E MIGRIMIT

Migrimi si fushë është mjaftë gjithëpërfshirëse dhe implikon angazhimin e një numri të konsiderueshëm të institucioneve, varësisht nga fushëveprimi i tyre në kuadër të këtij sektori, si për nga zhvillimi, ashtu edhe nga zbatimi i legjislacionit dhe politikave. Autoritetet kyçe që kanë përgjegjësi hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e politikave të migrimit në Republikën e Kosovës:

- **Autoriteti Qeveritar për Migrim (AQM)** – mekanizëm ndër-institucional që përfshin të gjitha institucionet dhe agjencitë relevante që veprojnë në fushën e migrimit, është përgjegjës për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave të migrimit, përfshirë profilin e Lehtë dhe të Zgjeruar të Migrimit, ofrimin e ekspertizës dhe kapaciteteve në fushën e migrimit, zhvillimin e hulumtimeve dhe analizave të nevojshme në këtë fushë, si dhe bashkëpunimin me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare e rajonale në fushën e migracionit.
- **Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)** – si institucion kyç në këtë fushë, është përgjegjës për politikën e migrimit, përfshirë lidhjen e marrëveshjeve bilaterale për ri-pranim, kryesisht përmes DSHAM-it, i cili departament mes tjerash, vendos mbi kërkesat për shtetësi, leje-qëndrim, azil, mbrojtje ndërkombëtare, e ri-pranim, si dhe ka nën mbikëqyrje Qendrën e Mbajtjes për të Huaj dhe Qendrën e Azil-kërkuesve. Një tjetër aspekt të rëndësishëm që MPB trajton në këtë fushë është ri-integrimi i personave të riatdhesuar, nëpërmjet programeve të ri-integrimit të cilat hartohen, zbatohen dhe

monitorohen nga Departamenti për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar, në bashkëpunim me institucionet relevante të linjës.

- **Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)** – zhvillon dhe bashkërendon politikat në punët e jashtme, duke shpreh dhe mbrojt interesat e Kosovës në raport me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, në bashkërendim të plotë me ministrinë e tjera, ndërsa veprimtaria e këtij institucioni në fushën e migrimit përfshin nënshkrimin e marrëveshjeve (p.sh. marrëveshjet bilaterale për ripranim), nxjerrjen e udhëzimeve për Sistemin Informativ të Vizave të Kosovës (SIVK), udhëzimeve për procedurat e lëshimit të vizave në misionet diplomatike/konsullore dhe pikat kufitare, formën dhe përmbajtjen e Afishes së Vizës si dhe vendimin mbi lëshimin e vizave, përmes Misioneve Diplommatike/Konsullore të Republikës së Kosovës, për qytetaret e vendeve për të cilat Kosova aplikon regjimin e vizave.
- **Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS)** – shërben si urë lidhëse në mes të institucioneve të Kosovës dhe diasporës në shtetet e jashtme, në mes tjerash, përmes themelimit të rrjeteve të bizneseve të diasporës, institucionalizimit të mësimin plotësues të gjuhës, si dhe themelimit të qendrave kulturore.
- **Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)** – aktivitetet e kësaj ministrie në fushën e migrimit përfshijnë shqyrtimin dhe dhënien e lejeve të punës për shtetasit e huaj, si dhe angazhimin aktiv për punësimin e punëtorëve sezonal nga Kosova në vendet e jashtme. Përveç këtyre, MPMS në kuadër të Programit për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar, ofron shërbimet e ndërmjetësimit në punësim për të riatdhesuarit si dhe trajnimet profesionale.
- **Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)** – aktivitetet e kësaj ministrie që lidhen drejtpërdrejt me fushën e migrimi janë ofrimi i shërbimeve për ri-integrimin e personave të riatdhesuar në sistemin shkollor si dhe organizimin e klasave plotësuese dhe tyre të gjuhës për këta nxënës. Përveç tjerash, përmes Programit për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar.
- **Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit (MKK)** – zhvillon dhe zbaton politika për krijimin e kushteve të përshtatshme për kthimin e personave të zhvendosur, përfshirë edhe të zhvendosurit brenda vendit.

- **Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)** – në përgjithësi zhvillon dhe zbaton politika të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthortë ndikojnë në trendin e migrimit në vend, duke e pasur parasysh që zhvillimi ekonomik trajtohet si një nga elementet më kryesore të lëvizjeve migratore.
- **Ministria e Integrit Evropian (MIE)** – ofron ekspertizën dhe kontributin e saj duke u siguruar që masat e ndërmarra në këtë fushë reflektojnë dhe bashkëdyzohen me kërkesat që dalin nga mekanizmat për integrim evropian dhe procesi i liberalizimit të vizave.
- **Ministria e Financave (MF)** – është autoritet që bën vlerësimet dhe sjell vendimet mbi implikimet financiare sa i përket politikave të migrimit dhe zbatimit të tyre.
- **Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)** – mbledh, analizon dhe ofron statistika lidhur me lëvizjet migratore, përfshirë edhe migrimin e brendshëm.
- **Banka Qendrore e Kosovës (BQK)** – kryesisht ofron statistikat zyrtare që ndërlidhne me remitancat që hyjnë nëpërmes kanaleve zyrtare.

D 2.2. ORGANIZATAT DHE AKTERËT E SHOQËRISË CIVILE NË FUSHËN E MIGRIMIT

Një numër i organizatave vendore të shoqërisë civile janë të përfshira aktivisht në përkrahjen e zbatimit të legjislacionit dhe politikave në këtë fushë nëpërmjet projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme. Akterët kryesor të shoqërisë civile të përfshirë në këtë fushë janë:

- Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP-K);
- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës;
- Qendra Burimore për Avokim dhe Trajnime (ATRC);
- Agjencia Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KAAD).

D 3. BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR NË FUSHËN E MIGRACIONIT

Gjatë periudhës 2013-2017, institucionet e Republikës së Kosovës kanë zhvilluar forma të ndryshme të bashkëpunimit me organizata dhe iniciativa të veçanta ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e migrimit. Kosova, gjithashtu ka vendosur bashkëpunim bilateral me një

numër shtetesh.

D 3.1. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT DHE INICIATIVAT RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARE, SI DHE AKTERËT E TJERË NDËRKOMBËTARË NË FUSHËN E MIGRIMIT

Akterët kryesorë të kësaj kategorie të përfshirë në fushën e migrimit janë:

- Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM);
- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë;
- Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR);
- Qendra Ndërkombëtare për Përgatitjen e Politikave të Migrimit (ICMPD);
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF);
- Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBE);
- Nisma Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI);
- Këshilli Danez për Refugjatë (DRC);
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Misioni në Kosovë;
- CARITAS.

Në lidhje me bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në iniciativat ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e migrimit, gjatë kësaj periudhe Republika e Kosovës ka marrë pjesë vazhdimisht në aktivitetet në kuadër të Procesit të Pragës, si në takimin e zyrtarëve të lartë ashtu edhe në trajnime.

Po ashtu, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të Autoritetit Qeveritar për Migrim dhe për të mbështetur Koordinatorin Kombëtar për Migrim, MPB është mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, në kuadër të Marrëveshjes së Partneritetit për Migracion në mes të Kosovës dhe Zvicrës, aktivitetet e së cilit projekt kanë përfshirë trajnime tematike të ndryshme, zhvillimin e hulumtimit për migrimin, si dhe organizimin e fushatës për informimin e qytetarëve për rregullat e lëvizjes pa viza në Zonën Schengen dhe pasojat e migrimi të parregullt.

D 3.2. BASHKËPUNIMI BILATERAL NË FUSHËN E MIGRIMIT

Deri më tani, Republika e Kosovës ka nënshkruar 22 marrëveshje me 24 shtete në fushën e ripranimit, duke përfshirë 6 shtete gjatë periudhës 2013-2017, me shtetet si: Estonia në vitin

2013, Principata e Lihtenshtajnit vitin 2013, Republika e Kroacisë vitin 2013, Republika e Italisë vitin 2014, Republika e Turqisë vitin 2015 dhe Republika e Maqedonisë vitin 2017.

Edhe gjatë kësaj periudhe kohore janë organizuar takime të rregullta me atashetë e migrimit në Misionet Diplomatike dhe Konsullore të akredituara në Kosovë, me qëllim të shkëmbimit të të dhënave dhe diskutimit rreth sfidave në fushën e azilit dhe migrimit.

PJESA E: VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË MIGRIMIT DHE POLITIKAT E MIGRIMIT PËR ZHVILLIMIN SOCIO-EKONOMIK

E 1. NDIKIMET E MIGRIMIT NË ZHVILLIMIN SOCIO-EKONOMIK TË VENDIT

Ndikimet potenciale të migrimit në zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës dallojnë dhe zakonisht janë negative ose pozitive. Në përputhje me statistikat dhe trendet e adresuara në pjesë tjera të këtij profili, disa ndikime specifike socio-ekonomike të migrimit janë adresuar në këtë kapitull:

- Roli i migrimit në formësimin e demografisë dhe profilin e popullatës në zona rurale;
- Efekti i migrimit dhe remitencave në mirëqenien dhe pabarazinë e ekonomive familjare;
- Efekti i migrimit në funksionimin dhe normat familjare;
- Roli i migrimit në stimulimin e zhvillimit të tregtisë dhe sektorit privat;
- Ndikimet e migrimit në tregun e punës;
- Profilet e shëndetit fizik dhe mendor të popullatës migruese dhe pasojat e tyre për sistemet e shëndetësisë.

E 2. ROLI I MIGRIMIT NË FORMËSIMIN E DEMOGRAFISË

Emigrimi apo lëvizjet e popullsisë nga vendi i origjinës në vendin e destinacionit ndodhin për shumë arsye. Këto lëvizje në aspektin territorial – administrativ ndahen:

- Emigrime kombëtare /ndërkombëtare dhe
- Imigrimi kombëtar/ndërkombëtar.

Emigrimi ndërkombëtar i jashtëm ka të bëjë me personat që emigrojnë, largohen jashtë kufijve të shtetit ndërsa emigrimi kombëtar ka të bëjë me lëvizje të popullatës nga një zonë në një zonë tjetër brenda shtetit. Këto lëvizje ndikojnë në ndryshimet demografike në nivel vendbanimi, komune si dhe në nivel shtetëror. Këto ndikime kanë të bëjnë me ndryshimin e numrit të popullatës: sipas gjinisë, moshës, strukturës etnike, përgaditjes shkollore, etj. Në periudhat afatgjate emigrimi ka një ndikim negativ në situatën demografike të Kosovës. Do të ndikoj në vitalitetin e popullsisë pasi që vlerësohet se pjesa dërrmuese e migrimit kishte

përfshirë grup-moshat e reja – riprodhuese të cilat do të kenë ndikim në aspektin e fertilitetit dhe asaj të fuqisë punëtore.

Migrimi i brendshëm dhe i jashtëm mund të kenë ndikim në karakteristikat demografike të komunitetit vendës.

Edhe pse migrimi i brendshëm nuk është trajtuar si seksion i veçantë në këtë profil të migrimit profili, ka disa indikatorë të gjeneruar nga ASK-ja se migrimi i brendshëm rural - urban brenda Kosovës mund t'i kontribuoj depopullimit të zonave rurale. Pasi që pjesa më e madhe e migrantëve të brendshëm janë persona relativisht të rinj që kërkojnë vende pune në zona urbane, individët të cilët mbeten në zona rurale të origjinës janë persona më të moshuar dhe kështu migrimi mund t'i kontribuojë përqindjeve më të larta të varësisë në zona rurale. Duke marrë parasysh koncentrimin më të madh në bujqësi në zona rurale, "humbja potenciale e trurit" të personave të rinjë, të aftë për punë nga zonat rurale mund t'i kontribuojë një rënie në rendimentet bujqësore. production.

Popullsia Kosovare ende ka lidhje të fuqishme familjare, kjo është ndër shkaqet e migrimit siç janë bashkimet familjare dhe punësimi; kryefamiljari kyresisht emigron për shkak të punësimit dhe me të ardhurat e fituara e mban familjen (përmes remitancave).

Emigrimi ndërkombëtar mund të ndikoj që në të ardhmen të kemi:

- Rënie të shkallës së fertilitetit;
- Ndikim në zvogëlimin e popullsisë së Kosovës.

E 3. EFEKTET E REMITENCAVE NË MIRËQENIEN DHE PABARAZINË E EKONOMIVE FAMILJARE

Duke pasë parasysh nivelin e emigrimit nga Kosova dhe një nivel të lartë të remitencave të transferuara tek pranuesit në Kosovë - që janë llogaritur të jenë mbi 759 milion euro në 2017 – emigrimi ndërkombëtar dhe remitencat ka gjasa të ndikojnë në mirëqenien e ekonomive familjare dhe cënueshmërinë për varfëri. Remitencat janë burim i rëndësishëm i të ardhurave. Informatat nga anketat për buxhet të ekonomive familjare 2016/17 tregojnë se remitencat janë një kontribues i rëndësishëm në të hyrat e ekonomive familjare. Në 2016 remitencat përbëjnë 7% të të hyrave mesatare individuale dhe në 2017 kjo pjesë është rritur në 8%. Përveç remitencave të dërguara nga jashtë, pensionet nga jashtë gjithashtu i kanë kontribuar të

hyrave individuale – rreth 4% në 2016 dhe 3% në 2017. Përderisa këto pjesëmarrje duken të vogla, është me rëndësi të pranohet se ato janë pjesëmarrje mesatare përkundër tërë popullsisë së Kosovës. Nëse pjesëmarrja e kontribuar nga remitencat dhe pensionet nga jashtë do të kalkulohej vetëm për pranuesit e transfereve të tilla, pjesa e të hyrave prej këtyre burimeve do të ishte shumë më e lartë⁴¹.

Një analizë e efekteve të remitencave bazuar në të dhënat e 2014⁴², ka gjetur se remitencat nuk kanë pasur ndonjë ndikim në popullsinë që jetojnë në varfëri ekstreme, si dhe nuk ka kontribuar në përmirësimin e rreth 40% të ekonomive familjare migruese për të kaluar mbi linjën e varfërisë. Në të njëjtën kohë, është gjetur se remitencat thellojnë pabarazinë e të hyrave në ekonomi familjare, rrisin hendekun ndërmjet ekonomive familjare të varfëra dhe jo të varfëra.

Në aspektin e zhvillimit ekonomik të vendit, kapitali nga diaspora është i rëndësishëm së veçantë, pasi që përveç remitencave dhe investimeve të diasporës si faktorë të rëndësishëm që mundë të ndikojnë në zhvillimin e vendit, ato janë edhe faktor të rëndësishëm për orientimin e kapitalit dhe investimeve në sektor të ndryshëm ekonomik që rrisin prodhueshmërinë, ndikojnë në hapjen e vendeve të reja të punës dhe ndikojnë në rritje të eksportit, si dhe në koncentrimin e kapitalit intelektual në sektorë deficitar socio-ekonomik në Republikën e Kosovës.

E 4. NDIKIMET E MIGRIMIT NË TREGUN E PUNËS

Ndikimi i migrimit në tregun e punës duhet shikuar në kontekst me zhvillimin ekonomik të vendit si në aspektin e imigrimit ku për shumë sektorë ekonomik, vendit i nevojiten fuqi punëtore e kualifikuar me profile specifike të cilat nuk gjinden në vendit tonë. Në këtë aspekt përfitimet e vendit tonë janë edhe sjellja e shkathtësive profesionale nga të cilat mund të përfitojnë të rinjtë tanë.

Riatdhesimi si proces mund të sjellë të mirat e veta me kthimin duke pasur parasysh se kjo kategori ka marrë përvoja profesionale të cilat mund të barten në vendin tonë dhe mund të

⁴¹ Sipas ASK

⁴² Shih Möllers and Meyer (2014). "The effects of migration on poverty and inequality in rural Kosovo." *IZA Journal of Labour & Development*, 3(16): 1-18.

kenë një efekt të vogël në zhvillimin ekonomik të vendit përmes hapjes së bizneseve dhe hapjes së vendeve të reja të punës.

E 5. ROLI I MIGRIMIT NË STIMULIMIN E ZHVILLIMIT TË TREGTISË DHE SEKTORIT PRIVAT

Efektet e politikave tregtare gjatë viteve 2013-2017 të përmendura në pjesën B, kanë ndikuar relativisht mirë në mënyrë indirekte në çështjet e migrimit në përgjithësi. Republika e Kosovës momentalisht ofron më shumë mundësi për investime, promovon investimet dhe eksporton kryesisht në Diasporë (Gjermani, Austri dhe Zvicër) përmes panairëve, misioneve tregtare dhe konferencave ndërkombëtare dhe kombëtare, numri total i regjistrimit të bizneseve është gjithnjë në rritje sidomos të bizneset me pronarë të huaj. Poashtu, Kosova qëndron më afër integritimit në BE pas nënshkrimit të MSA-së ku pritet të ketë efekte dhe ndikime zingjimore dhe multifunksionale në mënyrë indirekte në migrim.

E 6. NDIKIMI I MIGRIMIT NË SFERËN POLITIKE NË VEND

Aspekti i ndikimit të migrimit në sferën politike në Republikën e Kosovës është e ndërlidhur ngushtë me promovimin dhe avancimin e të drejtave politike dhe sociale të diasporës dhe kjo është e reflektuar në prioritetet e politikave qeveritare si Strategjia për Diasporën 2013-2018. Në këtë drejtim, sipas kërkesave të vazhdueshme të diasporës, në kuadër të Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme është shtuar edhe komponenti i diasporës dhe tani ky Komision quhet Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike. Edhe pse ky Komision nuk përfaqëson interesat e pjesëtarve të diasporës në mënyrë të drejtëpërdrejtë, mirëpo adreson të gjitha çështjet që ndërlidhen me diasporën në aspektin legjislativ. Në këtë drejtim, duhet theksuar se përfaqësimi politik i diasporës në sferën vendimmarrëse dhe politikbërëse nuk është në nivelin e duhur për shkak të mungesës së vullnetit politik. Duhet theksuar se sfidë për Republikën e Kosovës mbeten mekanizmat e duhur për mundësimin e realizimit të së drejtës së votës dhe përfaqësimi i diasporës në institucionet vendimmarrëse. Gjithashtu, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore nuk është themeluar Kuvendi i Përgjithshëm i Diasporës i cili do të shërbente si mekanizëm përfaqësimi për pjesëtarët e diasporës që vazhdimisht kërkojnë adresimin e nevojave të tyre.

PJESA F: PËRFUNDIMET

F1. REZULTATET (GJETJET) KRYESORE TË MIGRIMIT PËRSA I PËRKET PRIRJEVE TË ARDHSHE TË MUNDSHME TË MIGRIMIT

Imigrimi i rregullt

Të dhënat vjetore tregojnë se gjatë periudhës 2013-2017, trendi i lëshimit të leje-qëndrimeve për të huaj në Kosovë ka qenë në rritje. Rritja mesatare vjetore aritmike përgjatë këtyre viteve ishte 24.2% dhe kjo dëshmon që Kosova po bëhet vend i destinimit të imigrimit të rregullt.

Bazuar në kategoritë e lëshimit të lejeve të përkohshme të qëndrimit për të huaj, fillimisht në vitin 2013 ka dominuar kategoria e 'bashkimit familjar', përderisa nga viti 2014 dominon kategoria e lejeve të qëndrimit për 'qëllime të punësimit' dhe ky trend është në rritje duke kulminuar në vitin 2017. Këto trende tregojnë se Kosova po bëhet vend i destinimit për të huaj për qëllime të punësimit, në veçanti për shtetasit nga Turqia dhe shtetet e rajonit.

Trendi i fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës tregon rritje të theksuar nëse krahasojmë vitin 2017 me vitin 2016, pasi që një numër i madh i personave të cilët paraprakisht ishin të pajisur me leje të përkohshme apo të përhershme të qëndrimit kanë plotësuar kriteret si psh. lidhur me kohëzgjatjen e qëndrimit në Kosovë, dhë kështu kanë fituar të drejtën për fitimin e shtetësisë dhe e kanë shfrytëzuar atë të drejtë. Arsye tjetër kryesore mund të jetë gjithashtu edhe numri në rritje i bashkimeve familjare në vitet e fundi, që i jep të drejtën e fitimit të shtetësisë sic parasihet në Ligjin për Shtetësi. Shumica e personave që kanë fituar shtetësinë e Kosovës janë me origjinë nga Shqipëria.

Imigrimi i parregullt

Mund të konkludohet se numri refuzimi hyrjeve ndaj shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës është rritur pas hyrjes në fuqi të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin e kushteve të hyrjes dhe Regjimit të Vizave për të huajt në Republikën e Kosovës Nr. 15/158 i datës 29.11.2013. Hyrja në fuqi e këtij vendimi ka ndikuar në rritjen e refuzimit të hyrjeve për shtetasit e shteteve anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen dhe në rënien e numrit të refuzimit të hyrjeve për shtetasit e shteteve Aziatike dhe Afrikane. Shtetasve të shteteve fqinje, Shqipëria, Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi, iu është refuzuar hyrja për mungesë të dokumenteve të vlefshme, si dhe për shkak të ndalesave të ndryshme, ndërsa shtetasve të

shteteve anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen iu është refuzuar hyrja për arsye të mungesës së pasaportave dhe letërnjoftimeve biometrike. Përderisa shtetasve të shteteve Aziatike dhe Afrikane iu është refuzuar hyrja për arsye se nuk kanë pasur viza për të hyrë në Kosovë, apo nuk kanë pasur mjete të mjaftueshme për jetesë dhe nuk kanë mundur ta justifikojnë qëllimin dhe kushtet e qëndrimit.

Rritja e trendit të imigrantëve të parregullt të cilët kanë kaluar kufirin në mënyrë të paautorizuar gjatë pesë viteve të fundit, është si rezultat i lëvizjeve të imigrimit të parregullt në rajon (rruga Ballkanike) si dhe shfrytëzimi i rrugëve alternative përfshirë Kosovën.

Deri me tani imigrimi i parregullt nuk ka pasur ndikim në sigurinë e brendshme të shtetit tonë për arsye të numrit të vogël të imigrantëve të parregullt dhe se të njëjtit kanë shfrytëzuar Kosovën kryesisht si vend transit për të shkuar në shtetet e BE-së.

Gjatë periudhës 2013-2017 dominojnë shtetasit e Shqipërisë dhe Turqisë të cilët kanë qëndruar në mënyrë të parregullt në Republikën e Kosovës. Ndërsa sa i përket gjinisë dominon gjinia femërore. Në vitin 2013 dhe 2014 numri i qëndrimeve të pa rregullta ka qenë me i lartë, në krahasim me vitet 2015, 2016 dhe 2017 ku ka pas rënie. Arsyet e kësaj rënie ndërlidhen me informimin dhe vetëdijësimin e të huajve, lidhur me kushtet e nevojshme për të hyrë dhe qëndruar në Republikën e Kosovës.

Gjatë viteve 2014-2017, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj ka shqiptuar gjithsej 676 urdhër largime me forcë, të cilat janë ekzekutuar menjëherë duke bërë dëbimin e imigrantëve të parregullt. Urdhër Largimi me Forcë shoqërohet me ndalim të hyrjes së të huajit në territorin e Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej një (1) muaji deri në pesë (5) vite. Numri më i madh i të larguarve me forcë janë imigrantë të pa rregullt, shtetas nga Shqipëria me 90%, pasuar me vendet tjera me numër të vogël që në tërësi përbën 10% e totalit të përgjithshëm. Ndërsa përqindja sipas gjinisë është me 56% të gjinisë femërore krahasuar me 44% të gjinisë mashkullore.

Kontrabanda me emigrantë dhe imigrantë vazhdon të jetë ende prezent në vendin tonë, por me intensitet me të vogël.

Gjatë periudhës 2013-2017, kanë vazhduar kontrollet sistematike dhe të hollësishme nga Policia e Kosovës në të gjitha pikat e kalimit kufitar dhe përgjatë vijës së gjelbër të kufirit për

parandalimin dhe luftimin e kontrabandës me emigrantë. Po ashtu, janë luftuar edhe grupet e organizuara kriminale brenda territorit të cilat janë marrë me kontrabandë me migrantë.

Gjatë vitit 2014 dhe 2015 kemi pasur një fluks të emigrimit të pa rregull, për këtë arsye edhe numri i rasteve të iniciuara gjate këtyre dy viteve lidhur me kontrabandë me emigrantë është me i lartë se sa viteve tjera.

Ndërsa sa i përket imigrimit të parregullt, gjatë vitit 2015 dhe 2016, Kosova ka qenë më së shumti e prekur nga kjo dukuri, kështu që numri i rasteve të iniciuara për kontrabandë me imigrantë është me i lartë se vitet tjera.

Sa i përket Trafikimit me Qenie Njerëzore gjatë periudhës kohore 2013-2017 trendi është përafërsisht i njëjtë. Gjitha viktimat janë të gjinisë femërore dhe të moshës madhore, ku dominuese është mosha nga 20-30 vjeçe. Sa i përket vendit të origjinës, 80% e viktimave të trafikimit janë nga Shqipëria.

Emigrimi

Vitet 2016 dhe 2017 karakterizohen me rritje të lehtë të emigrimit të rregullt të Kosovarëve drejt vendeve të BE-së dhe zonës Schengen, në veçanti në Gjermani për arsye të punësimit. Në anën tjetër, gjatë viteve 2014 dhe 2015 ka pasur rritje të konsiderueshme të emigrimit të parregullt, përderisa në vitet 2016 dhe 2017 ky numër ka rënë dukshëm.

Emigrimi i rregullt

Bazuar në të dhënat e EUROSTAT-it për shtetasit e Republikës së Kosovës me lejeqëndrim të vlefshëm në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, emigrimi i rregullt ka mbetur në nivel të ngjajshëm me një rritje të lehtë në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016. Sidoqoftë, trendët tregojnë se bashkimi familjar si kategori e emigrimit të rregullt është duke shënuar rënie të lehtë sidomos në 3 vitet e fundit përderisa kategoria e emigrimit për 'qëllime të punësimit' ka shënuar rritje të dukshme, sidomos në vitin 2017 dhe është rreth gjashtëfish më e lartë krahasuar me vitin 2015, me Gjermaninë si destinacion kryesor për migrantët e punës.

Emigrimi i parregullt

Vitet 2014 dhe 2015 janë karakterizuar me rritje të dukshme të emigrimit të parregullt të Kosovarëve në drejtim të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen. Ky fenomen nisi të

rritet në shtator të vitit 2014 dhe ka vazhduar deri në fund të shkurtit 2015. Raporti i Frontexit⁴³ vë në theks ndryshimin e rrugëve të migrimit të parregullt për të hyrë në BE, duke dominuar ajo e Ballkanit Perëndimor, në veçanti kufiri Serbi-Hungari ka patur një rritje të konsiderueshme të migrimit të parregullt me mbi 25,000 migrantë të raportuar që kanë shfrytëzuar këtë rrugë për tre-mujorin e fundit të vitit 2014, dhe një numër i konsiderueshëm i këtyre migrantëve të parregullt ishin me origjinë nga Kosova.

Fenomeni i emigrimit të parregullt i viteve 2014 dhe 2015 është reflektuar në të gjitha kategoritë e emigrimit të parregullt si: kategoria e shtetasve Kosovarë me qëndrim të parregullt në vendet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, kategoria e shtetasve Kosovarë të urdhëruar të largohen nga vendet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen dhe kategoria e shtetasve Kosovarë të larguar nga vendet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen. Përfundimisht kategoria e refuzimit të hyrjes në kufi ose të zënë në kufi të vendeve të zonës Schengen e cila ka regjistruar trend kryesisht linear dhe arsyet e refuzimit ishin të lidhura kryesisht me dokumente jo të vlefshme të udhëtimit dhe vizë apo qëndrim jo të vlefshëm. Trendet në dy vitet e fundit (2016 dhe 2017) kanë treguar një rënie të konsiderueshme të emigrimit të parregullt ku në periudhën e ardhshme ky trend pritet të vazhdoj dhe vecanësisht me liberalizimin e mundshëm të vizave.

Azilkërkuesit në Kosovë

Trendet e 5 viteve të fundit tregojnë se Kosova ka patur numër të përafërt të azil-kërkuesve, përjashtuar vitin 2016 ku numri i azil-kërkuesve ishte 307. Kjo tregon se 'kriza e refugjatëve' e vitit 2015 që ka prekur vendet e Ballkanit përmes 'rrugës ballkanike' për të kaluar në shtetet e BE-së, nuk e ka prekur Kosovën. Mirëpo, ndryshimi i rrugës ballkanike dhe vendosja e pengesave nga vendet e ndryshme të rajonit për kalim të migrantëve dhe refugjatëve mund të prek Kosovën dhe të rritet numri i azil-kërkuesve apo migrantëve në masë më të madhe sa që kërkon reagim nga institucionet e shtetit për tu ballafaquar me këtë fenomen.

Azilkërkuesit Kosovarë në shtetet e BE-së

Sipas të dhënave, periudha 2013-2017 ka pasur një trend të rritjes së konsiderueshme të azilkërkuesve Kosovarë në shtetet e BE-së dhe zonës Schengen deri në Shkurt të vitit 2015.

⁴³ http://frontex.europa.eu/assets/Publications/Risk_Analysis/Fran_Q4_2014.pdf

Nga muaji mars i vitit 2015 kërkesat për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë nga Kosova në shtetet anëtare të BE-së dhe Zonën Schengen filluan të pësojnë rënie të vazhdueshme. Kështu që gjatë dy viteve të njëpasnjëshme 2016 dhe 2017, kërkesat për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë, pësuan rënie të konsiderueshme për rreth dymbëdhjetëfishit (5,455) të numrit të përgjithshëm (67,470) të vitit 2015. Ky trend në rënie pritet të vazhdoj edhe në të ardhmen, në rast të liberalizimit të vizave si dhe trendit në rritje të emigrimit të rregullt për qëllime të punësimit.

F2. PËRMIRËSIMI I TË DHËNAVE TË MIGRIMIT

Identifikimi i boshllëqeve dhe problemet e hasura në mbledhjen e të dhënave

Hartimi i Profilit të Zgjeruar të Migrimit 2013-2017 është përcjellur me vështirësi në mbledhjen në kohë të të dhënave të nevojshme për hartimin e këtij dokumenti. Këto vështirësi ishin për shkak të mungesës së të dhënave apo vonesave në sigurimin/publikimin e tyre. Ekspertët e institucioneve që janë pjesë e AQM-së kanë identifikuar disa mangësi lidhur me mbledhjen e të dhënave gjatë kësaj periudhe kohore. Këto mangësi janë si në vijim:

- Për shkak të llojllojshmërisë së ndërlidhjes së institucioneve/sectorëve me migrimin (disa janë direkt e disa indirekt të ndërlidhura), mbledhja e të dhënave në formatin e standardizuar dhe me kohë ka qenë e vështirësuar.
- Mungesa e një sistemi të standardizuar të të dhënave për fushën e migrimit shkakton vështirësi në menaxhimin e këtyrë të dhënave.
- Burimet e jashtme ndërkombëtare, sidomos për të dhënat e emigrimit mund të mos jenë të publikuara me kohë.
- Mbledhja e të dhënave për ripranim në sistemin e SMK (Sistemi për Menaxhim të Kufirit) në pjesën e dytë të vitit 2016 dhe në vitin 2017 ka qenë e vështirësuar.
- Vështirësitë në zbatimin e politikave të kthimit të të huajve në mungesë të bashkëpunimit me vendet e tyre të origjinës.
- Mungesa e të dhënave në lidhje me profilin e të huajve dhe sektorin e punësimit të të huajve që pajisen me leje të punës.
- Mungesa e ndërlidhjes së Sistemit për Menaxhim të Rasteve (SMR) me MASHT, MMPH, MSH, MBPZHR dhe me institucionet tjera të përfshirë në procesin e ri-integrimit.

- Mungesa e të dhënave për arsimin e lartë si dhe për studentët Kosovarë me studime jashtë vendit (përfshirë nostrifikimin).
- Vështirësitë teknike në funksionimin e mirëfilltë dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme e Sistemit Informativ të Vizave të Kosovës (SIVK).
- Mungesa e informatave dhe të dhënave për migrimin e brendshëm (lëvizjet komunë-komunë, dhe fshat-qytet).

Veprimet e rekomanduara për përmirësimin e të dhënave të migrimit

- Krijimi i sistemit për mbledhjen e të dhënave të migrimit në mënyrë të harmonizuar nga të gjitha institucionet e përfaqësuara në AQM.
- Ndërlidhja e bazave të të dhënave për çështje të migrimit me ASK-në.
- Fuqizimi i kapaciteteve të AQM-së dhe ofrimi i ekspertizës ndërkombëtare në drejtim të avancimit analitik të të dhënave në fushën e menaxhimit të migrimit.
- Pjesëmarrja në procese të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare që ndërlidhen me aspektet analitike të fushës së migrimit.
- Të përmirësohet mbledhja e të dhënave për ripranim pas ndërlidhjes së e sistemit SMK (BMS) me bazën e DSHAM-it.
- Ndërlidhja e SMR për riintegrim me institucionet tjera si: MSH, MASHT, MAPL, MMPH, MBPZHR, etj, në fushën e riintegritimit.
- Zgjerimi i platformës në kuadër të SMIAL për grumbullimin e të dhënave për çështjet që ndërlidhen me fushën e migrimit.
- Vlerësimi i nevojave për zhvillimin e sistemit për migrim të brendshëm në Kosovë (lëvizjet komunë-komunë, fshat-qytet).

Sygjerimet rreth përditësimit të profilit të migrimit

Për të siguruar që profilet e ardhshme të migrimit të përditësohen në mënyrë të rregullt, sygjerohet që:

- Të hartohen dhe miratohen rregullat dhe procedurat që përshkruajnë funksionimin, mbarëvajtjes së punës dhe përgjegjësitë e anëtarëve të AQM.
- Të avancohen kapacitetet analitike dhe të specializuara për anëtarët e AQM-së në fushat që ndërlidhen me migrimin.

- Të funksionalizohet platforma elektronike për mbledhjen e standardizuar dhe me kohë të të dhënave në fushën e migrimit.
- Profili i lehtë i migrimit të përditësohet në baza vjetore.
- Të sigurohen dhe ofrohen në mënyrë të vazhdueshme të dhënat/informatat nga institucionet dhe organizatat të cilat janë të përfshira në profilin e migrimit.
- Profili i zgjeruar i migrimit të hartohet për periudha pesë vjecare.
- Të rritet vizibiliteti i AQM-së dhe rezultateve të arritura.
- Të promovohet AQM dhe të ofrohet mbështetje insituacionale për të siguruar mbarëvatjen dhe efikasitetin e punës së AQM-së.

F 3. REKOMANDIMET NË LIDHJE ME MENAXHIMIN E MIGRIMIT

Identifikimi dhe fuqizimi i mekanizmave efikas institucional që kontribuojnë ose ndikojnë në dukurinë e migrimit

- Avancimi i legjislacionit sipas nevojës me qëllim të harmonizimit me legjislacionin ndërkombëtar duke përfshirë këtu edhe arritjet e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e migrimit.
- Fuqizimi i mekanizmit përmes të cilit do të mundësohet identifikimi, profilizimi dhe referimi i personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, migrantëve të parregullt, viktimave të trafikimit, kontrabandimit me migrantë, grupet e cënueshme.
- Fuqizimi i mekanizmave për të mundësuar identifikimin dhe vlerësimin e vendeve të origjinës së personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare.
- Avancimi i bashkëpunimit nderinstitucional për verifikimin e indentitetit dhe kthimin e të huajve që nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në vendin e origjinës.
- Senzibilizimi i duhur i shoqërisë civile dhe institucioneve tjera në referimin, identifikimin dhe lajmërimin e viktimave potenciale të trafikimit tek organet kompetente.
- Të bëhet profilizimi i punëtorëve social, si dhe prokurorëve që të merren me raste të trafikimit me njerëz.

- Në funksion të menaxhimit të flukseve të migrimit, të avancohet bashkëpunimi nderinstitucional si dhe me organizatat vendore e ndërkombëtare.

Fuqizimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar

Me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të politikave, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal, si dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale në këtë fushë duhen të merren parasysh rekomandimet si në vijim:

- Vazhdimi i negocimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale në fushën e migrimit.
- Avancimi i bashkëpunimit dhe anëtarësimit në iniciativat rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e migrimit.
- Vazhdimi dhe intensifikimi i aktiviteteve vetëdijësuese me qëllim të parandalimit të migrimit të parregullt dhe promovimit të migrimit të rregullt.
- Funksionalizimi i Misioneve tjera Diplomatie/Konsullore të Republikës së Kosovës dhe vazhdimi i shtrirjes së rrjetit për lëshimin e vizave dhe sistemit të gjendjes civile për pajisjen e diasporës me dokumente të gjendjes civile.
- Nënshkrimi dhe zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me IOM-in për kthimin e asistuar dhe vullnetar të të huajve me qëndrim të parregullt në Republikën e Kosovës.
- Krijimi dhe avancimi i partneriteteve formale strategjike me agjencitë evropiane dhe organizatat ndërkombëtare që ndërlidhen me menaxhimin e migrimit, EASO, EUROPOL, INTERPOL, Procesi i Budapestit, Procesi i Pragës, Procesi i Bërdos, ICMPD, etj.
- Vazhdimi i negociimit të marrëveshjeve për ripranim, në veçanti me vendet e origjinës së migrantëve të parregullt.
- Negociimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për partneritet në fushën e migrimit, sidomos atij qarkor me shtetet e BE-së dhe zonës Shengen.

Avancimi i kapaciteteve për menaxhimin e migrimit në përgjithësi

- Sigurimi i teknologjive moderne, si dhe pajisjeve operative për kryerjen e kontrolleve që kontribuojnë për identifikimin e migrantëve të parregullt.
- Krijimi dhe ndërlidhja e sistemit (databazës) të decentralizuar për lëshimin e lejeve të punës për të huaj me qëllim të shkëmbimit të informatave për profilin e të huajve.
- Rritja e cilësisë së arsimit të lartë dhe shkollave profesionale me qëllim të plotësimit të nevojave të tregut të punës.
- Zhvillimi i programeve të ndryshme studimore që ndërlidhen me mobilitetin e studentëve kosovarë.

REKOMANDIMET STRATEGJIKE PËR PËRMIRËSIMIN E MENAXHIMIT TË MIGRIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Nga analizat e bëra në këtë dokument për fushat e ndryshme të ndërlidhur me migrim, rekomandohet që:

1. Vazhdimi i reformave në fushën e migrimit në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, përkatësisht nenet 85, 86, 87 dhe 88 të kësaj Marrëveshje.
2. Rishikimi funksional i kornizës strategjike në fushën e migrimit, me qëllim të krijimit të një qasje sektoriale dhe horizontale të politikave të migrimit.
3. Zbatimi i sistemit të migrimit për qëllime të punësimit, që përfshin funksionalizimin e shërbimeve për këshillim, informim dhe punësim në nivel qendror dhe lokal si dhe koordinimin me agjencionet publike të punësimit me vendet e ndryshme të destinacionit.
4. Vlerësimi i zbatimit të migrimit në nivel lokal dhe zhvillimi i sistemit të migrimit të brendshëm.
5. Dërgesat e emigrantëve/diasporës kanë rëndësi të veçantë në lehtësimin e deficitit tregtar që ka Kosova. Megjithatë, remitancat duhet të zhvendosin kontributin e saj nga mbështetja për konsumin familjar në drejtim të investimeve kapitale që rezultojnë me hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e eksportit si rezultat i prodhimit/shërbimit.
6. Zhvillimi i politikave që kanë për qëllim krijimin e kushteve për investime të diasporës Kosovare. Investimet e diasporës duhet të orientohen në aspektin e zhvillimit ekonomik të vendit.
7. Menaxhimi i procesit pas-liberalizimit të mundshëm të vizave, përmes ngritjes së kapaciteteve të autoriteteve për menaxhimin e procesit pas-liberalizimit të vizave si

dhe informimin e vazhdueshëm të qytetarëve lidhur me të drejtat dhe obligimet e lëvizjes së lirë pa viza.

8. Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkufitar mes shteteve të rajonit si dhe bashkëpunimi me vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit është i një rëndësie të veçantë. Shkëmbimi i përvojave dhe informatave ndërmjet institucioneve dhe mekanizmave koordinues dhe atyre për zbatim të ligjit në fushën e menaxhimit të migrimit kontribuon në menaxhimin më efikas të lëvizjeve migratore në përputhje me parimet univerzale për të drejtat e njeriut.

SHTOJCAT

I. BURIMET DHE VARIABLAT (NDRYSHORET) E PËRDORURA PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE

- Sistemi i statistikave ASK;
- Statistikat e Bankës Qendrore të Kosovës;
- Baza e të dhënave të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion, Ministria e Punëve të Brendshme;
- Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA);
- Sistemin e Menaxhimit të rasteve / DRPR;
- Sistemi i statistikave të Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj, Policia Kufitare;
- Sistemi i statistikave të IOM Kosova;
- Sistemi i statistikave të UNHCR-së në Kosovë;
- Baza e të dhënave e Eurostatit.

II. ANEKS TABELAT

TABELA 1: AGREGATET KRYESOR MAKROEKONOMIK SIPAS VITEVE 2013-2017 DHE PROJEKSIONET 2018-2021

| Agregatët kryesor/vitet | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 Proj. | 2019 Proj. | 2020 Proj. | 2021 Proj. |
|---|---------|--------|---------|--------|--------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Përshkrimi | | | | | | | | | |
| BPV | 3.40% | 1.20% | 4.10% | 4.10% | 4.20% | 4.30% | 4.70% | 4.20% | 4.80% |
| BPV për kokë banori | | 3.00% | 6.10% | 2.80% | 4.70% | 3.90% | 4.30% | 3.90% | 4.50% |
| Konsumi | 5.70% | 7.70% | 4.60% | 4.70% | 1.50% | 5.90% | 3.90% | 3.80% | 3.80% |
| Investimet | -0.30% | -5.00% | 11.30% | 7.50% | 5.60% | 7.10% | 7.70% | 4.00% | 4.50% |
| Eksporti | -19.70% | -7.40% | -10.70% | 2.40% | 16.80% | 11.00% | 6.50% | 4.70% | 5.60% |
| Importi | -4.30% | 7.00% | 2.20% | 6.40% | 5.40% | 12.20% | 5.70% | 3.50% | 3.30% |
| Ndryshimet e çmimeve (në përqindje) | | | | | | | | | |
| ICK | 1.80% | 0.40% | -0.50% | 0.30% | 1.50% | 1.00% | 1.30% | 1.30% | 1.30% |
| Deflatori | 1.90% | 3.30% | 0.20% | 0.50% | 1.40% | 1.10% | 0.70% | 1.40% | 0.90% |
| Cmimet e Importit | 0.20% | -0.60% | -1.00% | -1.60% | 3.90% | 2.40% | 2.00% | 2.00% | 2.00% |
| Buxheti qeveritar (në përqindje të BPV-së) | | | | | | | | | |
| Te hyrat | 24.90% | 23.90% | 25.10% | 26.30% | 26.20% | 26.10% | 27.20% | 27.00% | 26.90% |
| <i>prej te cilave:</i> | 20.70% | | | | | | | | |
| Te hyrat tatimore | | 20.90% | 21.80% | 23.40% | 23.30% | 23.30% | 24.10% | 24.10% | 24.10% |
| Te hyrat jo-tatimore | | 3.10% | 3.20% | 2.90% | 2.90% | 2.80% | 3.00% | 2.80% | 2.70% |

| | | | | | | | | | |
|---|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| Shpenzimet | 27.80% | 26.40% | 26.70% | 27.30% | 27.20% | 28.80% | 32.60% | 31.60% | 30.50% |
| <i>prej te cilave:</i> | | | | | | | | | |
| Shpenzimet rrjedhese | | 19.00% | 19.80% | 20.10% | 20.40% | 20.90% | 21.70% | 21.30% | 20.90% |
| Shpenzimet kapitale dhe neto huamarrja | 9.90% | 7.40% | 6.90% | 7.20% | 7.10% | 7.90% | 10.90% | 10.30% | 9.60% |
| Pagesat e interesit | | 0.20% | 0.30% | 0.30% | 0.30% | 0.30% | 0.40% | 0.40% | 0.40% |
| Bilanci i pergjithshem | | -2.70% | -1.90% | -1.30% | -1.20% | -3.10% | -5.80% | -4.90% | -3.90% |
| Bilanci i pergjithshem (sipas rregulles fiskale) | -3.10% | -2.30% | -1.90% | -0.90% | -0.80% | -0.50% | -2.00% | -1.30% | -1.40% |
| Bilanci I kursimeve/Investimeve (në % të BPV-së) | | | | | | | | | |
| Neto te ardhurat paresore nga jashtë | 2.30% | 2.10% | 1.60% | 1.20% | 1.30% | 2.10% | 1.90% | 2.30% | 2.40% |
| Neto te ardhurat dytësore nga jashtë | | 19.80% | 18.30% | 18.10% | 18.10% | 18.30% | 18.10% | 17.80% | 17.60% |
| <i>prej te cilave: remitancat</i> | 10.80% | 11.20% | 11.50% | 11.40% | 11.80% | 11.80% | 11.80% | 11.70% | 11.60% |
| Investimet | 27.60% | 25.80% | 27.60% | 27.20% | 28.40% | 29.10% | 30.10% | 30.00% | 30.00% |
| Bilanci i llogarise rrjedhese | -3.40% | -6.90% | -8.60% | -8.30% | -6.80% | -8.10% | -9.60% | -8.90% | -8.90% |
| Bilanci tregtar | -37.50% | -37.00% | -36.30% | -37.70% | -38.40% | -42.60% | -43.90% | -43.90% | -43.90% |
| Bruto kursimet kombetare | | 18.90% | 19.00% | 19.20% | 21.90% | 20.90% | 20.50% | 21.00% | 21.20% |
| Kursimet private | | 14.60% | 14.60% | 13.10% | 15.30% | 15.20% | 14.50% | 14.80% | 14.60% |
| Agreatët kryesor(në miliona euro) | | | | | | | | | |
| BPV | 5,326.70 | 5,567.10 | 5,807.50 | 6,070.10 | 6,413.90 | 6,760.70 | 7,123.10 | 7,529.00 | 7,960.90 |
| BAKD | 6,623.20 | 6,781.90 | 6,962.50 | 7,240.20 | 7,660.70 | 8,138.70 | 8,544.00 | 9,048.80 | 9,549.40 |
| PBV per capita (ne euro) | 2,899.70 | 3,084.40 | 3,278.10 | 3,386.40 | 3,596.20 | 3,775.10 | 3,962.90 | 4,174.20 | 4,399.60 |

| | | | | | | | | | |
|---------------------------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| BAKD per capita (ne euro) | 3,277.90 | 3,492.50 | 3,706.00 | 3,813.40 | 4,069.40 | 4,298.30 | 4,502.70 | 4,759.50 | 5,013.20 |
| Remitancat e punëtorëve | 573.4 | 622.3 | 665.5 | 691 | 759.2 | 797.1 | 837 | 878.9 | 922.8 |
| Popullsia (ne mijëra) | 1,837.00 | 1,804.90 | 1,771.60 | 1,792.50 | 1,783.50 | 1,790.80 | 1,797.40 | 1,803.70 | 1,809.50 |

BURIMI: MF DHE ASK

TABELA 2: PARASHIKIMET BUXHETORE AFATMESME 2018-2020, NË MILIONA EURO

| Përshkrimi | Buxheti i rishik. | | | | Paraprak | Buxheti | Projeksionet | Projeksionet |
|--------------------------------------|-------------------|-------|-------|-------|----------|---------|--------------|--------------|
| | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
| Të hyrat totale | 1,345 | 1,470 | 1,608 | 1,725 | 1,689 | 1,829 | 1,939 | 2,069 |
| Të hyrat tatimore, neto | 1,162 | 1,269 | 1,421 | 1,512 | 1,495 | 1,607 | 1,719 | 1,847 |
| Të hyrat jo-tatimore | 171 | 188 | 175 | 201 | 185 | 202 | 203 | 204 |
| Tjetra | 12 | 13 | 12 | 12 | 9 | 19 | 17 | 17 |
| Shpenzimet totale | 1,480 | 1,564 | 1,672 | 1,811 | 1,748 | 2,092 | 2,183 | 2,297 |
| Shpenzimet operative | 1,058 | 1,149 | 1,221 | 1,309 | 1,281 | 1,386 | 1,420 | 1,458 |
| Shpenzimet kapitale | 411 | 404 | 444 | 501 | 468 | 694 | 751 | 827 |
| Tjera | 11 | 11 | 8 | 0 | 0 | 12 | 12 | 12 |
| Bilanci primar | -135 | -94 | -64 | -86 | -59 | -264 | -245 | -228 |
| Bilanci i buxhetit të përgjithshëm | -148 | -111 | -83 | -109 | -78 | -287 | -268 | -249 |
| Bilanci i buxhetit - rregulli fiskal | -128 | -78 | -54 | -96 | -43 | -122 | -109 | -70 |

BURIMI: MF DHE ASK

TABELA 3: DËRGESAT E MIGRANTËVE - SIPAS SHTETEVE (NË PËRQINDJE)

| Përshkrimi | Gjithsej | Gjermania | Zvicra | Italia | Austria | Belgjika | SHBA | Suedia | Franca | Norvegjia | Kanada | Britania e madhe | Vendet tjera |
|------------|----------|-----------|--------|--------|---------|----------|------|--------|--------|-----------|--------|------------------|--------------|
| 2013 | 100 | 34 | 24 | 8 | 6 | 2 | 4 | 3 | 4 | 3 | 1 | 2 | 9 |
| 2014 | 100 | 36 | 23 | 5 | 4 | 3 | 6 | 3 | 3 | 3 | 1 | 3 | 10 |
| 2015 | 100 | 37 | 22 | 5 | 4 | 2 | 8 | 3 | 3 | 3 | 2 | 3 | 8 |
| 2016 | 100 | 37 | 23 | 5 | 4 | 2 | 7 | 3 | 4 | 2 | 2 | 3 | 9 |
| 2017 | 100 | 39 | 22 | 4 | 4 | 3 | 7 | 3 | 4 | 2 | 2 | 3 | 7 |

Burimi: BQK

TABELA 4: NXËNËSIT NË ARSIMIN PUBLIK DHE PRIVAT SIPAS NIVELEVE DHE VITEVE SHKOLLORE, 2012/13-2016/17

| Niveli i arsimit | 2012/13 | | | 2013/14 | | | 2014/15 | | | 2015/16 | | | 2016/17 | | |
|---------------------------------------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|
| | M | F | Gj | M | F | Gj | M | F | Gj | M | F | Gj | M | F | Gj |
| Arsimi parashkollor (mosha 0-<5 vjeç) | 2,909 | 2,556 | 5,465 | 2,827 | 2,571 | 5,398 | 2,790 | 2,580 | 5,370 | 2,505 | 2,287 | 4,792 | 3,192 | 2,700 | 5,892 |
| Arsimi parafillor (mosha 5-<6 vjeç) | 10,422 | 9,943 | 20,365 | 10,319 | 9,620 | 19,939 | 10,739 | 10,136 | 20,875 | 11,483 | 10,649 | 22,132 | 11,901 | 11,193 | 23,094 |
| Fillor/i mesëm i ulët | 150,470 | 139,833 | 290,303 | 145,488 | 135,108 | 280,596 | 142,460 | 133,427 | 275,887 | 134,842 | 126,265 | 261,107 | 129,697 | 121,234 | 250,931 |
| I mesëm i lartë | 57,879 | 49,072 | 106,951 | 54,785 | 47,428 | 102,213 | 45,796 | 40,423 | 86,219 | 45,366 | 41,010 | 86,376 | 46,449 | 42,943 | 89,392 |
| Gjithsej | 221,680 | 201,404 | 423,084 | 213,419 | 194,727 | 408,146 | 201,785 | 186,566 | 388,351 | 194,196 | 180,211 | 374,407 | 191,239 | 178,070 | 369,309 |

Burimi: MASHT

TABELA 5: SHKALLA BRUTO E REGJISTRIMIT (SHBR) NË NIVELIN E ARSIMIT FILLOR, TË MESËM TË ULËT DHE MESËM TË LARTË, 2012/13-2016/17

| Shkalla bruto C14:M18 | 2012/2013 | | | 2013/2014 | | | 2014/2015 | | | 2015/2016 | | | 2016/2017 | | |
|----------------------------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|
| | Gj | M | F | Gj | M | F | Gj | M | F | Gj | M | F | Gj | M | F |
| SHBR në arsimin fillor | 98.60 % | 98.70 % | 98.50 % | 96.40 % | 96.80 % | 96.00 % | 96.40 % | 96.20 % | 96.50 % | 94.70 % | 94.50 % | 94.80 % | 96.20 % | 96.10 % | 96.40 % |
| SHBR në arsimin e mesëm të ulët | 98.60 % | 99.10 % | 98.10 % | 98.00 % | 98.30 % | 97.80 % | 99.50 % | 99.40 % | 99.60 % | 96.00 % | 95.80 % | 96.10 % | 93.30 % | 93.20 % | 93.30 % |
| SHBR në arsimin e mesëm të lartë | 88.70 % | 91.90 % | 85.30 % | 87.00 % | 89.40 % | 84.40 % | 84.50 % | 86.90 % | 81.90 % | 84.90 % | 86.30 % | 83.40 % | 88.10 % | 88.60 % | 87.50 % |

Burimi: MASH-T-SMIA

TABELA 6: NXËNËS TË LARGUAR JASHTË VENDIT SIPAS NIVELIT DHE VITIT SHKOLLOR, 2013/14-2016/17

| Niveli | 2013/14 | | | 2014/15 | | | 2015/16 | | | 2016/17 | | |
|---------------------------------------|---------|-----|-------|---------|-------|-------|---------|-------|-------|---------|-----|-----|
| | M | F | Gj | M | F | Gj | M | F | Gj | M | F | Gj |
| Parafillor (mosha 5-<6) | 7 | 4 | 11 | 15 | 19 | 34 | 3 | 2 | 5 | 6 | 2 | 8 |
| Fillor dhe i mesëm i ulët (kl. 1 - 9) | 859 | 720 | 1,579 | 2,496 | 2,028 | 4,524 | 1,169 | 957 | 2,126 | 337 | 291 | 628 |
| I mesëm i lartë (kl. 10 - 13) | 161 | 65 | 226 | 262 | 145 | 407 | 71 | 47 | 118 | 53 | 13 | 66 |
| Gjithsej | 1,027 | 789 | 1,816 | 2,773 | 2,192 | 4,965 | 1,243 | 1,006 | 2,249 | 396 | 306 | 702 |

Burimi: MASH-T-SMIA

TABELA 7: NXËNËS TË ARDHUR JASHTË VENDIT SIPAS NIVELIT DHE VITIT SHKOLLOR, 2013/14-2016/17

| Niveli | 2013/14 | | | 2014/15 | | | 2015/16 | | | 2016/17 | | |
|---------------------------------------|------------|------------|-------------|------------|------------|------------|------------|------------|-------------|------------|------------|------------|
| | M | F | Gj | M | F | Gj | M | F | Gj | M | F | Gj |
| Parafillor (mosha 5-<6) | 5 | 8 | 13 | 5 | 1 | 6 | 10 | 19 | 29 | 3 | 11 | 14 |
| Fillor dhe i mesëm i ulët (kl. 1 - 9) | 717 | 590 | 1307 | 419 | 362 | 781 | 799 | 681 | 1480 | 460 | 357 | 817 |
| I mesëm i lartë (kl. 10 - 13) | 158 | 69 | 227 | 86 | 59 | 145 | 116 | 66 | 182 | 70 | 35 | 105 |
| Gjithsej | 880 | 667 | 1547 | 510 | 422 | 932 | 925 | 766 | 1691 | 533 | 403 | 936 |

Burimi: MASH-T-SMIA

TABELA 8: NUMRI DHE SHTETËSIA IMIGRANTËVE QË KANË HYRË NË KOSOVË NË MËNYRË TË PAAUTORIZUAR, QËLLIMI IMIGRIMI I PARREGULLT 2013-2017

| Shteti/viti | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | Total |
|-------------|------|------|------|------|------|-------|
| Afganistani | 0 | 0 | 0 | 228 | 43 | 271 |
| Siri | 24 | 79 | 66 | 55 | 26 | 250 |
| Libia | 0 | 0 | 0 | 5 | 24 | 29 |
| Algjeri | 7 | 3 | 1 | 0 | 15 | 26 |
| Pakistan | 12 | 1 | 0 | 0 | 11 | 24 |
| Irak | 0 | 7 | 7 | 3 | 3 | 20 |
| Irani | 0 | 2 | 2 | 9 | 4 | 17 |

| | | | | | | |
|--------------|-----------|-----------|-----------|------------|------------|------------|
| Nigeri | 8 | 0 | 0 | 0 | 0 | 8 |
| Palestina | 0 | 1 | 2 | 3 | 2 | 8 |
| India | 0 | 0 | 6 | 0 | 0 | 6 |
| Senegali | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 |
| Maroku | 2 | 0 | 1 | 2 | 0 | 5 |
| Te tjera | 4 | 2 | 3 | 1 | 4 | 14 |
| Total | 62 | 95 | 88 | 306 | 132 | 683 |

Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrim të Dhënave, Departamenti i Kufirit, Policia e Kosovës

TABELA 9: NUMRI DHE SHTETËSIA E PERSONAVE ME QËNDRIM TE PA RREGULLT GJATE PERIUDHËS 2013-2017

| Shtetësia | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | Total |
|--------------|------------|------------|------------|-----------|-----------|-----------|
| Shqipëria | 283 | 106 | 108 | 16 | 21 | 32 |
| Turqia | 66 | 46 | 2 | 6 | 1 | 11 |
| Serbia | 15 | 15 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Maqedonia | 13 | 11 | 1 | 0 | 0 | 1 |
| Bullgaria | 13 | 8 | 2 | 1 | 1 | 1 |
| Moldavia | 7 | 0 | 3 | 0 | 0 | 4 |
| Të tjera | 82 | 26 | 18 | 12 | 13 | 13 |
| Total | 479 | 212 | 134 | 35 | 36 | 62 |

Burimi: DMH-Departamenti i Kufirit, Policia e Kosovës

TABELA 10: AZILËKËRKUESIT NË R. KOSOVËS SIPAS GJINISË DHE GRUP-MOSHËS, 2013-2017

| Shteti/Grup-Mosha | Gjithsej | Gjithsej (m) | Gjithsej (f) | 0-13 | 14-17 | 18-34 | 35-64 | 65+ | panjohur |
|-------------------|------------|--------------|--------------|------------|-----------|------------|------------|----------|----------|
| Gjithsej | 691 | 523 | 168 | 172 | 53 | 347 | 114 | 4 | 0 |
| Afganistan | 272 | 160 | 112 | 113 | 26 | 89 | 42 | 2 | 0 |
| Siri | 242 | 209 | 33 | 37 | 18 | 144 | 42 | 1 | 0 |
| Algjeri | 25 | 25 | 0 | 0 | 0 | 22 | 3 | 0 | 0 |
| Libi | 25 | 25 | 0 | 0 | 2 | 20 | 3 | 0 | 0 |
| Pakistan | 25 | 25 | 0 | 0 | 0 | 22 | 2 | 0 | 0 |
| Irak | 16 | 11 | 5 | 3 | 1 | 7 | 5 | 0 | 0 |
| Shqipëri | 11 | 8 | 3 | 5 | 2 | 1 | 2 | 1 | 0 |
| Iran | 10 | 9 | 1 | 3 | 1 | 5 | 1 | 0 | 0 |
| Nigeri | 8 | 3 | 5 | 5 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 |
| Palestinë | 6 | 6 | 0 | 0 | 0 | 5 | 1 | 0 | 0 |
| Shtetet tjera | 51 | 42 | 9 | 6 | 3 | 32 | 11 | 0 | 0 |

Burimi: DSHAM/MPB

TABELA 11: SHITETASIT KOSOVAR ME LEJE QËNDRIM TË RREGULLT NË SHITETET E BE-SË DHE ZONËS SCHENGEN, 2013-2017

| Viti | Total 2013-2017 | | 2013 | | 2014 | | 2015 | | 2016 | | 2017 | |
|---------------|-----------------|----------|---------------|----------|---------------|----------|---------------|----------|---------------|----------|---------------|----------|
| Gjermania | 48,866 | 45.90% | 7,846 | 39.10% | 8,260 | 40.80% | 8,260 | 38.20% | 10,020 | 47.40% | 14,480 | 61.90% |
| Italia | 12,393 | 11.60% | 2,461 | 12.30% | 2,078 | 10.30% | 2,786 | 12.90% | 2,599 | 12.30% | 2,469 | 10.60% |
| Franca | 8,760 | 8.20% | 1,528 | 7.60% | 1,576 | 7.80% | 1,676 | 7.80% | 2,029 | 9.60% | 1,951 | 8.30% |
| Slovenia | 7,825 | 7.30% | 1,246 | 6.20% | 1,555 | 7.70% | 1,612 | 7.50% | 1,397 | 6.60% | 2,015 | 8.60% |
| Austria | 7,197 | 6.80% | 1,713 | 8.50% | 1,763 | 8.70% | 1,877 | 8.70% | 1,844 | 8.70% | : | : |
| Suedia | 4,034 | 3.80% | 1,016 | 5.10% | 986 | 4.90% | 1,018 | 4.70% | 1,014 | 4.80% | : | : |
| Zvicra | 7,127 | 6.70% | 2,619 | 13.00% | 2,020 | 10.00% | 2,199 | 10.20% | : | : | 289 | 1.20% |
| Belgjika | 2,005 | 1.90% | 402 | 2.00% | 392 | 1.90% | 459 | 2.10% | 361 | 1.70% | 391 | 1.70% |
| Anglia | 1,249 | 1.20% | 210 | 1.00% | 348 | 1.70% | 312 | 1.40% | 379 | 1.80% | : | : |
| Finlanda | 1,800 | 1.70% | 336 | 1.70% | 372 | 1.80% | 326 | 1.50% | 352 | 1.70% | 414 | 1.80% |
| Tjera | 5,213 | 4.90% | 703 | 3.50% | 905 | 4.50% | 1082 | 5.00% | 1146 | 5.40% | 1377 | 5.90% |
| Total: | 106,469 | % | 20,080 | % | 20,255 | % | 21,607 | % | 21,141 | % | 23,386 | % |

Burimi: Eurostat

TABELA 12: SHTETASIT KOSOVARË QË IU REFUZUA HYRJA NË BE DHE ZONËN SCHENGEN, SIPAS SHTETEVE, 2013-2017

| Shteti/Viti | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
|----------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Gjithsej | 1,465 | 1,315 | 1,185 | 1,300 | 1,600 |
| Kroacia | 720 | 560 | 520 | 395 | 500 |
| Franca | 110 | 65 | 120 | 395 | 510 |
| Hungaria | 140 | 150 | 135 | 150 | 200 |
| Sllovenia | 150 | 115 | 115 | 95 | 110 |
| Bullgaria | 60 | 160 | 75 | 40 | 30 |
| Gjermania | 90 | 55 | 60 | 70 | 45 |
| Mbretëria e Bashkuar | 40 | 55 | 55 | 30 | 45 |
| Zvicra | 45 | 45 | 45 | 40 | 30 |
| Italia | 50 | 35 | 20 | 30 | 55 |
| Greqia | 15 | 40 | 10 | 10 | 35 |
| Belgjika | 25 | 15 | 10 | 5 | 5 |
| Rumunia | 0 | 5 | 10 | 10 | 10 |
| Irlanda | 10 | 5 | 5 | 5 | 5 |
| Suedia | 0 | 5 | 0 | 20 | 5 |
| Austria | 5 | 5 | 5 | 5 | 5 |
| Spanja | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 |
| Lihtenshtajni | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | |
|-----------|---|---|---|---|---|
| Norvegjia | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 |
|-----------|---|---|---|---|---|

Burimi: Eurostat

TABELA 13: SHETASIT KOSOVARË TË CILËT JANË ZËNË ME QËNDRIM TË PARREGULLT BRENDA TERRITORIT TË SHTETEVE ANËTARE TË BE-SË DHE ZONËS SCHEGEN, SIPAS SHTETEVE, 2013-2017

| Shteti/Viti | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
|----------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|--------------|
| Gjithsej | 16,445 | 35,490 | 52,310 | 11,385 | 7,785 |
| Hungaria | 7,580 | 24,000 | 26,280 | 810 | 485 |
| Gjermania | 3,070 | 4,110 | 18,965 | 6,480 | 3,615 |
| Zvicra | 1,790 | 1,615 | 2,105 | 1,575 | 1,160 |
| Austria | 1,175 | 1,780 | 1,995 | 380 | 375 |
| Franca | 845 | 1,270 | 1,415 | 975 | 835 |
| Suedia | 725 | 1,370 | 45 | 45 | 60 |
| Belgjika | 290 | 295 | 260 | 155 | 125 |
| Kroacia | 275 | 230 | 150 | 410 | 645 |
| Italia | 180 | 130 | 150 | 155 | 130 |
| Mbretëria e Bashkuar | 100 | 90 | 115 | 100 | 100 |
| Republika Çeke | 45 | 185 | 265 | 25 | 20 |
| Norvegjia | 65 | 90 | 150 | 100 | 45 |
| Finlanda | 40 | 40 | 70 | 15 | 10 |

| | | | | | |
|---------------|-----|-----|-----|----|----|
| Sllovenia | 100 | 100 | 100 | 55 | 45 |
| Greqia | 60 | 35 | 10 | 15 | 30 |
| Luksemburgu | 25 | 35 | 10 | 5 | 20 |
| Holanda | 45 | 20 | 55 | 25 | 20 |
| Sllovakia | 15 | 75 | 105 | 5 | 0 |
| Irlanda | 5 | 0 | 20 | 15 | 0 |
| Danimarka | 0 | 10 | 20 | 30 | 30 |
| Polonia | 10 | 5 | 10 | 5 | 25 |
| Bullgaria | 5 | 5 | 10 | 0 | 5 |
| Lihtenshtajni | 0 | 0 | 5 | 5 | 5 |

Burimi: Eurostat

TABELA 14: SHITESIT KOSOVARE TË URDHËRUAR TË LARGOHEN NGA SHITESIT ANËTARE TË BE-SË DHE ZONËS SCHENGEN, SIPAS SHITESIT, 2013-2017

| Shteti/Viti | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
|-------------|--------|-------|--------|--------|-------|
| Gjithsej | 10,675 | 9,645 | 22,220 | 14,170 | 7,570 |
| Gjermania | 1,275 | 1,505 | 10,625 | 5,405 | 2,160 |
| Franca | 2,205 | 2,700 | 2,900 | 2,540 | 1,970 |
| Hungaria | 1,785 | 1,910 | 1,075 | 625 | 285 |
| Austria | 720 | 0 | 2,560 | 2,195 | 195 |
| Belgjika | 2,070 | 1,035 | 860 | 640 | 600 |

| | | | | | |
|----------------------|-----|-----|-------|-----|-----|
| Suedia | 665 | 755 | 1,595 | 615 | 395 |
| Zvicra | 450 | 520 | 585 | 450 | 420 |
| Kroacia | 285 | 270 | 170 | 480 | 675 |
| Holanda | 105 | 125 | 510 | 305 | 130 |
| Norvegjia | 305 | 265 | 315 | 185 | 100 |
| Italia | 180 | 130 | 150 | 155 | 130 |
| Luksemburgu | 200 | 85 | 120 | 130 | 75 |
| Sllovenia | 100 | 100 | 105 | 155 | 150 |
| Mbretëria e Bashkuar | 100 | 90 | 115 | 100 | 100 |
| Finlanda | 90 | : | 180 | 105 | 55 |
| Danimarka | 100 | 50 | 120 | 60 | 45 |
| Republika Çeke | 10 | 30 | 105 | 10 | 15 |
| Greqia | 0 | 35 | 25 | 0 | 55 |
| Sllovakia | 0 | 20 | 90 | 5 | 0 |
| Irlanda | 20 | 5 | 5 | 5 | 0 |
| Bullgaria | 5 | 5 | 10 | 0 | 5 |
| Polonia | 5 | 5 | 0 | 5 | 10 |
| Lihtenshtajni | 0 | 5 | 0 | 0 | : |

Burimi: Eurostat

TABELA 15: SHTETAS KOSOVARË TË LARGUAR NGA SHTETET ANËTARE TË BE-SË DHE ZONËS SCHENGEN NË BAZË TË URDHRIT PËR LARGIM, SIPAS SHTETEVE DHE VITEVE, 2013-2017

| Shteti/Viti | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
|----------------------|--------------|--------------|---------------|---------------|--------------|
| Gjithsej | 5,945 | 4,835 | 19,045 | 13,295 | 6,285 |
| Gjermania | 1,005 | 1,095 | 13,965 | 10,415 | 4,205 |
| Hungaria | 1,440 | 1,270 | 650 | 60 | 55 |
| Austria | 790 | 440 | 1,455 | 360 | 260 |
| Suedia | 920 | 390 | 975 | 545 | 335 |
| Franca | 390 | 490 | 565 | 420 | 340 |
| Belgjika | 420 | 250 | 270 | 245 | 145 |
| Kroacia | 275 | 245 | 130 | 405 | 510 |
| Mbretëria e Bashkuar | 100 | 95 | 110 | 70 | 80 |
| Norvegjia | 145 | 125 | 175 | 130 | 60 |
| Luksemburgu | 100 | 170 | 120 | 125 | 100 |
| Holanda | 45 | 35 | 220 | 285 | 45 |
| Finlanda | 80 | : | 90 | 95 | 30 |
| Danimarka | 75 | 70 | 60 | 40 | 25 |
| Sllovenia | 90 | 90 | 90 | 55 | 35 |
| Italia | 50 | 35 | 35 | 35 | 40 |
| Rep. Çeke | 5 | 10 | 60 | 5 | 5 |
| Sllovakia | 0 | 15 | 70 | 0 | 5 |

| | | | | | |
|-----------|---|---|---|---|---|
| Bullgaria | 5 | 5 | 5 | 0 | 5 |
| Greqia | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Polonia | 5 | 5 | 0 | 5 | 5 |
| Irlanda | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Burimi: Eurostat

TABELA 16: NUMRI I KËRKESAVE PËR MBROJTJEN NDËRKOMBËTARE PËR HERË TË PARË TË SHITETASVE KOSOVARË DREJT SHITETEVE ANËTARE TË BE-SË DHE ZONËN SCHENGEN, 2013-2017

| Shteti/Viti | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
|-------------|-------|--------|--------|-------|-------|
| Hungari | 6,090 | 20,910 | 23,690 | 105 | 5 |
| Gjermani | 3,395 | 6,910 | 33,425 | 4,975 | 1,300 |
| Francë | 5,205 | 2,420 | 3,825 | 2,350 | 2,680 |
| Suedi | 1,055 | 1,320 | 1,605 | 225 | 205 |
| Austri | : | 1,745 | 2,305 | 155 | 110 |
| Sëitserland | 625 | 340 | 495 | 200 | 105 |
| Belgjikë | 420 | 315 | 470 | 200 | 185 |
| Itali | 95 | 100 | 325 | 340 | 585 |
| Holandë | 50 | 60 | 685 | 465 | 35 |
| Luksemburg | 145 | 105 | 190 | 195 | 65 |
| Norvegji | 235 | 135 | 155 | 30 | 10 |
| Finlandë | 65 | 95 | 160 | 40 | 20 |

| | | | | | |
|----------------------|----|----|-----|----|----|
| Danimarkë | 80 | 80 | 110 | 50 | 40 |
| Mbretëria e Bashkuar | 30 | 30 | 30 | 35 | 35 |
| Sllovenia | 30 | 15 | 25 | 20 | 45 |
| Republika Çeke | 10 | 10 | 10 | 5 | 0 |
| Kroacia | 5 | 5 | 10 | 10 | 5 |
| Irlandë | 5 | 5 | 15 | 0 | 5 |
| Islandë | : | : | 10 | 5 | 15 |
| Portugali | 0 | 0 | 5 | 0 | 0 |

Burimi: Eurostat

TABELA 17: RIPRANIMI ME FORCË DHE VULLNETARË SIPAS SHTETEVE, 2013-2017

| Shtetet/Viti | 2013 | | 2014 | | 2015 | | 2016 | | 2017 | |
|--------------|-------|------------|-------|------------|-------|------------|-------|------------|-------|------------|
| | Forcë | Vullnetarë | Forcë | Vullnetarë | Forcë | Vullnetarë | Forcë | Vullnetarë | Forcë | Vullnetarë |
| Gjermania | 655 | 268 | 684 | 305 | 6,545 | 8,029 | 4,952 | 5,943 | 1,774 | 1 |
| Zvicra | 673 | 306 | 584 | 160 | 524 | 62 | 451 | 52 | 259 | 0 |
| Franca | 271 | 92 | 296 | 139 | 256 | 0 | 175 | 0 | 110 | 1,550 |
| Austria | 280 | 276 | 201 | 194 | 371 | 1,036 | 164 | 203 | 62 | 61 |
| Hungaria | 396 | 145 | 633 | 185 | 348 | 114 | 67 | 5 | 2 | 0 |
| Suedia | 553 | 39 | 277 | 11 | 418 | 0 | 285 | 0 | 130 | 0 |
| Belgjike | 255 | 215 | 184 | 88 | 139 | 118 | 91 | 66 | 59 | 0 |

| | | | | | | | | | | |
|---------------|----|-----|-----|----|-----|-----|----|-----|----|-----|
| Norvegjia | 68 | 134 | 117 | 13 | 123 | 29 | 86 | 9 | 27 | 0 |
| Luxemburgu | 20 | 45 | 39 | 98 | 44 | 105 | 16 | 113 | 18 | 0 |
| Kroacia | 37 | 6 | 79 | 0 | 17 | 0 | 48 | 0 | 69 | 82 |
| Holanda | 18 | 6 | 22 | 11 | 17 | 102 | 28 | 74 | 17 | 8 |
| Finlanda | 64 | 15 | 30 | 19 | 32 | 39 | 31 | 40 | 14 | 0 |
| Danimarke | 67 | 14 | 76 | 5 | 58 | 0 | 38 | 0 | 8 | 3 |
| Britania | 12 | 4 | 22 | 13 | 22 | 0 | 8 | 1 | 11 | 143 |
| Sllovenia | 14 | 4 | 23 | 5 | 18 | 1 | 26 | 0 | 16 | 2 |
| Italia | 29 | 6 | 11 | 4 | 20 | 0 | 23 | 3 | 12 | 0 |
| Kanada | 17 | 3 | 27 | 5 | 19 | 0 | 14 | 0 | 5 | 0 |
| Rep. Qeke | 6 | 0 | 7 | 1 | 15 | 56 | 0 | 0 | 4 | 0 |
| ShBA | 11 | 5 | 15 | 0 | 9 | 0 | 7 | 0 | 5 | 28 |
| BeH | 22 | 5 | 14 | 0 | 30 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| Shtetet tjera | 17 | 42 | 11 | 2 | 15 | 58 | 9 | 2 | 21 | 6 |

Burimi: PK, IOM

TABELA 18: QENDRAT KOLEKTIVE NË KOSOVË

| Regjioni | Komunat | Refugjat | | Serb PZHBV-te | | Romë, Ashkali dhe Egjiptian | | Shqiptarët PZHBV | | TOTAL | |
|----------------------------------|--------------------|-----------|-----------|---------------|------------|-----------------------------|-----------|------------------|-----------|------------|------------|
| | | Fam | Ind | Fam | Ind | Fam | Ind | Fam | Ind | Fam | Ind |
| Mitrovicë | Mitrovica e Veriut | 0 | 0 | 17 | 23 | 0 | 0 | 0 | 0 | 17 | 23 |
| | Leposaviq | 13 | 21 | 25 | 51 | 2 | 18 | 0 | 0 | 40 | 90 |
| | Zubin Potok | 9 | 22 | 7 | 17 | 0 | 0 | 0 | 0 | 16 | 39 |
| | Zvecan | 0 | 0 | 8 | 20 | 2 | 11 | 0 | 0 | 10 | 31 |
| | Mitrovica e Jugut | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 13 | 4 | 13 |
| Gjilan | Shtërpcë | 2 | 5 | 100 | 242 | 0 | 0 | 0 | 0 | 102 | 247 |
| Prishtinë | Gracanicë | 0 | 0 | 15 | 21 | 0 | 0 | 0 | 0 | 15 | 21 |
| Total 28 Qendra Kolektive | | 24 | 48 | 172 | 374 | 4 | 29 | 4 | 13 | 204 | 464 |

Burimi: UNHCR

III. REFERENCAT

- Strategjia Shtetërore për Migrim dhe Plani i Veprimit 2013 – 2018;
- Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën, si dhe Plani i Veprimit 2013 – 2018;
- Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2013 – 2019;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit 2013 – 2018;
- Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Kosovë dhe Plani i Veprimit 2013 – 2017;
- Politikat e regjimit të vizave;
- Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt;
- Ligji Nr. 04/L-217 për Azil;
- Ligji Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës;
- Ligji Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror;
- Ligji Nr. 04/L214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 4/L214 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror;
- Ligji Nr. 04/l216 për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit;
- Ligji Nr. 04/l-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit;
- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë;
- Ligji Nr. 03/L-208 për Ripranim;
- Ligji Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile;
- Ligji Nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën;
- Ligji Nr. 02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin.